



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 129

Tiranë – E hënë, 22 qershor 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 10, datë 29.5.2026	Për rregullat e hollësishme për prodhimin organik të algave dhe specieve të akuakulturës..... 11937
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 40, datë 26.3.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 21, datë 13.3.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 27, datë 16.3.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 16, datë 25.4.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1690, datë 17.10.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë..... 11951
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 143, datë 28.5.2026	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 mw..... 11963
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 144, datë 28.5.2026	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 mw..... 11964
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 145, datë 28.5.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw..... 11965
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 146, datë 28.5.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw..... 11966

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 147, datë 28.5.2026	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 25 mw”, i ndryshuar.....	11968
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 148, datë 28.5.2026	Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 25 mw.....	11969
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 149, datë 28.5.2026	Mbi licencimin e shoqërisë “Premium Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	11970
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 150, datë 28.5.2026	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 238, datë 6.11.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Orher’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.....	11971
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 151, datë 28.5.2026	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.8.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Faethon’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.....	11973
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 152, datë 28.5.2026	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘DION Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw”.....	11974
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 153, datë 28.5.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.....	11976
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 154, datë 28.5.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.....	11977
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 155, datë 28.5.2026	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 30 mw”, i ndryshuar.....	11978
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 156, datë 28.5.2026	Mbi miratimin e vlerësimit të ERE-s për gatishmërinë e tregut të ditës në avancë në Shqipëri.....	11979
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 158, datë 5.6.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Greensol” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	12001
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 159, datë 5.6.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	12002
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 160, datë 5.6.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Nexora Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	12004



UDHËZIM

Nr. 10, datë 29.5.2026

**PËR RREGULLAT E HOLLËSISHME PËR
PRODHIMIN ORGANIK TË ALGAVE
DHE SPECIEVE TË AKUAKULTURËS¹**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 15, të ligjit nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”,

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për prodhimin organik të specieve të bimëve ujore dhe kafshëve ujore dhe në veçanti për speciet e mëposhtme:

- a) peshqit;
 - b) krustacët (si gaforret, karkalecat dhe karavidhet);
 - c) ekinodermët;
 - ç) molusqet.
2. Ky udhëzim zbatohet, edhe për:
- a) zooplanktonin;
 - b) mikrokrustacët;
 - c) rotiferët;
 - ç) krimbat; dhe
 - d) lloje të tjera, që përdoren si ushqim për speciet ujore.

3. Rregullat për prodhimin e bimëve ujore zbatohen edhe për prodhimin e fitoplanktonit, duke marrë parasysh kushtet e veçanta.

4. Mbledhja e algave të egra dhe e pjesëve të tyre konsiderohet si metodë e prodhimit organik nëse:

a) zonat e kultivimit të tyre janë të përshtatshme nga pikëpamja shëndetësore dhe të kenë një status të mirë ekologjik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të burimeve ujore ose të një cilësie ekuivalente me zonat e prodhimit të klasifikuara si A dhe B, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë ushqimore dhe kontrollin zyrtar të produkteve me origjinë shtazore;

b) mbledhja nuk ndikon në qëndrueshmërinë afatgjatë të ekosistemit natyror ose tek mirëmbajtja e specieve në zonën e mbledhjes.

5. Kultivimi i algave kryhet në zona me karakteristika mjedisore dhe shëndetësore ekuivalente me ato të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij neni, që të konsiderohen organike. Në të gjitha fazat e prodhimit, nga mbledhja e rasatit deri në vjeljen e algave, përdoren praktika të akuakulturës së qëndrueshme.

Neni 2

Përkufizime

1. Të gjithë termat e përcaktuar në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në ligj.

2. Për efekt të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Cikli i prodhimit” është jetëgjatësia e një specie të akuakulturës ose algave, nga faza më e hershme e jetës, si faza e vezëve të fekunduara në rastin e specieve të akuakulturës, deri në fazën e vjeljes së produktit;

b) “Energjia nga burimet e rinovueshme” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”;

c) “Implant akuakulture me sistem riqarkullimi të ujit” është një implant në tokë ose mjet lundrues ku akuakultura zhvillohet brenda një mjedisi të mbyllur, i cili përfshin riqarkullimin e ujit dhe që varet nga furnizimi i jashtëm dhe i vazhdueshëm me energji, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së mjedisit për speciet e akuakulturës;

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (BE) nr. 2018/848, të datës 30 maj 2018, mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007, numri CELEX 32018R0848, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 150, datë 14.6.2018, faqe 1–92, datë 14.6.2018 dhe Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/464, e datës 26 mars 2020, që vendos rregulla të caktuara për zbatimin e

Rregullores (BE) 2018/848, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me dokumentet e nevojshme për njohjen prapavepruese të periudhës së kalimit, prodhimin e produkteve organike dhe informacionin që duhet dhënë nga shtetet anëtare C/2020/1772 CELEX 32020R0464, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 98, datë 31.3.2020, faqe 2–25.



ç) “Inkubator” është një vend për kultivimin, çeljen dhe rritjen që nga fazat e para të jetës së specieve të akuakulturës, veçanërisht peshqve halorë dhe molusqeve bivalve;

d) “Ligj” është ligji nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”;

dh) “Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, si rezultat i aktivitetit njerëzor, e substancave ose nxehtësisë në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për shëndetin e njeriut ose cilësinë e ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore që varen drejtpërsëdrejti nga ekosistemet ujore, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin për mjedisin;

e) “Produkt mjekësor veterinar” është çdo lëndë ose përzierje lëndësh: a) që përdoret për mjekimin ose parandalimin e sëmundjes në kafshë;

ë) “Produkte të akuakulturës” janë specie ujore, në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, që përftohen nga një aktivitet i akuakulturës ose produkte të tyre;

f) “Polikulturë” është rritja në akuakulturë e dy ose më shumë specieve, zakonisht nga nivele të ndryshme trofike, në të njëjtën njësi kultivimi;

g) “Qendër rritjeje” është njësi ku zbatohet një sistem i ndërmjetëm i prodhimit në akuakulturë, ndërmjet fazave të inkubimit dhe rritjes, ku larvat e peshqve ose të specieve të tjera ujore mbahen dhe ushqehen në kushte të kontrolluara, deri në arritjen e madhësisë minimale kur kalon një e treta e ciklit të prodhimit për transferim në fazën e rritjes ose mbarështimit të mëtejshëm, me përjashtim të llojeve që kalojnë në procesin e smoltifikimit;

gj) “Specie indigjene” janë speciet e akuakulturës që nuk janë të huaja dhe nuk mungojnë në vendin tonë;

h) “Smoltifikimi” është procesi fiziologjik dhe morfologjik përmes të cilit peshqit salmonidë përshtaten nga jeta në ujë të ëmbël në jetën në ujë të kripur;

i) “Trajtim veterinar” është trajtimi mjekësor ose parandalues kundër shfaqjes së një sëmundjeje të veçantë.

Neni 3

Parimet lidhur me prodhimin organik të akuakulturës

Për prodhimin organik të akuakulturës zbatohen parimet lidhur me aktivitetet bujqësore dhe të akuakulturës, të përcaktuara në nenin 6, të ligjit dhe rregullat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 15, të ligjit.

KREU II

KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 4

Ndarja e njësive të prodhimit organik dhe joorganik

1. E gjithë ferma menaxhohet në përputhje me kërkesat për prodhimin organik, të përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim.

2. Pavarësisht pikës 1 të këtij neni, ferma mund të ndahet në njësi prodhimi, të ndara në mënyrë të qartë dhe efektive për prodhimin organik, në kalim dhe joorganik, në përputhje me pikën 9, të nenit 9, të ligjit.

3. Përveç përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, për algat dhe speciet e akuakulturës, përfshihen të njëjtat specie, me kusht që të ketë një ndarje të qartë dhe efektive midis proceseve ose njësive të prodhimit, në përputhje me pikën 10, të nenit 9, të ligjit. Në këtë rast operatorët mbajnë të dhëna të dokumentuara për zbatimin e kësaj pike.

Neni 5

Kërkesat e përgjithshme për prodhimin e algave dhe specieve të akuakulturës

1. Për çdo proces të ri në prodhimin organik që prodhon mbi 20 ton produkte të akuakulturës në vit, kërkohet një vlerësim mjedisor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), për të përcaktuar kushtet dhe ndikimet mjedisore të veprimtarisë së njësive të prodhimit. Operatori i dorëzon trupës së kontrollit raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

2. Operatori paraqet një plan menaxhimi të qëndrueshëm, në proporcion me njësinë e prodhimit për akuakulturën dhe vjeljen e algave.

3. Plani i menaxhimit të qëndrueshëm, sipas pikës 2 të këtij neni:



a) përditësohet çdo vit; dhe
b) përshkruan në hollësi ndikimet mjedisore të veprimtarisë dhe monitorimin mjedisor që ndërmerret;

c) liston masat që merren për të minimizuar ndikimet negative në mjediset ujore dhe tokësore përreth, përfshirë shkarkimin e lëndëve ushqyese në mjedis për çdo cikël prodhimi ose në vit;

ç) përmban të dhëna për mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknike.

4. Në planin e menaxhimit të qëndrueshëm përfshihen edhe të dhëna për masat mbrojtëse dhe parandaluese që merren kundër grabitqarëve.

5. Operatori mund të koordinohet me operatorët fqinj, për hartimin e planit të tyre të menaxhimit.

6. Operatorët e akuakulturës dhe algave përpilojnë, si pjesë të planit të menaxhimit të qëndrueshëm, sipas pikës 2 të këtij neni, një plan pune për reduktimin e mbetjeve, që zbatohet që në fillim të veprimtarisë. Kur është e mundur, përdorimi i nxehtësisë së mbetur kufizohet në energjinë nga burime të rinovueshme.

7. Nëse tek algat ose speciet e akuakulturës kryhen proceset e përgatitjes, të ndryshme nga përpunimi, në këto procese zbatohen rregullat e përcaktuara në pikën 6, të nenit 16, të ligjit.

8. Ndalohet shkatërrimi i mangrovave.

Neni 6

Kërkesat shtesë për algat

1. Kultivimi i algave kryhet në zona me karakteristika mjedisore dhe shëndetësore, në përputhje me pikën 4, të nenit 1, të këtij udhëzimi.

2. Për algat zbatohen rregullat e prodhimit të parashikuara në nenin 11, të këtij udhëzimi.

3. Një vlerësim i biomasës kryhet vetëm një herë, në fillim të vjeljes së algave.

Neni 7

Kërkesat shtesë për speciet e akuakulturës

Për prodhimin e specieve të akuakulturës në rezervuarë, pellgje ose kanale me qarkullim uji të rrjedhshëm, fermat pajisen me filtra natyrorë, dekantorë, filtra biologjikë ose mekanikë për të mbledhur mbetjet e lëndëve ushqyese ose përdorin alga dhe/ose specie bivalvore, që përmirësojnë cilësinë e mbetjeve të lëngshme të shkarkuara.

Monitorimi i mbetjeve të lëngshme kryhet në intervale të shpeshta, kur është e mundur.

KREU III

KËRKESAT PËR ALGAT

Neni 8

Kërkesat e përgjithshme për algat

Krahas rregullave të përgjithshme të prodhimit të parashikuara në nenin 9 të ligjit, për mbledhjen dhe prodhimin organik të algave, zbatohen rregullat e parashikuara në këtë kre. Këto rregulla zbatohen edhe për prodhimin e fitoplanktonit.

Neni 9

Periudha e kalimit për algat

Përveç rregullave të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 10 të ligjit, për prodhimin e algave zbatohen rregullat e veçanta, si më poshtë:

1. Periudha e kalimit për një njësi prodhimi për mbledhjen e algave të egra është gjashtë muaj;

2. Periudha e kalimit për një njësi prodhimi për kultivimin e algave është gjashtë muaj ose një cikël prodhimi i plotë, cilado periudhë është më e gjatë.

Neni 10

Mbledhja e algave të egra në mënyrë të qëndrueshme

Mbledhja e algave të egra kryhet në mënyrë të tillë që sasi të mbledhura të mos shkaktojnë ndikim të konsiderueshëm në gjendjen e mjedisit ujor. Me qëllim sigurimin e rigjenerimit të algave dhe parandalimin e kapjes së paqëllimshme të tyre, merren masa të tilla si teknika e mbledhjes, përmasat minimale të algave, mosha, ciklet riprodhuese ose përmasat e algave të mbetura.

Neni 11

Kultivimi i algave

1. Për të siguruar ruajtjen e një larmie të madhe gjenetike, mbledhja e farës së algave të egra, kryhet rregullisht, në mënyrë që të ruhet dhe rritet diversiteti i kulturave të popullatës në mjedise të mbyllura.

2. Plehëruesit nuk përdoren, përveçse në mjedise të mbyllura dhe vetëm ato që përdoren në



prodhimin organik, të përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, të ligjit. Operatorët mbajnë të dhëna për përdorimin e këtyre produkteve, duke përfshirë datën ose datat e përdorimit të produktit, emrin e produktit dhe sasinë e përdorur, me informacionin për lotet, depozitat ose rezervuarët përkatës.

3. Për kultivimin e algave në det përdoren vetëm lëndë ushqyese natyrore, të pranishme në mjedis ose nga prodhimi organik i specieve të akuakulturës, mundësisht që ndodhen afër, si pjesë e një sistemi polikulture.

4. Në stabilimentet e kultivimit në tokë, ku përdoren burime të jashtme të lëndëve ushqyese, nivelet e lëndëve ushqyese në mbetjet e lëngshme ujore janë të njëjta ose më të ulëta sesa uji në hyrje. Përdoren vetëm lëndët ushqyese me origjinë bimore ose minerale, që përdoren në prodhimin organik, të përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, të ligjit.

Operatorët mbajnë të dhëna për përdorimin e këtyre produkteve, duke përfshirë datën ose datat e përdorimit, emrin e produktit dhe sasinë e përdorur, me informacionin për lotet, depozitat ose rezervuarët përkatës.

5. Operatorët mbajnë të dhëna për dendësinë e kulturave ose shpeshësinë e proceseve dhe ruajnë integritetin e mjedisit ujor, duke mos tejkaluar sasinë maksimale të algave që shkaktojnë ndikime negative në mjedis.

6. Litarët dhe pajisjet e tjera që përdoren për rritjen e algave ripërdoren ose riciklohen, kur është e mundur.

Neni 12

Masat kundër ndotjes dhe pastrimi i pajisjeve dhe mjediseve të prodhimit

1. Për parandalimin e sëmundjeve, organizmat ndotës të gjallë largohen vetëm me anë të mjeteve përkatëse ose me dorë dhe, kur është e përshtatshme, hidhen në det në distancë nga ferma.

2. Për pastrimin dhe dezinfektimin e pajisjeve dhe mjediseve përdoren vetëm substancat që përdoren në prodhimin organik, të përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, të ligjit.

Neni 13

Rregulla të veçanta për pastrimin dhe tharjen e algave

Algat thahen në mënyrë indirekte duke përdorur ajër të ngrohur ose mjete të tjera të përshtatshme, përfshirë tharëset që punojnë me propan, naftë dhe parafinë, por nuk duhet të ndoten me produktet e djegies së këtyre lëndëve. Për të siguruar djegie të plotë të këtyre lëndëve, zbatohet një program i rregullt i mirëmbajtjes. Për tharjen e algave përdoret vetëm vaj, i klasifikuar për qëllime tregtare.

Neni 14

Dokumentacioni financiar dhe regjistrat

1. Kur sistemi i kontrollit të algave të detit zbatohet për herë të parë, përshkrimi i plotë i njësisë së prodhimit organik, të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 44, të ligjit, përfshin:

a) një përshkrim të plotë të instalimeve në tokë dhe në det;

b) vlerësimin mjedisor, siç parashikohet në pikën 1, të nenit 5, të këtij udhëzimi;

c) planin e menaxhimit të qëndrueshëm, sipas pikës 2, të nenit 5, të këtij udhëzimi;

ç) për algat e egra të detit, përpilohet një përshkrim i plotë dhe një hartë e zonave të mbledhjes në breg dhe në det, dhe i zonave në tokë ku kryhen veprimtaritë pas mbledhjes.

2. Dokumentacioni financiar mbahet në njësinë ose stabilimentin e prodhimit, duke i mundësuar operatorit të identifikojë, si dhe trupës së kontrollit dhe autoritetit përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë të verifikojnë, që grumbulluesit kanë furnizuar vetëm alga të egra, të prodhuara në përputhje me ligjin dhe rregullat e këtij udhëzimi.

3. Të dhënat për prodhimin e algave të detit, mbahen nga operatori, në formën e një regjistri, gjatë të gjithë kohës në mjediset e fermës dhe i vendosen në dispozicion trupës së kontrollit dhe autoritetit përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë. Regjistri përmban të paktën informacionet e mëposhtme:

a) listën e specieve, datën dhe sasinë e vjelë;

b) datën e përdorimit, llojin dhe sasinë e plehëruesit të përdorur.

4. Për mbledhjen e algave të egra të detit, regjistri, gjithashtu, përmban:

a) historikun e veprimtarisë së vjeljes për secilën specie në shtretërit e caktuar;



b) parashikimin e prodhimit të vjeljes për sezon;
c) burimet e ndotjes së mundshme të shtretërve të vjeljes;

ç) rendimentin vjetor të qëndrueshëm, për secilin shtrat.

5. Nëse algat vilen nga një zonë e ndarë ose e përbashkët mbledhjeje, dokumentacioni i mbajtur nga operatori dhe trupa e kontrollit, tregon se vjelja e plotë është realizuar në përputhje me ligjin dhe rregullat e këtij udhëzimi.

KREU IV KËRKESAT PËR SPECIET E AKUAKULTURËS

Neni 15

Origjina dhe menaxhimi i specieve të akuakulturës

1. Për sa i përket origjinës së specieve të akuakulturës, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) akuakultura organike bazohet në rritjen e rasantit që ka origjinën nga materiali organik për shumim dhe njësitë e prodhimit organik;

b) përdoren specie indigjene dhe kultivimi synon prodhimin e llojeve që përshtaten më mirë me kushtet e prodhimit, për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e specieve, si dhe përdorim të mirë të burimeve të ushqimit për speciet e akuakulturës. Dokumentacioni lidhur me origjinën dhe trajtimin e tyre i vihen në dispozicion trupës së kontrollit ose autoritetit përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë;

c) zgjidhen speciet që janë rezistente dhe që prodhohen pa shkakuar dëme të konsiderueshme të popullatave të egra;

ç) për qëllime kultivimi, autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë, miraton përjashtimin për futjen në njësinë e prodhimit, të specieve të egra ose specieve të akuakulturës joorganike, kur nuk gjenden specie organike ose kur në njësinë e prodhimit futet popullatë e re gjenetike, për të përmirësuar qëndrueshmërinë gjenetike të popullatës. Këto specie mbahen në menaxhim organik, për të paktën tre muaj, përpara se të përdoren për kultivim.

Për speciet që janë pjesë e listës së kuqe, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin në zbatim të ligjit për mbrojtjen e biodiversitetit dhe mbështetur në kategorizimin e IUCN-së për speciet e rrezikuara, miratimi nga autoriteti përgjegjës për

kontrollin zyrtar në fermë për të përdorur specie të egra, jepet vetëm nëse ato nuk përfshihen në listën e kuqe. Miratimi për përdorimin e specieve të listës së kuqe mund të jepet vetëm në kuadër të programeve të ruajtjes, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës për ruajtjen e specieve të rrezikuara;

d) Për qëllim të rritjes së mëtejshme, autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë miraton përjashtimin për mbledhjen e rasantit të egër të akuakulturës, vetëm në rastet e mëposhtme:

i. hyrjes natyrale dhe rrjedhëse të larvave dhe rasateve të peshqve ose krustaceve gjatë mbushjes së pellgjeve, sistemeve të mbajtjes dhe zonave të mbyllura;

ii. ripërtëritjes të popullatës së rasantit të egër ose larvave të krustaceve për specie që nuk janë pjesë e listës së kuqe, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, në fermat e akuakulturës ekstensive, brenda zonave të ligatinave, të tilla si: pellgjet me ujë të kripur, zonat e baticës dhe lagunat bregdetare, me kushtin që:

- ripërtëritja e popullatës të jetë në përputhje me masat e menaxhimit të miratuara nga autoriteti përkatës për mjedisin, për të siguruar shfrytëzimin e qëndrueshëm të specieve në fjalë; dhe

- speciet të ushqehen vetëm me ushqim që gjendet natyrisht në mjedis.

3. Në përjashtim nga shkronja “a”, e pikës 1, të këtij neni, autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë, miraton përjashtimin për futjen për qëllime rritjeje të mëtejshme të specieve në një njësi prodhimi organik, deri në maksimumi 50% rasant joorganike të specieve të rritura në mënyrë jo organike, me kusht që, të paktën, dy të tretat e fundit të ciklit të prodhimit të menaxhohen në përputhje me rregullat e prodhimit organik. Ky përjashtim mund të jepet për një periudhë maksimale prej dy vitesh dhe nuk rinovohet.

4. Autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë miraton përjashtimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kur të dhënat në sistemin e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 24 të ligjit, tregojnë se nuk plotësohen nevojat cilësore ose sasiore të operatorit për rasant e peshkut organik.

5. Operatorët mbajnë të dhëna dhe dokumentacionin për origjinën e specieve, duke identifikuar speciet/grupet e specieve, datën e mbërritjes dhe llojin e specieve, sasinë, statusin organik ose joorganik dhe periudhën e kalimit.



6. Operatorët mbajnë dokumentacionin, për çdo përjashtim nga rregullat e prodhimit për speciet e akuakulturës, të miratuar në përputhje me pikën 1 dhe 2, të këtij neni, i cili i paraqitet trupës së kontrollit dhe autoritetin përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë.

7. Për miratimin e përjashtimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, operatori aplikon në portalin qeveritar *e-Albania*, në përputhje me pikën 6, të nenit 24, të ligjit.

Neni 16

Periudhat e kalimit për prodhimin e specieve të akuakulturës

Në njësitë e prodhimit të akuakulturës zbatohen periudhat e mëposhtme të kalimit, sipas llojeve të stabilimenteve të prodhimit të akuakulturës, përfshirë speciet ekzistuese të akuakulturës:

a) për stabilimentet që nuk kanë sistem kullimi dhe nuk pastrohen ose dezinfektohen, periudha e kalimit është 24 muaj;

b) për stabilimentet që kanë sistem kullimi ose nuk janë përdorur për një kohë, periudha e kalimit është 12 muaj;

c) për stabilimentet që kanë sistem kullimi dhe janë pastruar ose dezinfektuar, periudha e kalimit është 6 muaj;

ç) për stabilimentet e hapura ujore, përfshirë ato që kultivojnë molusqe bivalvë, periudha e kalimit është 3 muaj.

Neni 17

Praktikat e kultivimit dhe mirëqenies së specieve të akuakulturës

1. Për sa i përket praktikave të kultivimit dhe mirëqenies:

a) Të gjithë personat e përfshirë në kultivimin e specieve të akuakulturës duhet të kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme bazë, në lidhje me shëndetin dhe nevojat për mirëqenien e këtyre specieve;

b) Mjedisi i kultivimit të specieve të akuakulturës, është në përputhje me pikën 2, të këtij neni;

c) Për transportin e specieve të akuakulturës, merren masat e nevojshme për të minimizuar kohëzgjatjen e tij;

ç) Çdo vuajtje mbahet në minimum gjatë të gjithë jetës së specieve, përfshirë kohën e zënies.

2. Mjedisi i kultivimit të specieve të akuakulturës projektohet në përputhje me nevojat specifike të secilës specie dhe sigurohet që speciet e akuakulturës, të:

a) kenë hapësirë të mjaftueshme për mirëqenien e tyre dhe dendësinë përkatëse të popullatës, të parashikuar në nenet 22 dhe 26, të këtij udhëzimi;

b) mbahen në ujë me cilësi të mirë, duke përfshirë një shkallë të përshtatshme rrjedhjeje dhe qarkullimi, nivele të mjaftueshme oksigjeni dhe nivel të ulët të metabolitëve; dhe

c) mbahen në kushte temperature dhe ndriçimi, në përputhje me kërkesat e specieve dhe duke mbajtur parasysh vendndodhjen gjeografike;

ç) në rastin e peshqve të ujërave të ëmbla, lloji i tabanit të jetë sa më afër kushteve natyrale;

d) në rastin e krapit dhe specieve të ngjashme;

i. tabani të jetë prej dheu natyral;

ii. plehërimi organik dhe mineral i rezervuarëve dhe liqeneve kryhet vetëm me plehërues dhe përmirësues të tokës që përdoren në prodhimin organik të përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, të ligjit, me përdorim maksimal deri në 20 kg azot/ha;

iii. ndalohen trajtimet me kimikate sintetike për kontrollin e hidrofiteve dhe mbulesës bimore të pranishme në ujërat e prodhimit.

3. Operatorët mbajnë të dhëna dhe dokumentacionin për masat e monitorimit dhe mirëmbajtjes, lidhur me mirëqenien e specieve dhe cilësinë e ujit. Në rast plehërimi të rezervuarëve dhe liqeneve, operatorët mbajnë të dhëna dhe dokumentacionin për përdorimin e plehëruesve dhe përmirësuesve të tokës, përfshirë datën e përdorimit, emrin e produktit, sasinë e përdorur dhe vendndodhjen ku janë përdoruar substancat në fjalë.

4. Operatorët që prodhojnë specie të akuakulturës, respektojnë rregullat e hollësishme për speciet ose për grupet e specieve, të parashikuara në nenet 22 dhe 26, të këtij udhëzimi, në lidhje me dendësinë e popullatës dhe karakteristikat specifike të sistemeve të prodhimit dhe ruajtjes.

5. Në vlerësimin e ndikimit të dendësisë së popullatës në mirëqenien e peshqve të prodhuar, monitorohen dhe merren në konsideratë gjendja e peshqve, si: dëmtimi i pendëve, lëndime të tjera, norma e rritjes, sjellja dhe shëndeti në përgjithësi, si dhe cilësia e ujit.

6. Projektimi dhe ndërtimi i sistemeve të mbyllura për organizmat ujore siguron një shkallë rrjedhjeje të ujit dhe parametra fiziko-kimikë, që



sigurojnë shëndetin, mirëqenien e specieve dhe kushte për nevojat e tyre të rritjes.

7. Sistemet e mbyllura projektohen, vendosen dhe vihen në funksion që të minimizohet rreziku i daljes së papritur të specieve.

8. Nëse peshqit ose krustacet dalin papritur, ndërmerren veprime të përshtatshme për të reduktuar ndikimin në ekosistemin lokal, përfshirë rikapjen e tyre, dhe mbahen të dhëna lidhur me këto veprime.

9. Për prodhimin e karkalecave të llojit *penaeid* dhe karkalecave të ujërave të ëmbla, ndalohet heqja e indeve të syrit, përfshirë praktikën e tjera të ngjashme, si: lidhja, prerja dhe shtrëngimi.

Neni 18

Rregullat e veçanta për sistemet ujore të mbyllura

1. Objektet e mbyllura me riqarkullim të ujit, për prodhimin e specieve të akuakulturës, ndalohen, me përjashtim të inkubatorëve dhe qendrave të rritjes ose objekteve për prodhimin e specieve që përdoren si organizma për ushqim organik për kafshë.

2. Njësitë e rritjes në tokë përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) sistemet me rrjedhje të vazhdueshme lejojnë monitorimin dhe kontrollin e shkallës së rrjedhës dhe cilësinë e ujit që hyn dhe del;

b) të paktën 10% e perimetrit të zonës në sipërfaqen tokë–ujë të ketë bimësi natyrale.

3. Sistemet e mbyllura, të vendosura në det, përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) të vendosen në zona ku qarkullimi i ujit, thellësia dhe shkëmbimi i masës ujore janë të mjaftueshme për të minimizuar ndikimin në shtratin e detit dhe në trupin ujqor përreth;

b) të këtë projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje të përshtatshme të kafazeve, duke marrë parasysh ekspozimin e tyre ndaj kushteve të mjedisit ku ndodhen.

4. Ngrohja ose ftohja artificiale e ujit lejohet vetëm në inkubatorë dhe qendra rritjeje. Uji natyral nga shpime nëntokësore mund të përdoret për të ngrohur ose ftohur ujin, në të gjitha fazat e prodhimit.

Neni 19

Menaxhimi i specieve të akuakulturës

1. Trajtimi i specieve të akuakulturës duhet të minimizohet dhe kryhet me kujdes të madh dhe, për të shmangur stresin dhe dëmtimet fizike që lidhen me procedurat e trajtimit, përdoren pajisjet dhe protokollet e duhura.

Materiali organik për shumim trajtohet në mënyrë që të minimizohen dëmtimet fizike dhe stresi dhe, kur është e nevojshme, trajtimi kryhet nën anestezi. Veprimet e klasifikimit sipas madhësisë, reduktohen në minimum dhe kryhen vetëm kur janë të nevojshme për të siguruar mirëqenien e peshqve.

2. Për përdorimin e ndriçimit artificial zbatohen kufizimet e mëposhtme:

a) për zgjatje të ndriçimit natyral të ditës, nuk tejkalohet maksimumi që respekton nevojat etologjike, kushtet gjeografike dhe gjendjen e përgjithshme shëndetësore të specieve, deri në 14 orë në ditë, përveç rasteve kur nevojitet për qëllime riprodhimi;

b) ndryshimet e menjëhershme të intensitetit të dritës shmangen gjatë kalimit nga ndriçimi natyral tek ai artificial, nëpërmjet përdorimit të ndriçuesve me intensitet të rregullueshëm ose ndriçimit në sfond.

3. Ajrimi lejohet për të siguruar mirëqenien dhe shëndetin e specieve. Preferohet që ajruesit mekanikë të punojnë me burime të energjisë së rinovueshme.

4. Oksigjeni mund të përdoret vetëm për qëllime të mirëqenies dhe shëndetit të specieve, gjatë periudhave kritike të prodhimit dhe transportit, dhe vetëm në rastet e mëposhtme:

a) raste të jashtëzakonshme të rritjes së temperaturës, rënies së presionit atmosferik ose ndotjes aksidentale;

b) procedura rastësore të menaxhimit të popullatës, si marrja e mostrave dhe seleksionimi;

c) për të siguruar mbijetesën e popullatës në fermë.

5. Operatorët mbajnë të dhëna dhe dokumente për përdorimin e oksigjenit, për të treguar nëse përdoret sipas shkronjave “a”, “b” ose “c”, të pikës 4, të këtij neni.

6. Teknikat e përgatitjes duhet t'i vendosin peshqit menjëherë në gjendje të pavetëdijshme, të pandjeshëm ndaj dhimbjes. Veprimet përpara përgatitjes kryhen në mënyrë të tillë që të shmangen



lëndimet, duke ulur në maksimum nivelin e vuajtjes dhe stresit. Kur zgjidhen të përdoren metoda optimale të përgatitjes, merren parasysh diferencat në përmasat e vjeljes, midis specieve dhe zonave të prodhimit.

Neni 20 Shumimi

1. Për shumimin, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) për prodhimin artificial të llojeve njëseksuale (monoseks), nuk lejohet përdorimi i poliploidisë, hibridizimit artificial dhe klonimit, përveç seleksionimit manual;

b) zgjidhen lloje të përshtatshme.

2. Nuk përdoren hormone dhe derivate hormonesh.

Neni 21 Transporti i peshqve të gjallë

1. Peshqit e gjallë transportohen në depozita të përshtatshme me ujë të pastër, të cilat përmbushin nevojat e tyre fiziologjike, për sa i përket temperaturës dhe oksigjenit të tretur.

2. Përpara transportit të peshqve organikë dhe produkteve të tyre, depozitat pastrohen, dezinfektohen dhe shpëlahen tërësisht.

3. Gjatë transportit merren masa mbrojtëse për të ulur stresin dhe dendësia e popullatës nuk arrin në nivelin që është i dëmshëm për speciet.

4. Operatorët mbajnë të dhënat dhe dokumentacionin për veprimet e përmendura në pikat 1 deri në 3, të këtij neni.

Neni 22 Rregullat e veçanta për peshqit

Operatorët që prodhojnë peshq duhet të plotësojnë rregullat e detajuara për speciet ose grupet e specieve, të parashikuara në pjesën A, të aneksit I, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij udhëzimi, në lidhje me dendësinë e popullatës dhe karakteristikat specifike të sistemeve të prodhimit, përfshirë sistemet e mbyllura.

KREU V RREGULLAT E VEÇANTA PËR MOLUSQET

Neni 23 Zona e ritjes

1. Për sa i përket praktikave të ruajtjes dhe kultivimit, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) prodhimi mund të kryhet në të njëjtën zonë ujore me prodhimin organik të peshqve halorë dhe algave, në një sistem polikulture që dokumentohet në planin e menaxhimit të qëndrueshëm;

b) molusqet bivalvë mund të rriten në polikulturë së bashku me molusqet gastropodë (kërmijtë e detit).

2. Prodhimi organik i molusqeve bivalvë kryhet brenda zonave të rrethuara me shtylla, objekte pluskuese ose shënjes të tjerë të dukshëm, dhe, kur është e përshtatshme, të kufizohet me thasë rrjete, kafaze ose mjete të tjera artificiale.

3. Në fermat organike të molusqeve bivalve, rreziqet për speciet me interes për ruajtje duhet të minimizohen. Nëse përdoren rrjeta kundër grabitqarëve, ato duhet të projektohen në mënyrë që të mos shkaktojnë lëndimin e shpendëve zhytës.

Neni 24 Burimi i farës

1. Në lidhje me origjinën e farës, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) përdorimi i farës së egër nga jashtë kufijve të njësisë së prodhimit organik lejohet në rastin e molusqeve bivalvë, me kusht që të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për akuakulturën dhe të vijë nga:

i. shtretër që nuk i mbijetojnë kushteve atmosferike të dimrit ose nga tepricat mbi dendësinë e lejuar të popullatës; ose

ii. vendosja natyrale e larvave të molusqeve bivalve në kolektorë;

b) mbahen të dhëna të dokumentuara për mënyrën, vendin dhe kohën kur është mbledhur fara e egër, për të mundësuar gjurmueshmërinë në zonën e mbledhjes;

c) fara e egër mund të mbledhet vetëm pasi autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë ka dhënë miratimin për këtë përfundim.



2. Për speciet e llojit *Crassostrea gigas*, i jepet përparësi popullatës së përzgjedhur në mënyrë selektive, për të reduktuar shumimin në natyrë.

3. Për miratimin e përjashtimit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, operatori aplikon në portalin qeveritar *e-Albania*, në përputhje me pikën 6, të nenit 24 të ligjit.

Neni 25

Menaxhimi

1. Në prodhim e molusqeve bivalve organike përdoret një dendësi e popullatës që nuk e kalon atë të përdorur në molusqet joorganike në të njëjtën zonë. Seleksionimi, rrallimi dhe rregullimi i dendësisë së popullatës kryhen në përputhje me biomasën dhe për të siguruar mirëqenien e specieve dhe cilësi të lartë të produktit.

2. Organizmat ndotës të gjallë largohen me anë të mjeteve fizike ose me dorë, dhe, kur është e përshtatshme, kthehen në det larg fermave të molusqeve. Molusqet mund të trajtohen vetëm një herë gjatë ciklit të prodhimit, me tretësirë gëlqerore, për të kontrolluar praninë e organizmave të tjerë ndotës.

Neni 26

Rregullat e kultivimit

1. Operatorët që prodhojnë specie të akuakulturës zbatojnë rregullat e detajuara për speciet ose për grupet e specieve, të parashikuara në pjesën B, të aneksit I të këtij udhëzimi, në lidhje me dendësinë e popullatës dhe karakteristikat specifike të sistemeve të prodhimit dhe sistemeve të mbyllura.

2. Në prodhimin organik mund të përdoret kultivimi në litarët e midhjeve dhe metoda të tjera sipas pjesës B, të aneksit I, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

3. Kultivimi në thellësi i molusqeve lejohet vetëm kur nuk shkakton ndikim të konsiderueshëm mjedisor në zonat e mbledhjes dhe rritjes.

4. Në planin e menaxhimit të qëndrueshëm sipas pikës 2, të nenit 5, të këtij udhëzimi, përfshihet një seksion i veçantë, i cili përmban një studim dhe raport vlerësimi të ndikimit në mjedis, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, që vlerëson ndikimin mjedisor minimal, të cilin operatori ja paraqet trupës së kontrollit, përpara fillimit të veprimtarisë.

Neni 27

Rregullat e veçanta të kultivimit të molusqeve ostrika

Lejohet kultivimi në thasë mbi platforma të ngritura. Këto ose struktura të tjera, në të cilat mbahen molusqet ostrika, vendosen në mënyrë të tillë që të shmanget formimi i një barriere të plotë përgjatë vijës bregdetare. Popullata vendoset me kujdes mbi shtretër në drejtime me rrjedhën e baticës, për të optimizuar prodhimin. Prodhimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në pikën 1, të nenit 26, të këtij udhëzimi.

KREU VI

USHQIMI PËR PESHQIT, KRUSTACET DHE EKinODERMËT

Neni 28

Rregulla të përgjithshme për ushqimin për speciet e akuakultuës

1. Për ushqimin për peshqit, krustacet dhe ekinodermët, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) speciet ushqehen me ushqim që përmbush kërkesat e ushqyerjes së këtyre specieve, në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre;

b) regjimi ushqimor përputhet me pikën 2, të këtij neni;

c) pjesa bimore e ushqimit është organik dhe pjesa e ushqimit që vjen nga specie ujore ka origjinë nga akuakultura organike ose ferment e qëndrueshme të peshkut, të certifikuara sipas standardeve të peshkimit të qëndrueshëm;

ç) lëndët e para për ushqim për kafshë joorganike, me origjinë bimore, shtazore, nga algat ose majatë, apo si lëndë e parë për ushqim për kafshë me origjinë minerale ose mikrobike përdoren vetëm në përputhje me pikën 4, të nenit 21, të ligjit;

d) aditivët e ushqimit për speciet dhe lëndët ndihmëse për përpunimin përdoren në përputhje me pikën 3, të nenit 22, të ligjit;

dh) nuk përdoren substanca që nxitin rritjen dhe aminoacidet sintetike.

2. Regjimet ushqimore përcaktohen duke marrë parasysh, si më poshtë:

a) shëndetin dhe mirëqenien e specieve;

b) cilësinë e lartë të produktit, përfshirë përbërjen ushqimore të produktit, që siguron cilësi të lartë të produktit përfundimtar për konsum;



c) ndikimin e ulët në mjedis.

3. Për molusqet bivalvë dhe specie të tjera, që nuk ushqehen artificialisht, por me plankton natyral, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) speciet filtruese marrin të gjitha nevojat ushqimore nga mjedisi natyror, përveç rasteve kur ato rriten në inkubatorë ose qendra të rritjes, të cilat përjashtohen nga ky parashikim;

b) zonat e rritjes janë të përshtatshme nga pikëpamja shëndetësore, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të ligjit.

Neni 29

Rregulla të veçanta të ushqimit për speciet mishngrënëse të akuakulturës

Ushqimi për speciet mishngrënëse të akuakulturës sigurohet sipas rendit të mëposhtëm të prioritetëve:

1. Ushqim organik për kafshë me origjinë nga akuakultura;

2. Miell peshku dhe vaj peshku nga mbetjet e akuakulturës organike, të siguruar nga peshq, krustace apo molusqe;

3. Miell peshku, vaj peshku dhe lëndë ushqyese me origjinë nga peshku, të përfuara nga mbetjet e peshqve, krustacëve ose molusqeve, të kapur në ferma të qëndrueshme peshkimi për konsum njerëzor;

4. Lëndët e para për ushqim organik për kafshë, me origjinë bimore dhe shtazore;

5. Miell peshku, vaj peshku dhe lëndë e parë për ushqim për kafshë, me origjinë nga peshku, të përfuara nga peshq, krustace ose molusqe të kapur në ferma të qëndrueshme peshkimi dhe që nuk përdoren për konsum njerëzor.

Neni 30

Rregulla të veçanta për ushqimin për kafshë për specie të caktuara të akuakulturës

1. Në fazën e rritjes, peshqit në ujërat e brendshme, karkalecat *penaeid*, karkalecat e ujërave të ëmbla dhe peshqit tropikalë të ujërave të ëmbla ushqehen, si më poshtë:

a) me ushqim për kafshë që gjendet në mënyrë natyrale në rezervuarë dhe liqene;

b) kur ushqimi, sipas shkronjën “a” të kësaj pike, nuk gjendet në sasi të mjaftueshme, përdoret ushqim organik për kafshë, me origjinë bimore,

mundësisht i rritur nga vetë ferma ose mund të përdoren algat. Operatorët mbajnë të dhëna të dokumentuara lidhur me nevojën për të përdorur ushqim për kafshë shtesë;

c) kur ushqimi natyral për kafshë është plotësuar në përputhje me shkronjën “b” të kësaj pike:

i. racioni ushqimor për karkalecat e llojit *penaeid* dhe karkalecat e ujërave të ëmbla (*Macrobrachium spp.*) mund të përmbajë maksimumi 25 % miell peshku dhe 10 % vaj peshku, të përfuara nga ferma të qëndrueshme peshkimi;

ii. racioni ushqimor për mustakun siamez (*Pangasius spp.*) mund të përmbajë maksimumi 10% miell peshku ose vaj peshku, të përfuara nga ferma të qëndrueshme peshkimi.

2. Në fazën e rritjes dhe në fazat e hershme të jetës në inkubatorë dhe qendra rritjeje, mund të përdoret kolesterol organik si shtesë në dietat e karkalecave *penaeid* dhe të karkalecave të ujërave të ëmbla (*Macrobrachium spp.*), për të plotësuar nevojat e tyre sasiore të dietës.

Neni 31

Mbajtja e të dhënave për ushqyerjen e specieve të akuakulturës

Operatorët mbajnë të dhëna për regjimet e veçanta të ushqyerjes, veçanërisht lidhur me emrin, sasinë e ushqimit dhe përdorimin e ushqimit për kafshë shtesë, si dhe për speciet ose grupet përkatëse të specieve të ushqyera.

Neni 32

Prodhimi i rasatit

1. Për rritjen e larvave të specieve detare të peshqve, mund të përdoren sistemet e rritjes në veçanti “rezervuar i madh” ose “sisteme me ujë me vëllim të madh”.

2. Sistemet e rritjes sipas pikës 1, të këtij neni, përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) dendësia fillestare e popullatës është nën 20 vezë ose larva për litër;

b) depozita e rritjes së larvave ka një vëllim prej të paktën 20 m³;

c) larvat ushqehen me plankton natyral që zhvillohet në depozitë, duke u plotësuar kur është e nevojshme me fitoplankton dhe zooplankton të prodhuar jashtë fermës.



KREU VII
PARANDALIMI I SËMUNDJEVE DHE
TRAJTIMI VETERINAR

Neni 33
Parandalimi i sëmundjeve

1. Për parandalimin e sëmundjeve, zbatohen rregullat si më poshtë:

a) Parandalimi i sëmundjeve bazohet në mbajtjen e specieve në kushte optimale, nëpërmjet vendosjes së përshtatshme, duke marrë parasysh, ndër të tjera, kërkesat e specieve për qarkullimin dhe shkëmbimin e ujit të cilësisë së mirë, projektimin optimal të fermave, zbatimin e praktikave të mira të kultivimit dhe menaxhimit, përfshirë pastrimin dhe dezinfektimin e rregullt të mjediseve, ushqimin me cilësi të lartë, dendësinë e duhur të popullatës, si dhe përzgjedhjen e llojit dhe racës;

b) Sëmundjet trajtohen menjëherë për të shmangur vuajtjen e specieve. Nën përgjegjësinë e një veterineri mund të përdoren produktet alopatiche mjekësore veterinarë të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët, kur përdorimi i produkteve fitoterapeutike, homeopatike e të tjera nuk është i mundur. Kur është e mundur, përcaktohen kufizime për kohëzgjatjen e trajtimit mjekësor dhe periudhën e kalimit;

c) Mund të përdoren medikamente veterinarë imunologjike;

ç) Lejohen trajtimet që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin veterinar.

2. Plani i menaxhimit të shëndetit të specieve përmban praktikën e biosigurisë dhe parandalimit të sëmundjeve, përfshirë një marrëveshje me shkrim për këshillim mbi shëndetin, në proporcion me njësinë e prodhimit, me veterinerë të kualifikuar për akuakulturën, të cilët kryejnë kontroll në fermë, jo më pak se një herë në vit ose, në rastin e molusqeve bivalvë, jo më pak se një herë në dy vjet.

3. Sistemet, pajisjet dhe mjetet e fermës, pastrohen dhe dezinfektohen në mënyrën e duhur.

4. Për pastrimin dhe dezinfektimin e rezervuarëve, kafazeve, depozitave, kanaleve, ndërtesave dhe instalimeve që përdoren për prodhimin shtazor, përdoren vetëm produktet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, të ligjit.

5. Për ndërprerjen e përkohshme të një zone të kultivimit, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) trupa e kontrollit përcakton nëse ndërprerja është e nevojshme, duke përcaktuar kohëzgjatjen e duhur, e cila zbatohet dhe dokumentohet pas çdo cikli prodhimi në sistemet e mbyllura në ujërat e hapura në det;

b) nuk është e detyrueshme për kultivimin e molusqeve bivalvë;

c) gjatë ndërprerjes së kultivimit, kafazet ose strukturat e tjera për prodhimin e specieve të akuakulturës zbrazen, dezinfektohen dhe lihen bosh përpara se të përdoren sërish.

6. Për të shmangur çdo rrezik për dëme të konsiderueshme mjedisore në cilësinë e ujit, minimizuar riskun për sëmundje dhe shmangur tërheqjen e insekteve ose brejtësve, ushqimi i pakonsumuar i peshqve, jashtëqitjet dhe speciet e ngordhura, duhet të largohen menjëherë.

7. Ndriçimi ultraviolet dhe ozoni mund të përdoren vetëm në inkubatorë dhe qendra rritjeje.

8. Për kontrollin biologjik të ektoparazitëve, i jepet përparësi përdorimit të peshqve pastrues dhe përdorimit të ujit të ëmbël, ujit të detit dhe tretësirave të klorur natriumit.

Neni 34
Trajtimet veterinarë

1. Kur shfaqet një problem shëndetësor, pavarësisht masave parandaluese për të siguruar shëndetin e kafshëve, siç përcaktohet në nenin 33 të këtij udhëzimi, përdoren trajtime veterinarë si më poshtë:

a) substanca me origjinë bimë, shtazore ose minerale në një tretësirë homeopatike;

b) bimët dhe ekstraktet e tyre që nuk kanë efekte anestetike; dhe

c) substanca të tilla si elemente gjurmë, metale, imunostimulantë natyrorë ose probiotikë të lejuar.

2. Përdorimi i trajtimeve alopatiche kufizohet në dy kura trajtimi në vit, me përjashtim të vaksinimeve dhe skemave të detyrueshme të çrrënjësjes. Megjithatë, në raste të ciklit të prodhimit më të shkurtër se një vit, përdoret vetëm një trajtim alopatic. Nëse tejkalohen kufizimet e përcaktuara për trajtimet alopatiche, këto specie të akuakulturës nuk vendosen në treg si produkte organike.

3. Përdorimi i trajtimeve kundër parazitëve, të ndryshme nga skemat e detyrueshme të kontrollit që përdoren nga autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë, kufizohet si më poshtë:



a) për salmonin, maksimumi deri në dy kura trajtimi në vit ose një kurë trajtimi në vit, kur cikli i prodhimit është më pak se 18 muaj;

b) për të gjitha speciet, përveç salmonit, dy kura trajtimi në vit ose një kurë trajtimi në vit, kur cikli i prodhimit është më pak se 12 muaj;

c) për të gjitha speciet, jo më shumë se katër kura trajtimi në total, pavarësisht kohëzgjatjes së ciklit të prodhimit të specieve.

4. Koha e pezullimit ndërmjet përdorimit të fundit të produkteve alopatiche mjekësore veterinare të sintetizuara kimikisht, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, përfshirë trajtimet sipas skemave të detyrueshme të kontrollit dhe çrrënjësjes, është dyfishi i kohës së pezullimit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për shërbimin veterinar dhe është të paktën 48 orë.

5. Përveçse kur produkti mjekësor i përdorur tregon kohën e pezullimit për speciet në fjalë, koha e pezullimit nuk është më pak se 1000 ditë-gradë për mishin e peshkut.

6. Çdo përdorim i produkteve mjekësore veterinare deklarohet te trupa e kontrollit përpara se speciet të tregtohen si organike dhe popullata e trajtuar është qartësisht e identifikueshme.

Neni 35

Mbajtja e dhënave për parandalimin e sëmundjeve dhe kujdesin veterinar

1. Operatorët mbajnë të dhëna dhe/ose regjistra për masat e zbatuara për parandalimin e sëmundjeve, duke specifikuar ndërprerjen e prodhimit, pastrimin dhe trajtimin e ujit dhe çdo trajtim veterinar dhe trajtime të tjera parazitësh të marra dhe, në veçanti, datën e trajtimit, diagnozën, dozën, emrin e produktit të trajtimit dhe recetën veterinare për kujdesin veterinar, dhe kohën e pezullimit të zbatuar përpara se produktet e akuakulturës të tregtohen dhe etiketohen si organike.

2. Produktet alopatiche mjekësore veterinare, përfshirë antibiotikët, mund të ruhen në ferma bujqësore me kusht që të jenë lëshuar me recetë nga një mjek veterinar, për trajtimin e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 33, të këtij udhëzimi, ruhen në një vend të mbikëqyrur dhe shënohen në regjistrin e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

Neni 36

Dokumentacioni financiar dhe regjistrat

1. Të dhënat dhe dokumentacioni financiar mbahen në formën e një regjistri gjatë të gjithë kohës në mjediset e fermës, të cilat i paraqiten trupës së kontrollit dhe autoritetin përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë.

2. Të dhënat dhe dokumentacioni përfshijnë të gjithë informacionin e vlefshëm, në lidhje me:

a) origjinën, datën e mbërritjes dhe periudhën e kalimit të specieve që arrijnë në fermë, në përputhje me pikën 4, të nenit 15 të këtij udhëzimi;

b) numrin e loteve, moshën, peshën dhe destinacionin e specieve që largohen nga ferma;

c) llojin dhe sasinë e ushqimit, dhe në rastin e krapit dhe specieve të ngjashme një dokument për përdorimin e ushqimit shtesë, në përputhje me nenin 31, të këtij udhëzimi;

ç) trajtimet veterinare, duke dhënë hollësi për qëllimin, datën dhe metodën e aplikimit, llojin e produktit dhe kohën e pezullimit, në përputhje me nenin 34, të këtij udhëzimi;

d) masat për parandalimin e sëmundjeve, duke dhënë detaje për ndërprerjen e prodhimit, pastrimin dhe trajtimin e ujit në përputhje me nenin 34, të këtij udhëzimi;

dh) përjashtimet në përputhje me pikën 1, të nenit 15, të këtij udhëzimi.

3. Të dhënat shtesë për akuakulturën, në lidhje me:

a) vlerësimin e ndikimit në mjedis, që rishikohet të paktën çdo vit, në përputhje me pikën 1, të nenit 5, të këtij udhëzimi;

b) planin e menaxhimit të qëndrueshëm, që rishikohet të paktën çdo vit, në përputhje me nenin pikën 2, të nenit 5, të këtij udhëzimi;

c) masat mbrojtëse dhe parandaluese të marra kundër grabitqarëve, në përputhje me legjislacionin për shërbimin veterinar, që regjistrohen në planin e menaxhimit të qëndrueshëm, në përputhje me pikën 4, të nenit 5, të këtij udhëzimi;

ç) koordinimin me operatorët fqinj për hartimin e planit të tyre të menaxhimit, në përputhje me pikën 5, të nenit 5, të këtij udhëzimi;

d) monitorimin e mbetjeve të lëngshme që kryhet në intervale të rregullta, në përputhje me nenin 7, të këtij udhëzimi;

dh) dokumentacionin për origjinën dhe trajtimin e specieve indigjene, si dhe për proceset e



përzgjedhjes për shumim, që synon krijimin e llojeve më të përshtatshme për kushtet e prodhimit, mirëqenien dhe shfrytëzim të mirë të burimeve ushqimore, në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 15, të këtij udhëzimi;

e) monitorimi i gjendjes së peshqve, si: dëmtimi i pendëve, lëndime të tjera, normat e rritjes, sjellja dhe shëndeti në përgjithësi, si dhe monitorimi i cilësisë së ujërave, në përputhje me pikën 5, të nenit 17, të këtij udhëzimi;

ë) veprimet e ndërmarra për të reduktuar ndikimin tek ekosistemi lokal nëse peshqit ose krustacet dalin papritur, në përputhje me pikën 8, të nenit 17, të këtij udhëzimi;

f) përdorimin e oksigjenit, në përputhje me pikën 5, të nenit 19, të këtij udhëzimi;

g) transportin e peshqve të gjallë, në përputhje me pikën 4, të nenit 21, të këtij udhëzimi;

gj) mbledhjen e farës së egër, që mundëson gjurmueshmërinë në zonën e mbledhjes, në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 24 të këtij udhëzimi;

h) të dhëna të dokumentuara për ndikimin minimal në mjedis, mbështetur nga një studim dhe raport vlerësimi për zonën e shfrytëzuar. Raporti përfshihet në një seksion të veçantë në planin e menaxhimit të qëndrueshëm sipas shkronjës “b” të kësaj pike, në përputhje me pikën 3, të nenit 26 të këtij udhëzimi;

i) planin e menaxhimit të shëndetit të specieve, në përputhje me pikën 2, të nenit 33, të këtij udhëzimi.

KREU VIII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 37

Dispozita kalimtare

Përfshirimi i parashikuar në pikën 2, të nenit 15 të këtij udhëzimi, zbatohet deri më 1 janar 2030.

Neni 38

Dispozitat e fundit

Ngarkohen Drejtoria e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, trupat e kontrollit dhe autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar në fermë dhe të ushqimit, dhe ushqimit për kafshë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet në datën 29 tetor 2026.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

ANEKS I

Pjesa A: Rregullat e detajuara për speciet ose për grupet e specieve, sipas nenit 22 të këtij udhëzimi, në lidhje me dendësinë e popullatës dhe karakteristikat specifike të sistemeve të prodhimit dhe sistemeve të ruajtjes:

1. Prodhimi organik i salmonideve në ujëra të ëmbla: trofta e murrme (*Salmo trutta*) – trofta ylber (*Oncorhynchus mykiss*) – trofta amerikane e përrenjve (*Salvelinus fontinalis*) – salmoni (*Salmo salar*) – Trofta alpine (*Salvelinus alpinus*) – losa (*Thymallus thymallus*) – trofta amerikane e liqenit (ose trofta gri) (*Salvelinus namaycush*) – salmoni i Danubit (*Hucho hucho*):

Sistemi i prodhimit	Sistemet e fermave të rritjes furnizohen nga sisteme të hapura. Norma e rrjedhës siguron minimalisht 60% ngopje me oksigjen për popullatën dhe siguron mirëqenien e tyre dhe eliminimin e mbetjeve të lëngëta të fermës.
Dendësia maksimale e popullatës	Speciet e salmonidit që nuk listohen më poshtë, 15 kg/m ³ , salmoni 20 kg/m ³ , trofta e murrme dhe trofta ylber 25 kg/m ³ , trofta alpine 25 kg/m ³



2. Prodhimi organik i *salmonideve* në ujëra detare: Salmon (*Salmo salar*), troftë e murrme (*Salmo trutta*) – troftë ylber (*Oncorhynchus mykiss*):

Dendësia maksimale e popullatës	10 kg/m ³ në rrjeta lundruese
---------------------------------	--

3. Prodhimi organik i *merlucit* (*Gadus morhua*) dhe llojeve të tjera të familjes Gadidae, levrekut të detit (*Dicentrarchus labrax*), spalçës së detit (*Sparus aurata*), orlit të detit (*Argyrosomus regius*), shkotrës (*Psetta maxima* [= *Scophthalmus maximus*]), pagrit të kuq (*Pagrus pagrus* [= *Sparus pagrus*]), korbit të kuq (*Sciaenops ocellatus*) dhe llojeve të tjera të familjes Sparidae, dhe kurrizgjëmborit (*Siganus spp.*):

Sistemi i prodhimit	Në sisteme ujore të hapura të ruajtjes (rrjeta lundruese/kafaze rrjete) me shpejtësi minimale të rrymës së ujit, për të siguruar mirëqenien optimale të peshqve ose në sisteme të hapura në tokë.
Dendësia maksimale e popullatës	Për peshq të ndryshëm nga shkotra: 15 kg/m ³ Për shkotrën: 25 kg/m ²

4. Prodhimi organik i *levrekut të detit*, *spalçës së detit*, *orlit të detit*, *qefullit* (*Liza*, Mugil) dhe ngjalës (*Anguilla spp.*) në rezervuarë në tokë me zona baticash dhe në laguna bregdetare:

Sistemi i ruajtjes	Basenet tradicionale të kripura të transformuar në njësi prodhimi të akuakulturës dhe rezervuarë të ngjashëm në tokë në zona baticash.
Sistemi i prodhimit	Duhet të bëhet ndërrimi i duhur i ujit për të siguruar mirëqenien e specieve të paktën 50% e argjinaturave (digave), duhet të kenë mbulesë bimore. Kërkohen rezervuarë pastrimi në ligatina.
Dendësia maksimale e popullatës	4 kg/m ³

5. Prodhimi organik i llojit *blini* në ujëra të ëmbla:

Speciet me interes: Familja *Acipenser*:

Sistemi i prodhimit	Rrjedha ujore në çdo njësi rritjeje është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e kafshëve. Uji në dalje të ketë të njëjtën cilësi si uji në hyrje.
Dendësia maksimale e popullatës	30 kg/m ³

6. Prodhimi organik i peshkut në ujëra të brendshme:

Speciet me interes: Familja e *krapit* (*Cyprinidae*) dhe speciet e tjera përkatëse në kontekstin e polikulturës, përfshirë *sharmakun*, *peshkun heshtë*, *mustakun*, *coregonids* (lloje salmoni) dhe blinin Sturgeon . Sharmaku (*Perca fluviatilis*) në monokulturë:

Sistemi i prodhimit	Në rezervuarë peshqish, që duhet të kullohen plotësisht dhe periodikisht dhe në liqene. Liqenet duhet të përdoren vetëm për prodhimin organik, përfshirë rritjen e kulturave bujqësore në zona të thata. Zona e kapjes së peshqve të jetë e pajisur me një burim uji të pastër dhe të ketë një përmasë të tillë që siguron komfortin optimal për peshqit. Peshqit mbahen në ujë të pastër pas mbledhjes. Përreth njësive ujore të brendshme si zonë tampon për zonat e jashtme tokësore që nuk përfshihen në veprimtarinë e fermës, krijohen zona me bimësi natyrore, në përputhje me rregullat e akuakulturës organike. Për të rriturit, përdoret polikultura, me kushtin që të zbatohen kriteret e përcaktuara në specifikimet për speciet e tjera të peshqve të liqenit.
Rendimenti i fermës	Prodhimi total i specieve kufizohet në 1,500 kg peshk për hektar në vit, parashikuar si rendiment ferme për shkak të karakteristikave specifike të sistemit të prodhimit
Dendësia maksimale e popullatës për <i>sharmakun</i> në monokulturë	20 kg/m ³

7. Prodhimi organik i *gaforres/ karavidhes*:

Speciet me interes: *Astacus astacus*:

Dendësia maksimale e popullatës	Për karavidhet e vogla (< 20 mm): 100 individë për m ² ; Për karavidhe mesatare (20-50 mm): 30 individë për m ² ; Për karavidhe të rritura (> 50 mm): 5 individë për m ² me kushtin që të ketë në dispozicion vende të duhura fshehjeje.
---------------------------------	---



8. Peshqit e ujërave të ëmbla tropikale: peshku i qumështit (*Chanos chanos*), tilapia (*Oreochromis spp.*), mustaku siamez (*Pangasius spp.*):

Sistemi i prodhimit	Rezervuarët dhe kafazet me rrjetë
Dendësia maksimale e popullatës	<i>Pangasius</i> : 10 kg/m ³ ; <i>Oreochromis</i> : 20 kg/m ³ .

Pjesa B: Rregullat e detajuara për speciet ose për grupet e specieve, sipas nenit 26, të këtij udhëzimi, në lidhje me dendësinë e popullatës dhe karakteristikat specifike të sistemeve të prodhimit dhe sistemeve të ruajtjes:

Molusqet dhe ekinodermët:

Sistemet e prodhimit	Linja të gjata, platforma pluskuese, kulturë fundore, thasë rrjetë, kafaze, tezgja, rrjeta në formë fanari, shtylla bouchot dhe sisteme të tjera kufizuese. Për kultivimin e midhjeve në platforma pluskuese, numri i litarëve të varur nuk kalon një për metër katror. Gjatësia maksimale e litarit të varur nuk i kalon 20 metra. Hollimi i litarëve të varur nuk duhet të ndodhë gjatë ciklit të prodhimit, por litarët e varur mund të ndahen pa e rritur dendësinë e popullatës.
----------------------	---

VENDIM
Nr. 40, datë 26.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 26.3.2026
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 16 (E) 2025 të Regjistrat
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Evis Berberi, përfaqësuar nga
avokatët Elda Zotaj dhe Gentjan Rumano, me
prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe
Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori
Dritan Prençi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 21, datë
13.3.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së
Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr.
27, datë 16.3.2024, të Gjykatës së Posaçme të
Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar; nr. 16, datë 25.4.2024, të Gjykatës së
Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e
Organizuar; nr. 00-2024-1690, datë 17.10.2024, të
Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të
papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së
Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin
Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 15, 17, 18, 27,
29, 31, 32, 38, 42, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134,
pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së
Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6, 7, 10, 14 dhe 18 të
Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
(*KEDNJ*); nenet 27, 32 dhe 71/a të ligjit nr. 8577,
datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin
e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së
Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, mori
në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Evis Berberi
(*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës,
prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së
Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të
Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar
rrezimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në
tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme, pas referimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), në datën 29.9.2023 ka regjistruar procedimin penal nr. 214/2023 për veprën penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal (KP), pa regjistruar emrin e ndonjë personi nën hetim. Në vijim, në datën 5.3.2024, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar edhe veprat penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 244 e 25, 259 dhe 287/2 të KP-së. Për këto dy të fundit në regjister është shënuar edhe emri i kërkuesit, si person i dyshuar për kryerjen e tyre.

2. Konkretisht, nga Prokuroria e Posaçme, bazuar në provat e grumbulluara gjatë hetimit, është ngritur dyshimi se kërkuesi, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës së drejtuesit të Agjencisë së Eficiencës së Energjisë (AEE) dhe, më pas, të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), ka kërkuar, ka pranuar dhe ka marrë në mënyrë të tërthortë nga një shoqëri tregtare (shoqëria “N.”) përfitime të parregullta monetare nëpërmjet një shoqërie tjetër tregtare të kontrolluar prej tij (shoqëria “D.”). Marrja e përfitimeve të parregullta ka ndodhur pas fitimit prej shoqërisë “N.” të procedurave të prokurimit publik të zhvilluara nga autoritetet publike kontraktore, titullar i të cilave ka qenë kërkuesi, të cilit, më pas, i kanë kaluar vlerat monetare përmes transaksioneve të kësaj shoqërie me shoqërinë “D.”, të zotëruar nga ai indirekt. Në vijim, vlerat monetare të përfituara në mënyrë të parregullt janë investuar për blerjen e pasurive të paluajtshme në emër të shoqërisë “D.”, të cilat përbëjnë edhe produkte të veprës penale.

3. Në lidhje me këtë, sipas Prokurorisë së Posaçme, ka dyshime të bazuara në prova se gjatë kryerjes së detyrave publike në fjalë kërkuesi ka përdorur dhe vazhdon të përdorë dy shoqëritë tregtare për të përfituar në mënyrë të paligjshme interesa financiarë prej tyre, përmes shtetasit V.B., i

cili është në marrëdhënie shoqërore me të dhe shërben si lidhje mes tij dhe shoqërive tregtare në fjalë. Këto shoqëri janë krijuar nga shtetasi V.B., në gusht dhe tetor të vitit 2017, dhe kërkuesi në regjistrat tatimorë shfaqet si i punësuar në to, në periudha të ndryshme. Ndërsa për shoqërinë “N.” shtetasi V.B. ka vijuar të jetë ortak i vetëm dhe administrator, për shoqërinë “D.”, sipas të dhënave të regjistratit tregtar, kuotat e saj në datën 7.9.2018 i janë shitur kërkuesit për çmimin 100.000 lekë. Në datën 31.1.2019 kërkuesi ia ka shitur kuotat e kësaj shoqërie shtetasit B.B., në marrëdhënie shoqërore me bashkëshorten e tij, për çmimin 500.000 euro, kurse në datën 23.12.2021, kjo e fundit ia ka shitur ato shtetasit V.B. për çmimin 200.000.000 lekë. Dy muaj më pas, në datën 21.2.2022, kuotat e shoqërisë i janë shitur shtetasit E.L. për të njëjtin çmim dhe, pak më shumë se një muaj më pas, në datën 29.3.2022, ato i janë rishitur sërish shtetasit V.B. për çmimin 0 lekë. Të gjitha këto transaksione, sipas Prokurorisë së Posaçme, janë fiktive, me qëllim për të mbuluar faktin e zotërimit nga kërkuesi të kësaj shoqërie, si dhe përfitimin nga ai, përmes kësaj shoqërie, të përfitimeve të parregullta dhe ligjërimin e tyre.

4. Kështu, sipas Prokurorisë së Posaçme, gjatë kohës kur kërkuesi ka ushtruar detyrën e drejtuesit të AEE-së, në vitet 2019-2021, shoqëria “N.” ka deklaruar fatura tatimore shitjeje, duke përfituar nga AEE-ja të ardhura në shumën 85,756,654 lekë. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, në vitin 2020, kjo shoqëri është shpallur fituese në tri procedura prokurimi publik të zhvilluara nga AEE-ja, për një vlerë totale 137,400,000 lekë, pa TVSH. Ndërkohë, gjatë kohës kur kërkuesi ka ushtruar detyrën e drejtorit të përgjithshëm të ARRSH-së, gjatë viteve 2021 dhe 2022, shoqëria “N.” është shpallur fituese në tri procedura prokurimi publik të zhvilluara nga ARRSH-ja, për vlerën totale 101,811,343.88 lekë, pa TVSH. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe, deri në datën 4.12.2023, referuar të dhënave të regjistrave tatimorë, ka rezultuar se shoqëria “D.” ka deklaruar fatura tatimore shitjeje në drejtim të shoqërisë “N.” në vlerën totale 223,480,476 lekë, si dhe fatura tatimore për blerjen nga shoqëria “N.” në vlerën totale 7,655,000 lekë.

5. Po ashtu, nga të dhënat e dokumenteve bankare, për shoqërinë “D.” ka pasur të drejtë veprimi në llogaritë bankare edhe kërkuesi, i cili ka veprime edhe gjatë kohës kur formalisht nuk kishte



lidhje me këtë shoqëri. Gjithashtu, për shoqërinë “N.” ka pasur të drejtë për të kryer veprime në llogarinë e saj bankare edhe motra e kërkuesit. Ka rezultuar gjithashtu se shoqëria “D.” ka bërë disa pagesa për faturat telefonike për numrin celular në përdorim të kërkuesit. Nga përmbajtja e telefonave celularë të sekuestruar personave ndaj të cilëve zhvillohen hetime, përfshirë edhe kërkuesin, kanë rezultuar komunikime për procedura prokurimi publik dhe veprime bankare mes shtetasve V.B., V.L. dhe B.B., por edhe mes shtetasve V.B. dhe V.L. me kërkuesin. Së fundi, ka rezultuar se dy shoqëritë në fjalë janë bashkëpronare në pesë pasuri të paluajtshme, të ndodhura në Tiranë.

6. Pas kërkesës së Prokurorisë së Posaçme të datës 7.3.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 21, datë 13.3.2024, ndër të tjera, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në burg”. Kjo masë sigurimi personal është ekzekutuar po në datën 13.3.2024, ora 21:30.

7. Në datën 14.3.2024 Prokuroria e Posaçme ka kërkuar verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal edhe ndaj kërkuesit në zbatim të nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Seanca gjyqësore për marrjen në pyetje edhe të kërkuesit të arrestuar është caktuar për në datën 15.3.2024. Në këtë seancë mbrojtësit e të arrestuarve, përfshirë edhe të kërkuesit, kanë kërkuar kohë për t’u njohur me aktet e paraqitura nga Prokuroria e Posaçme për caktimin e masës së sigurimit personal. Gjyqtari i hetimeve paraprake ka pranuar kërkesën dhe seanca është shtyrë për në datën 16.3.2024, në përfundim të së cilës, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 27, ndër të tjera, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të dhënë ndaj kërkuesit me vendimin nr. 21, datë 13.3.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Pas ankimit edhe të kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 16, datë 25.4.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 21, datë 13.3.2024 dhe nr. 27, datë 16.3.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, për sa është disponuar në lidhje me kërkuesin. Ky i fundit ka ushtruar rekurs dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1690, datë 17.10.2024, ka vendosur mospranimin e

rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

8. Në datën 15.5.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objekt të pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Ankimi është regjistruar në datën 13.6.2025, pasi është plotësuar sipas nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës. Kolegji i Gjykatës gjatë shqyrtimit paraprak në datën 30.7.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se janë cenuar:

9.1. *Liria personale, e garantuar në nenin 27 të Kushtetutës*, pasi gjykatat nuk kanë ndjekur standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, si një masë ekstreme që duhet parë në raport me rrethanat, klasifikimin e veprës penale të hetuar, veprimet e dyshuara si të kundërligjshme, rrethanat personale, por edhe kushtet dhe sipas neneve 228, 229 dhe 230 të KPP-së. Gjithashtu, nga provat e paraqitura, gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të argumentojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. Faktet për të cilat dyshohet kërkuesi nuk përmbajnë elemente të veprave penale të parashikuara nga nenet 259 dhe 287, pika 2, të KP-së. Masa e sigurimit personal “Arresti në burg” e caktuar ndaj kërkuesit nuk është e përshtatshme dhe proporcionale me nevojat e sigurimit. Gjykata e posaçme në çdo rast, në kuptim të nenit 232 të KPP-së, në vendosjen e masave të sigurimit duhet të vlerësojë përshtatshmërinë e vet masës siguruese në raport me nevojat ruajtëse. Individualizimi i masës duhet të bazohet në parimin e nevojës dhe masa e sigurimit “Arresti në burg” përbën një *extrema ratio*. Edhe sipas nenit 5 të KEDNJ-së, masa e sigurimit “Arresti në burg” duhet të shfaqet si zgjidhje ekstreme që justifikohet vetëm kur të gjitha mundësitë në dispozicion rezultojnë të pamjaftueshme. Vendimi i Gjykatës së Lartë që nuk ka pranuar rekursin ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta është pa analizë të mjaftueshme ligjore në drejtëm të nevojës dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit. Gjykata e



Lartë, në kundërshtim me ligjin, praktikën gjyqësore dhe jurisprudencën kushtetuese, ka pranuar argumentimin e gjykatës së apelit pa e analizuar vetë rrezikun real të ikjes ose të pengimit të hetimeve.

9.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të proporcionalitetit*, pasi vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe të GJKKO-së Apelit u mungon arsyetimi për kriterin e proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë, për rrjedhojë nuk rezulton që ato të kenë vlerësuar nevojën për caktimin e kësaj mase ndaj kërkuesit. Mungesa e arsyetimit, interpretimi dhe vlerësimi i tyre kanë krijuar dyshime nëse ato kanë vlerësuar kriterin e proporcionalitetit të masës në drejtim të nevojës për kufizimin e lirisë të kërkuesit, sipas neneve 228 e vijuese të KPP-së. Nga përmbajtja e vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe GJKKO-së Apelit krijohet përshtypja se po shqyrtohet themeli i gjykimit dhe jo kushtet e kriteret për caktimin e masës së sigurimit personal. Edhe Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar mjaftueshëm për vlerësimin e masave të tjera të sigurimit të vlerësuar si masa më të buta (si arresti në shtëpi, detyrimi për paraqitje ose garanci pasurore), edhe pse gjykatat e posaçme kanë argumentuar vetëm në mënyrë teorike për rrezikun e ikjes dhe ndikimit të provat.

9.3. *E drejta e mbrojtjes*, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë në caktimin e masës së sigurimit nuk e ka njoftuar mbrojtësin e kërkuesit, në kundërshtim me nenin 245 të KPP-së, sipas të cilit kërkohet domosdoshmërisht prania e mbrojtësit ligjor të shtetasit në caktimin e masës së sigurimit.

9.4. *E drejta për trajtim të barabartë, standardi i dyfishtë i gjykimit nga Gjykata e Lartë dhe gjykata e caktuar me ligj*, për sa i përket *rëndimit të pozitës procedurale*, sepse në raste të ngjashme (vendimi nr. 00-2024-1588 (232), datë 26.9.2024) Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se ndërhyrja e gjyqtarit të hetimeve paraprake në veprimtarinë e prokurorit, duke bërë ri(kualifikim) të faktit penal për të cilin dyshohet i hetuari, fakt për të cilin nuk ka ende finalizim nga organi i akuzës, është në tejkalim të kompetencave të tij funksionale. Ndryshe nga organi i akuzës, gjyqtari i hetimeve paraprake ka vlerësuar se personat e hetuar nuk kishin kryer veprat penale sipas nenit 25 të KPP-së, në bashkëpunim të thjeshtë, por, sipas tij, kanë vepruar si grup i strukturuar kriminal. Ndërsa GJKKO-ja e Apelit ka shtuar rrethana rënduese për kërkuesin, duke

orientuar për hetimin në kuadër të grupit të strukturuar kriminal.

9.5. *Prezumimi i pafajësisë dhe mosdënimi pa ligj, i garantuar në nenet 29 dhe 30 të Kushtetutës*, pasi nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të posaçme dhe të Gjykatës së Lartë rezulton se ato kanë krijuar bindjen për fajësinë e kërkuesit, duke cenuar *parimin e prezumimit të pafajësisë*, që është e papranueshme në këtë fazë të procedurës penale. Për më tepër, GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar për rrethanën që kërkuesi po hetohet pa një dispozitë penale/pa ligj për sa i përket akuzës së “pronarit faktik” ose “pronari i fshehur”, pasi në asnjë dispozitë të KP-së nuk parashikohen këto nocione. Çdo vlerësim për cilësimin juridik të veprës penale dhe mënyrën e zbatimit të ligjit kur konstatohen shkelje të procesit të rregullt ligjor është në juridiksionin kushtetues. Cenimi i së drejtës për të mos u dënuar/hetuar pa ligj ka ardhur si rezultat i mënyrës së interpretimit të ligjit nga Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat e posaçme, në të cilën konstatohen edhe elemente të arbitraritetit.

9.6. *Fshehtësia e korrespondencës dhe e të dhënave personale*, pasi janë kryer veprime procedurale pa vendim gjyqësor, duke ndërhyrë në korrespondencën private dhe të dhënat kompjuterike. Organi i ndjekjes penale ka kryer sekuestrimin e pajisjeve elektronike të subjekteve të dyshuara, persona nën hetim, dhe ka aksesuar përmbajtjen e korrespondencës elektronike pa pasur një vendim gjyqësor. Kjo masë, që është pranuar edhe nga gjykatat, përbën ndërhyrje të pajustificuar dhe joproporcionale në sferën e jetës private, duke cenuar *lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale*. Në këto kushte, Gjykata duhet të konstatojë shkeljen e të drejtave kushtetuese të garantuara nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës. Kërkuesi nuk është njohur me vendimin nr. 116, datë 18.2.2024, të GJKKO-së së Shkallës së Parë për kontrollin e banesës, duke iu mohuar edhe e drejta e ankimit.

10. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka parashtruar sa vijon:

10.1. Pretendimi për *cenimin e së drejtës për liri personale*, sipas *nenit 27 të Kushtetutës*, është i pabazuar, pasi është respektuar kriteri i dyshimit të arsyeshëm. Vendimarrja për vendosjen e masës së sigurimit i është nënshtruar kontrollit gjyqësor deri në Gjykatën e Lartë. Gjykatat e posaçme kanë arsyetuar mjaftueshëm për plotësimin e kushteve të veçanta



për caktimin e masës së sigurimit, në kontekst të rrethanave çështjes dhe kriterëve të parashikuara në pikën 3 të nenit 228 të KPP-së, ndonëse nuk janë të detyrueshme që të plotësohen në mënyrë kumulative (rreziku i ikjes, rreziku i marrjes ose vërtetësisë së provës, si dhe rreziku që kërkuesi të kryejë krime të të njëjtit lloj me atë që procedohet). Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar pretendimet e ngritura gjatë procesit gjyqësor përkundrejt fakteve dhe provave të marra gjatë gjyqimit nga gjykatat më të ulëta në raport me rregullimet ligjore për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”.

10.2. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të proporcionalitetit* është i pabazuar. Gjykatat e posaçme kanë arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e masës së sigurimit. Ato kanë arsyetuar në përputhje me standardet kushtetuese dhe të GJEDNJ-së në lidhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit në drejtim të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sigurimit të caktuar ndaj kërkuesit, si dhe kanë mbajtur në konsideratë se ajo përmbush qëllimin për të cilin është caktuar. Gjykata e Lartë, ndonëse ka vendosur mospranimin e rekursit, ka marrë në shqyrtim, ka analizuar dhe u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesit.

10.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për trajtim të barabartë, standardit të dyfishtë të gjyqimit nga Gjykata e Lartë dhe gjykatës së caktuar me ligj*, është i pabazuar. Gjykata e Lartë ka analizuar edhe pretendimin për rëndimin e pozitës procedurale nga gjyqtari i hetimit paraprak pranë GJKKO-së së Apelit. Nuk mund të pretendohet për standard të dyfishtë, derisa vendimi i Gjykatës së Lartë nuk bie ndesh me vendimet unifikuese të vet asaj.

10.4. Pretendimi për *prezumimin e pafajësisë dhe mosdënimin pa ligj* është i pabazuar, pasi gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Ato nuk e kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme, si dhe kanë përcaktuar dyshimin e arsyeshëm të të hetuarit në fazën e caktimit të masës së sigurimit.

10.5. Për pretendimin për cenimin e *fshehtësisë së korrespondencës dhe mbrojtjes të të dhënave personale*, kërkuesi nuk ka shteruar shkallët e tjera të gjyqësorit, për t’iu nënshtruar më pas kontrollit kushtetues. Ai

ka paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit të prokurorit të datës 21.2.2024, “Për vleftësimin e sekuestros”, për të cilin GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi kërkuesi nuk e ka ushtruar më tej të drejtën e ankimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor penal të kundërshtuar në ankimin kushtetues individual, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata konstaton se në parashtrimet shtesë të datës 23.9.2025, të paraqitura pas kalimit të çështjes në seancë plenare, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës, të garantuara nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës*, për shkak të sekuestrimit të pajisjeve elektronike/dokumenteve gjatë hetimit. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, për këtë pretendim në prapësimet e datës 6.10.2025 është shprehur se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Sipas tij, kërkuesi e ka kundërshtuar vendimin e prokurorit për sekuestrimin e sendeve, i cili është rrëzuar me vendimin nr. 193, datë 4.4.2024



të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe kërkuesi nuk e ka ushtruar më tej të drejtën e ankimit.

14. Për këto pretendime, Gjykata konstaton se objekt i këtij gjykimi kushtetues janë vendimet gjyqësore për vendosjen ndaj kërkuesit të masës së sigurimit personal të arrestit në burg dhe jo vendimet e kontrollit dhe të sekuestrimit. Masa e sekuestrimit ka qenë objekt i një procesi tjetër gjyqësor, për të cilin kërkuesi ka mjete të tjera në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës. Për më tepër, Gjykata çmon se pretendimet e reja, të cilat përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues individual, nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ato janë paraqitur nga kërkuesi pas vendimit të Kolegjit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Për rrjedhojë, pretendimet për cenimin e të dhënave personale, lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës nuk mund të merren në shqyrtim.

15. Për sa u përket vendimeve të kundërshtuara për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, Gjykata vlerëson se edhe pse ato janë me natyrë të ndërmjetme, të dhëna në kuadër të një procedimi penal që është ende duke u zhvilluar, Gjykata i ka konsideruar këto lloj vendimesh, në mënyrë përjashtimore, si përfundimtare për qëllime të gjyqimit kushtetues, për sa kohë që ato sjellin kufizimin e lirisë personale të individit (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 28, datë 23.6.201, të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me pretendimet e parashtruara për këto vendime, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit (gjykatat e posaçme dhe Gjykatën e Lartë) dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Prandaj Gjykata vlerëson se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

16. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mban datën 17.10.2024 dhe i është komunikuar mbrojtësit të kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 16.1.2025. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 15.5.2025, brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka parashtruar pretendime për cenimin e lirisë personale në drejtim të standardit të dyshimit të

arsyeshëm të bazuar në prova, parimit të proporcionalitetit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor po në drejtim të proporcionalitetit, së drejtës së mbrojtjes, së drejtës për trajtim të barabartë, standardit të dyfishtë të gjyqimit nga Gjykata e Lartë dhe gjykatës së caktuar me ligj, si dhe parimit të prezumimit të pafajësisë dhe mosdënimit pa ligj.

18. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së mbrojtjes, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë në caktimin e masës së sigurimit nuk ka njoftuar mbrojtësin e kërkuesit, në kundërshtim me nenin 245 të KPP-së, sipas të cilit kërkohet domosdoshmërisht prania e mbrojtësit ligjor të shtetasit në caktimin e masës së sigurimit. Subjekti i interesuar nuk ka prapësuar për këtë pretendim të kërkuesit.

19. Lidhur me të drejtën e mbrojtjes së personit të arrestuar, Gjykata, bazuar në nenin 28, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 5, pika 4, të KEDNJ-së, ka theksuar se ajo realizohet nga shqyrtimi gjyqësor i ligjshmërisë së arrestit, i cili duhet të garantojë parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, duke i dhënë të ndaluarit mundësi efektive për të kundërshtuar dyshimet ose akuzat ndaj tij (*shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 83, datë 5.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nisur nga argumenti i kërkuesit, Gjykata vëren se neni 244 i KPP-së parashikon se vendimi për caktimin e masës së sigurimit merret nga gjykata në dhomën e këshillimit dhe jepet i arsyetuar, sipas elementeve të përcaktuara në nenin 245, mungesa e të cilave e bën vendimin të pavlefshëm. Një prej elementeve të arsyetimit është parashtrimi i shkaqeve pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja (pika 1, shkronja “ç”) dhe, sipas kërkuesit, ky element tregon se pjesëmarrja e mbrojtësit është e detyrueshme në procedurën e caktimit të masës së sigurimit.

21. Nga ana tjetër, nenet 246-247 të KPP-së parashikojnë procedurën e zbatimit të masave të sigurimit, duke përcaktuar, ndër të tjera, detyrimin që vendimi gjyqësor t'i njoftohet jo vetëm individit, por edhe mbrojtësit. Ndërsa, sipas nenit 248 të KPP-së gjykata merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur masën, duke i dhënë mbrojtësit të drejtën të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre. Në rastin e arrestit në burg, marrja në pyetje e personit duhet bërë jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës. Gjatë kësaj procedure, gjykata verifikon kushtet e caktimit të masës dhe kur ato nuk ekzistojnë, ajo vendos revokimin e masës, në të



kundërt, vendos vazhdimin e zbatimit të saj, me vendim të arsyetuar, ndërkohë që gjatë debatit gjyqësor palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshmitarë.

22. Nga sa më lart, Gjykata vëren se neni 245 i KPP-së, që parashikon elementet e arsytimit, zbatohet për të gjitha vendimet gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit personal. Ai nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur nga normat e tjera procedurale, siç parashtron kërkuesi, sepse jep rezultat jologjik. Në fakt, nga përmbajtja sistematike e normave procedurale rezulton e qartë se vendimi për caktimin fillestar të masës merret në dhomën e këshillimit dhe i njoftohet kërkuesit e mbrojtësit të tij, të cilëve u garantohej njohja me aktet. I arrestuari merret në pyetje brenda tri ditëve nga zbatimi i masës, në prani të mbrojtësit. Gjatë seancës së marrjes në pyetje, i arrestuari dhe mbrojtësi kanë të drejtën të parashtronë kundërshtime për masën, si dhe të debatojnë gjyqësisht për provat. Janë pikërisht këto parashtrime, të cilat duhet të pasqyrohen në vendimin gjyqësor, sipas nenit 245, pika 1, shkronja ç, të KPP-së. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë standardet kushtetuese dhe parashikimet ligjore, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

23. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për trajtim të barabartë, të standardit të dyfishtë të gjyqimit nga Gjykata e Lartë dhe të gjykatës së caktuar me ligj, kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se në rastin e tij Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Apelit, e cila ka rënduar pozitën e tij juridike duke vlerësuar se ishte e domosdoshme që hetimet të zhvilloheshin edhe në drejtim të bashkëpunimit në kuadër të krimit të organizuar. Sipas kërkuesit, në raste të ngjashme, Gjykata e Lartë e ka konsideruar si tejkalim të kompetencës së gjyqtarit të seancës paraprake (duke referuar edhe vendimin nr. 00-2024-1588 (232), datë 26.9.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

24. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se GJKKO-ja e Apelit ka orientuar Prokurorinë e Posaçme për të hetuar në drejtim të bashkëpunimit si grup i strukturuar kriminal, pasi personat e hetuar, mes tyre edhe kërkuesi, dyshohet se janë marrë vesh me njëri-tjetrin për kryerjen e veprës penale së paku një herë, pra jo më pak sesa parashikon si minimum pika 4 e nenit 28 të KP-së. Sipas gjykatës së posaçme, ata e kanë kryer për të realizuar përfitim

material dhe bashkëpunimi i tyre dyshohet arsyeshëm se është i paramenduar dhe i paralogantur për të kryer në momentin e duhur veprimet që kanë marrë përsipër për të kryer, pra nuk është “formuar rastësisht”, si dhe bashkëpunimi i tyre është një organizim i strukturuar, efikas e me strukturë të konsoliduar (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqe 28*). Pas rekursit të kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se gjyqtari i hetimit paraprak pranë GJKKO-së së Apelit nuk e ka rënduar pozitën e kërkuesit dhe as ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi pavarësisht orientimit në lidhje me formën e veçantë të bashkëpunimit, analiza në lidhje me ekzistencën e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së sigurimit është e plotë dhe e mirargumentuar, duke iu referuar fakteve penale që i atribuohen kërkuesit (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafët 46-47*).

25. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se shtimi dhe ndryshimi i akuzës janë veprime procedurale formale të cilat kryhen nga organi procedues pasi individ i merr cilësinë e të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës nga prokurori, në të cilin, në përputhje me nenin 34 të KPP-së, tregohen të dhënat e mjaftueshme. Edhe në raste të ngjashme Gjykata është shprehur se GJKKO-ja e Apelit nuk e ka rënduar pozitën e kërkuesit, por ka vlerësuar në mënyrë autonome rëndësinë e fakteve konform natyrës së veprave penale për të cilat ai dyshohet. Arsyetimi i gjykatës në drejtim të nevojave të sigurimit personal nuk përbën rëndim të pozitës të të pandehurit, pasi është organi i akuzës ai që vlerëson gjatë hetimit paraprak se për cilat vepra penale do të ngrejë përfundimisht akuzë (*shih vendimin nr. 7, datë 28.1.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se edhe në rastin në shqyrtim nuk rezulton që gjykata e apelit të ketë dhënë një vendim që bie ndesh me parashikimet ligjore të KPP-së, si dhe nuk evidentohet që interpretimi i bërë nga ajo gjykatë të jetë zgjeruar në atë masë sa të cenojë garancitë procedurale të vendosura nga KPP-ja, duke rënduar në rastin konkret pozitën e kërkuesit. Gjykata evidenton se GJKKO-ja e Apelit, në thelb, nuk e ka rënduar pozitën e kërkuesit, ndërkohë që procesi ndaj tij nuk është një proces themeli. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë, i referuar nga kërkuesi për raste të ngjashme në dukje, nuk është vendim unifikues ose njësuës, për rrjedhojë të jetë i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat më të ulëta,



ndaj Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për këtë argument në lidhje me cenimin e të gjitha parimeve kushtetuese të ndërlidhura (*parimit të sigurisë juridike, gjykatës së caktuar me ligj dhe mosrëndimit të pozitës*) nuk mund të merret parasysh.

27. Gjykata vëren se kërkuesi argumentet për cenimin e lirisë personale i ka parashtruar në drejtim të *standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, parimit të proporcionalitetit, si dhe prezumimit të pafajësisë dhe mosdënimit pa ligj*. Për sa i përket këtij të fundit, për nga mënyra sesi është parashtruar ky pretendim, për sa kohë që është i ndërlidhur edhe me disa të drejta të tjera kushtetuese, Gjykata vlerësoi ta shqyrtojë atë jo si pretendim të mëvetshtëm, por të lidhur me pretendimet për aspektin substancial të masës së arrestit. Nga ana tjetër, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pikërisht në lidhje me dy aspektet e së drejtës substanciale të pretenduar si të shkelur*. Për rrjedhojë, Gjykata, bazuar në jurisprudencën e saj, sipas së cilës në rastet e kontrollit të vendimeve që caktojnë masat e sigurimit personal, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe bazuar edhe në arsyetimin e gjykatave të posaçme, do të analizojë pretendimin për cenimin e *lirisë personale* në aspektin substancial në drejtim të: i. standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova; ii. parimit të proporcionalitetit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

B.1.1. Në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova

28. Kërkuesi në mënyrë të përmblodhur ka pretenduar se masat e sigurimit personal duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të gjykatës edhe në raport me akuzën, aktet hetimore dhe provat, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm, pikërisht për shkak të kufizimeve të cilave i nënshtrohet individ gjatë zbatimit të tyre në raport me të drejtën për liri, të mbrojtur nga neni 27, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së. Gjykatat e posaçme nuk kanë ndjekur standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. Hetimi ndaj tij po zhvillohet pa pasur ligj, pasi akuzat janë ngritur duke u bazuar në konceptin e “pronarit faktit”, që nuk njihet nga ligji.

29. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se gjykatat e posaçme kanë arsyetuar mjaftueshëm për plotësimin e kushteve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit, në kontekst të rrethanave të çështjes. Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar pretendimet e ngritura gjatë procesit gjyqësor përkundrejt fakteve dhe provave të marra gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta në raport me rregullimet ligjore për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”.

30. Neni 27 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (paragrafi 1), ndërsa liria e personit mund të kufizohet kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale (paragrafi 2, shkronja “c”).

31. Gjykata ka pohuar se qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një “shoqëri demokratike”. Kërkesa “dyshime të arsyeshme” për kryerjen e veprës penale që justifikon kufizimin e lirisë personale të individit, nënkupton ekzistencën e fakteve ose të informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkallë të mëvonshme të procesit të hetimit penal (*shih vendimin nr. 7, datë 28.1.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Po sipas Gjykatës, në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar nga KPP-ja, ku në rastin e caktimit të masës së sigurimit, neni 228, pika 1, i saj, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, përcakton si kusht të domosdoshëm (*sine qua non*) ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individ ka kryer një vepër penale (*shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 19, datë 4.4.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e autoriteteve për faktet e çështjes, për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, do të përbënte cenim të nenit 27 të Kushtetutës. Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për arrestimin e një individ, mbahet në



konsideratë konteksti i përgjithshëm i fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/ personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata do të analizojë faktin nëse gjykatat e zakonshme, nëpërmjet arsyetimit të vendimit, kanë respektuar kriterin kushtetues të dyshimit të arsyeshëm si kusht *sine qua non* për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuesit.

35. Gjykata vëren se kërkuesi është proceduar penalisht dhe i është nënshtruar masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues për shkak të ekzistencës së dyshimeve të arsyeshme se ai, në fillim, në cilësinë e ish-drejtorit të përgjithshëm të AEE-së dhe, më pas, në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të ARRSH-së, ka pranuar dhe ka marrë në mënyrë të tërthortë nga shoqëria “N.” përfitime të parregullta monetare nëpërmjet shoqërisë “D.” të kontrolluar prej tij. Marrja e përfitimeve të parregullta ka ndodhur pas fitimit prej shoqërisë “N.” të procedurave të prokurimit publik të zhvilluara nga autoritetet publike kontraktore, titullar i të cilave ka qenë kërkuesi, të cilit, më pas, i kanë kaluar vlerat monetare përmes transaksioneve të kësaj shoqërie me shoqërinë “D.”, të zotëruar nga ai indirekt (*shih paragrafët 2 deri 5 të vendimit*). Në këto rrethana, kërkuesi është dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 259 dhe 287/2 të KP-së.

36. Mbi bazën e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në të dyja vendimet e saj, atë lidhur me caktimin e masës së sigurimit e më tej atë të marrjes në pyetje të kërkuesit, ka analizuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, duke arsyetuar për faktet, informacionet dhe provat mbi të cilat ka krijuar bindjen se mes kërkuesit dhe veprave penale për të cilat dyshohet ekziston një lidhje objektive që përlligj ekzistencën e këtyre dyshimeve si kusht *sine qua non* për kufizimin e lirisë personale. Konkretisht, dyshimi i arsyeshëm është krijuar mbi një sërë provash të paraqitura nga organi i akuzës, siç janë

këqyrja e faturave nga sistemi i administratës tatimore, verifikimi i deklaratave të pasurisë të kërkuesit, transkriptimi i bisedave telefonike mes kërkuesit dhe të pandehurve të tjerë, këqyrja e regjistrit tregtar dhe llogarive bankare të shoqërisë “D”, si dhe marrja në pyetje e personave të përfshirë. Për sa i takon fiktivitetin të zotërimit nga kërkuesi të shoqërisë “D”, ajo gjykatë ka vlerësuar se blerja nga shtetasi V.B. për një shumë 100.000 euro dhe shitja më tej për 500.000 euro për një periudhë shumë të shkurtër dhe me një vlerë shumë më të madhe, ngre dyshime për fiktivitet. Sipas gjykatës, të gjitha provat dhe indiciet e grumbulluara ngrenë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi i ka kryer veprat për të cilat dyshohet.

37. Në vijim, masa e sigurimit e caktuar ndaj kërkuesit i është nënshtruar kontrollit nga GJKKO-ja e Apelit, e cila, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkuesit, e ka vlerësuar të drejtë vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ajo gjykatë i ka konsideruar të bazuara vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ka arsyetuar se nga tërësia e provave të paraqitura nga organi i akuzës ka dyshime se kërkuesi mund të ketë zhvilluar një veprimtari korruptive, duke kërkuar dhe marrë përfitime materiale prej të hetuarve të tjerë si “çmim të shitjes së pushtetit të tij”, në kundërshtim me funksionin publik, detyrën e tij si drejtor i AEE-së dhe ARRSH-së, duke u provuar dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi mund të jetë subjekt i nenit 259 të KP-së. Po nga tërësia e provave ekziston dyshimi se kërkuesi mund të ketë krijuar shoqëri fiktive, me qëllim pastrimin e produkteve nga veprimtaria kriminale, duke shkelur edhe nenet 287 e 28, pika 4, të KP-së. Ndër të tjera, GJKKO-ja e Apelit për kërkuesin ka arsyetuar se provat e mbledhura gjatë hetimit janë të afta të krijojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi në bashkëpunim me personat e tjerë ka kryer veprat penale që dyshohet. Për më tepër, tërësia e provave (faturat e shitjeve, dokumentet e tri procedurave të prokurimit të ARRSH-së, këqyrja e sistemit të administratës tatimore, dokumentet përkatëse të llogarive bankare, të dhënat e sistemit TIMS, këqyrja e CD-ve të dërguar nga kompanitë telefonike etj.) ngrihet dyshimi se kërkuesi mund të ketë krijuar shoqëri tregtare fiktive me qëllim pastrimin e produkteve nga veprimtaria kriminale, duke shkelur nenet 278 e 28, pika 4, të KP-së. Këto prova nxjerrin në dritë se ekzistojnë elementet provuese të kërkuara nga neni 228 i KPP-së, si



parametër provues i dyshimit të arsyeshëm, në lidhje me faktin që kërkuesi ka korruptuar përmes kërkimit dhe marrjes së përfitimeve materiale gjatë ushtrimit të funksionit publik, duke dëmtuar themelet e veprimtarisë shtetërore, nisur edhe nga fakti që vepra për të cilën dyshohet se e ka kryer mbron një të mirë juridike (veprimtarinë shtetërore).

38. Çështja është shqyrtuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar se vendimet e gjykatave të faktit kanë disponuar drejt lidhur me caktimin e masës së sigurisë, duke u dhënë përgjigje të argumentuara dhe ezauruese të gjitha pretendimeve të kërkuesit. Ai kolegji ka vlerësuar se lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, gjykatat e faktit kanë verifikuar mjaftueshëm e më tej kanë arsyetuar ekzistencën e provave, rrethanave të faktit dhe elementet e mjaftueshme juridike që mbështesnin dyshimin se kërkuesi mund të kishte kryer veprat për të cilat dyshohej.

39. Gjykata vlerëson se gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë kanë arsyetuar mjaftueshëm për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, duke treguar qartë faktet dhe provat shkresore që kanë shërbyer si bazë për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”.

40. Në dritën e këtyre konsideratave, Gjykata vlerëson se në çështjen penale ndaj kërkuesit duket se ka informacione që do të bindnin një vëzhgues të paanshëm se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat është i dyshuar, ndaj nuk mund të konkludohet se ai është arrestuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës. Kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprave penale për të cilat dyshohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë së tij personale, pasi është bazuar në fakte, informacione dhe provat e sipërcituara, që i kanë krijuar bindjen gjykatave të posaçme se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprave penale për të cilat dyshohet. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit *për cenimin e lirisë personale me argumentin e mungesës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova* janë të pabazuara.

B.1.2. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit

41. Kërkuesi ka parashtruar se gjykatat e posaçme në caktimin e masës duhet të vlerësojnë me kujdes dhe dilijencë jo vetëm përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore për caktimin e masës, por edhe të vlerësojnë në mënyrë objektive përshtatshmërinë e masës në raport me faktin penal. Gjykatat e posaçme duhet të vlerësojnë të gjitha rrethanat që mbështesin interesin publik në ushtrimin e ndjekjes penale dhe se interesi për ligj mjaftueshëm në mënyrë proporcionale kufizimin e lirisë së individit. Sipas tij, vendimi i Gjykatës së Lartë që nuk ka pranuar rekursin ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, që kanë vendosur një masë kufizuese të lirisë (atë të arrestit në burg), është pa analizë të mjaftueshme ligjore në drejtim të nevojës dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit.

42. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se gjykatat e posaçme në caktimin e masës së sigurimit kanë bërë një analizë të kriterëve të parashikuara në pikën 3 të nenit 228 të KPP-së, ndonëse nuk janë të detyrueshme që të plotësohen në mënyrë kumulative (rreziku i ikjes, rreziku i marrjes ose vërtetësisë së provës, si dhe rreziku që kërkuesi të kryejë krime të të njëjtit lloj me atë që procedohet). Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar pretendimet e ngritura për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar.

43. Gjykata në jurisprudencën e saj në lidhje me caktimin e masës së sigurimit personal, në drejtim të proporcionalitetit, ka pohuar se ajo duhet të jetë në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur dhe se arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë duhet të jenë “relevante dhe të mjaftueshme”. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për atë sa ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Në vijim, në drejtim të kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata analizon aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijuese të KPP-së. Gjithashtu, në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata bazohet në arsyetimin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se u takon atyre që, përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 1, datë 17.1.2025; nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).



44. Ndërkohë, KPP-ja, në nenin 228, pika 3, përcakton kushtet e veçanta, alternative, për vendosjen e masave të sigurimit personal dhe konkretisht: kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit (shkronja “a”); kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet (shkronja “b”); kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të njëjtët lloj me atë për të cilin procedohet (shkronja “c”). Neni 229 përcakton kriteret e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, duke parashikuar se gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (pika 1) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga KP-ja (pika 2). Kurse neni 230 përcakton kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, duke parashikuar, ndër të tjera, se një masë e tillë mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit (pika 1).

45. Për sa më lart, si dhe referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata vlerëson të analizojë nëse gjykatat e posaçme, në caktimin e masës së sigurimit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, për rrezikun që i pandehuri të largohet, si dhe për rrezikun që për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit kërkuesi të kryejë krime të tjera. Për këtë qëllim, Gjykata do të mbajë në konsideratë kontekstin e fakteve të çështjes për të përcaktuar nëse masa e caktuar ndaj kërkuesit është e përshtatshme dhe në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur, si dhe nëse çdo masë tjetër është e papërshtatshme.

46. Në vijim, pa rënë në përsëritje të fakteve në lidhje me proceset gjyqësore që çuan në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit dhe vazhdimin e paraburgimit të tij, Gjykata çmon të evidentojë arsyet e veçanta që gjykatat e posaçme parashtruan rreth përshtatshmërisë së masës së sigurimit të arrestit në burg.

47. GJKKO-ja e Shkallës së Parë si gjatë seancës së caktimit të masës, ashtu dhe të vleftësimit të saj ka arsyetuar se bazuar në natyrën, llojin e veprave penale, mjetet dhe mënyrat e këqyrjes së tyre, pasojat e shkaktuara, si dhe elementet subjektive të lidhura me personalitetin e kërkuesit dhe gjendjen e rrezikut, masa më e përshtatshme është ajo “Arresti në burg”. Edhe gjatë seancës së marrjes në pyetje dhe verifikimit të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se nuk ka rezultuar që nevojat e sigurimit për kërkuesin të kenë ndryshuar në raport me masën e caktuar ndaj tij, duke konstatuar papërshtatshmërinë e masave të tjera të sigurimit. Konkretisht, ajo gjykatë ka vlerësuar se masa ishte diktuar nga prezenca e kushteve të posaçme, të tilla si: rrezikshmëria shoqërore që ato krime paraqisnin, numri i veprave penale për të cilat ai dyshohej, sanksioni që parashikohej për veprat penale që dyshohej, prezenca e rrethanave rënduese/cilësuese dhe numri i episodeve kriminale për të cilat dyshohej. Gjithashtu, lidhur me kriteret e posaçme (rreziqet) të parashikuara nga pika 3 e nenit 228 të KPP-së, ajo gjykatë ka çmuar se për kërkuesin ekzistonin të tria rreziqet, ai i ikjes, helmimit të provave dhe kryerjes së veprave të tjera penale. Për sa i takon rrezikut të ikjes, ajo gjykatë (në vendimin për caktim mase) arsyeton se ky rrezik ekzistonte për të pamundësuar procedimin e tij penal, si dhe gjithashtu në raport me sanksionin përkatës. Lidhur me helmimin e provave është vlerësuar si rrezik fakti që hetimet vijonin me pyetjen e personave të cilët kishin dijeni dhe kërkuesi mund të ndërhynte duke ndikuar në rrethanat e hetimit. Për sa i takon mundësisë për të kryer vepra të tjera penale, ajo gjykatë konstaton se rreziku lidhet me personalitetin e kërkuesit, shtrirjen në kohë dhe përsëritjen e veprimeve të paligjshme.

48. Ndër të tjera, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se masa “Arresti në burg” është masë proporcionale dhe më e përshtatshme me shkallën e nevojave të sigurimit nga pikëpamja e natyrës dhe rëndësisë së faktit penal, sanksionit dhe rrethanave rënduese të kryerjes së veprës penale duke shpërdoruar funksionin publik. Ajo gjykatë ka arsyetuar se rrezikshmëria e veprave penale për të cilat dyshohej përcaktohej si e tillë edhe në Konventën e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizimit”, të ratifikuar nga shteti



shqiptar. Për sa i takon papërshtatshmërisë së masave të tjera, apeli, në të njëjtën linjë me shkallën e parë, ka theksuar se ato janë të papërshtatshme për shkak të rrezikut për helmimin e provave, mënyrës së veprimit, rëndësisë së fakteve dhe mungesës së respektit për ligjin dhe sistemin.

49. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, e ka vlerësuar të drejtë arsyetimin se ekzistojnë shkaqe që vënë në rrezik vërtetësinë e provave, si kusht i tretë i parashikuar në nenin 228 të KPP-së dhe se gjykatat e posaçme kanë dhënë argumente të mjaftueshme për ekzistencën e kushteve të përgjithshme të caktimit të masave të sigurimit, si dhe kanë argumentuar në lidhje me përshtatshmërinë e masës dhe proporcionalitetin e saj duke vlerësuar edhe kriteret e veçanta të përcaktuara në KPP.

50. Nga sa më lart, Gjykata vëren se në vendimet e tyre gjykatat e posaçme e kanë caktuar masën e sigurimit “Arresti në burg”, duke mbajtur në konsideratë elementet objektive për llojin e veprës penale, mjetet dhe mënyrën e kryerjes së saj, pasojat e ardhura, por edhe elementet subjektive të lidhura me personalitetin e kërkuesit, rrezikun që mund të kryejë vepra të tjera penale ose vënien në rrezik të provave. Arsye këto të përshtatshme dhe të mjaftueshme në aspektin kushtetues dhe konventor për justifikimin e caktimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” dhe të vazhdimit të paraburgimit të një individi. Arsyetimi i gjykatave në këtë drejtim nuk është abstrakt, por i lidhur me pasqyrimin e detajuar të rrethanave të çështjes, të konstatuara nga hetimi deri në atë moment. Duket se gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë kanë shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme praninë në këtë rast të atyre rreziqeve, duke evidentuar kompleksitetin e hetimit, në pikëpamje të shtrirjes në kohë të veprimtarisë së dyshuar si kriminale, rolin e kërkuesit në kryerjen e veprave penale, por edhe ndikimin potencial negativ që ai mund të kishte në vijimin e hetimeve.

51. Në këndvështrim të parashtrimeve më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për kufizimin e lirisë personale, për shkak të caktimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, janë të pabazuara, për sa kohë që masa është vendosur për një qëllim të ligjshëm, garantimin e mbarëvajtjes së procesit penal në ngarkim të tij. Ajo nuk duket të jetë joproporcionale në kontekstin e rrethanave të

çështjes dhe në raport me veprat penale për të cilat ai dyshohet, si dhe është vendosur në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e saj. Gjykatat e posaçme kanë parashtruar mjaftueshëm argumente në drejtim të përshtatshmërisë së masës së paraburgimit të kërkuesit dhe përfundimi i tyre se çdo masë tjetër nuk është e përshtatshme nuk duket e paarsyeshme në raport me nevojat e sigurimit që janë evidentuar në rastin konkret. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se caktimi i masës së sigurimit “Arresti në burg” për kërkuesin duket se është i justifikuar në interesin publik, që tejkalon rregullin e respektimit të lirisë personale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së. Nisur nga kjo, Gjykata vlerëson se nuk mund të arrihet në përfundimin se caktimi i masës së arrestit në burg ndaj kërkuesit është i pajustificuar, ndaj pretendimi i tij për cenimin e *lirisë personale në drejtim të proporcionalitetit* është i pabazuar.

52. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e pabazuar dhe, si e tillë, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.3.2026.

Shpallur më 12.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Asim Vokshi

**VENDIM****Nr. 143, datë 28.5.2026****MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13 dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1100/6 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar, me vendndodhje në zonën e Sheq-Marinas, Bashkia Fier, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1100 prot., datë 8.4.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit prej 50 mw.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 184, datë 25.3.2021 dhe kontratën nr. 2720 rep., nr. 2066 kol., datë 9.7.2021, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria ka fituar të drejtën “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike ‘Blue 1’” me

kapacitet të instaluar 50 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 21.4.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.4.2026 dhe 23.4.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.5.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1100/4 prot., datë 24.4.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije dokumentacionin e munguar të aplikimit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1100/5 prot., datë 29.4.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1100/3 prot., datë 24.4.2026. Nga ana e tyre nuk rezultoi të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Nga analiza e aplikimit rezultoi se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar. Po ashtu, shoqëria ka shlyer pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin



A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 144, datë 28.5.2026

**MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13 dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1099/5 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’

sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 296 datë 30.12.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga parku fotovoltaik “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në Sheq-Marinas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1099 prot., datë 8.4.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 50 mw.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 183, datë 25.3.2021 dhe kontratën nr. 2721 rep., nr. 2067 kol., datë 9.7.2021 të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria ka fituar të drejtën “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike ‘Blue 2’ me kapacitet të instaluar 50 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 107, datë 21.4.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.4.2026 dhe 23.4.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.5.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1099/4 prot., datë 24.4.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije dokumentacionin/informacionin e munguar të aplikimit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1099/5 prot., datë 14.5.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar.

- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe MIE-n, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1099/3 prot.,



datë 24.4.2026. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar. Po ashtu, shoqëria ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 296 datë 30.12.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 145, datë 28.5.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 100 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1611/1 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.1.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1611 prot., datë 15.5.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 100 mw.



- Me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 673, datë 30.10.2024, dhe kontratën nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria ka fituar të drejtën “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesionit, në zonën kadastrale 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, qarku Fier”.

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores, e po ashtu ka shlyer dhe pagesat e rregullimit.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave “a”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, germa “b” të rregullores, shoqëria duhet të bëjë saktësimin përkatës të veprave ndihmëse dhe kapacitetit të secilës.

- Po ashtu, në kuadër të informacionit shtesë, vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë të depozitojë një informacion mbi mënyrën se si parashikon financimin e investimit për vendosjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.1.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 146, datë 28.5.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 100 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1291/4 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e



Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GreeNNat Solar Park Ballsh’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1291 prot., datë 28.4.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim për modifikimin e licencës, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, në aneksin A të saj, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të licencës.

- Nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 11.1.2023 dhe kontratës me nr. 31 rep, nr. 13 kol., datë 27.1.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria është pajisur me të drejtën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 mw, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi paraprak i dosjes ka rezultuar se shoqëria nuk ka kryer pagesën e aplikimit, si e tillë me *email*-in nr. 1291/1 prot., datë 5.5.2026, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i sjellë në vëmendje kryerjen e pagesës përkatëse.

- Rezulton se në datën 15.5.2026, shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores, si dhe ka shlyer pagesat e rregullimit.

- Po ashtu, me *email*-in e saj të datës 15.5.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/2 prot., datë 18.5.2026, shoqëria ka paraqitur disa saktësime/sqarime, në lidhje me aplikimin e saj, duke shtuar se kërkon të ndryshojë dhe numrin e paneleve, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar.

- Si e tillë, vlerësohet se afati për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë të fillojë nga kryerja e pagesës

dhe paraqitjes së saktësimeve të objektit të kërkesës së saj.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave “a”, “b”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, germa “c”, të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve të saj për ndryshimin e kërkuar në aneksin A të licencës.

- Po ashtu, në kuadër të një informacioni shtesë, vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë që të depozitojë në ERE informacion mbi mënyrën se si parashikon të financojë investimin përkatës për vendosjen e këtyre veprave ndihmëse/njësite depozituese të energjisë elektrike.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 mw, duke ndryshuar numrin e paneleve dhe duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të



Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 147, datë 28.5.2026

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 198, DATË
15.8.2025, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘POWER ENERGY’ SHPK
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET PRODHUES 25 mw”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1694 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 25 mw’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Power Energy” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 198, datë 15.8.2025, i ndryshuar me vendimin nr. 278, datë 6.11.2025, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali

fotovoltaik, me kapacitet prodhues 25 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025 dhe jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës. Ndërsa në pikën 5 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Afati për vënien në operim të centralit brenda datës 31.12.2025 është përcaktuar duke iu referuar parashikimeve të vetë shoqërisë, ndërkohë që me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 382 prot., datë 28.1.2026, shoqëria ka bërë me dije se është pajisur me lejen e ndërtimit, dhe se parashikon që punimet për ndërtimin e centralit të fillojnë në datën 12.2.2026.

- Referuar pikës 1, germa “d”, të VKM-së nr. 310, datë 4.6.2025 dhe nenit 9, të kontratës nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.6.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të depozituara nga shoqëria në kuadër të licencimit, impianti fotovoltaik duhet të vendoset, fillojë operimin brenda datës 4.6.2028. Shoqëria është brenda këtij afati, ndaj vlerësohet që dhe afati i pikës 3 të vendimit të jetë në përputhje me këto akte.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, të ndryshuar, si vijon:

a) Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet: “Shoqëria të fillojë operimin/ushttrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 4.6.2028.”.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 148, datë 28.5.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR
ME KËRKESËN E SHOQËRISË “POWER
ENERGY” SHPK PËR MODIFIKIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË
INSTALUAR 25 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1608/1

prot., datë 26.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 25 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “Power Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 25 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1608 prot., datë 15.5.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 25 mw.

- Nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 310, datë 4.6.2025 dhe kontratës nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.6.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria ka fituar të drejtën “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 25 mw, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesionit, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Power Energy’ sh.p.k.”.

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores e po ashtu ka shlyer dhe pagesat e rregullimit.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 e rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave “a”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, germa “b” të rregullores, shoqëria duhet të bëjë saktësimin përkatës të veprave ndihmëse dhe kapacitetit të secilës.

- Po ashtu, në kuadër të informacionit shtesë, vlerësohet t'i kërkojë shoqërisë të depozitojë një informacion mbi mënyrën se si parashikon



financimin e investimit për vendosjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe MIE, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe shoqëria “Operatori Sistemit Transmetimit” (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 149, datë 28.5.2026

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “PREMIUM GREEN ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1233/5 prot., datë 26.5.2026 dhe relacionin shtesë me nr. 1233/7, datë 28.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Premium Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Premium Green Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1233 prot., datë 21.4.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 122, datë 6.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.5.2026 dhe 8.5.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.5.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1233/3 prot., datë 4.5.2026 dhe *email*-in e datës 14.5.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/ dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.



- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1233/4 prot., datë 18.5.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Për sa informuar nga vetë shoqëria, se struktura organizative do të bëhet efektive, me hyrjen në treg të shoqërisë vlerësohet që t’i lihet kushti që, me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, të depozitojë në ERE informacionin e përditësuar në lidhje me këtë strukturë.

- Rezulton se shoqëria ka aktualisht një kontratë të vlefshme për disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, por duket qenë se afati i saj përfundon më 14.5.2031 dhe nuk mbulon të gjithë periudhën 5-vjeçare të vlefshmërisë së licencës, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument për disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Premium Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Brenda datës 14.5.2031, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument, në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Premium Green Energy” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 150, datë 28.5.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 238, DATË 6.11.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ORHER’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 998/5 prot., datë 26.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 238, datë 6.11.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Orher’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Orher” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 238, datë 6.11.2024, vendosi të licencojë shoqërinë “Orher” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.



- Në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaiik brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake (brenda datës 11.4.2025) ose duhet të depozitojë në ERE një VNM paraprake të re, si dhe të fillojë ushtrimin e veprimtarisë brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Në kuadër të përmbushjes së kushteve të licencës, shoqëria ka kryer raportime periodike pranë ERE-s, në lidhje me ecurinë e ndërtimit të centralit.

- Në vijim të kësaj korrespondence, me shkresën nr. 2541/2 prot., datë 5.12.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për një lapsus në vendimin e licencimit dhe i ka kërkuar informacion mbi vendndodhjen e saktë të projektit, si dhe vërtetimin e fillimit të punimeve brenda afatit të përcaktuar.

- Shoqëria, me shkresën protokolluar në ERE me nr. 170/43 prot., datë 28.1.2026, ka bërë me dije se impianti ndodhej në fazën e testimit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., pas së cilës do të vijonte me procesin e kolaudimit nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

- Si e tillë, duke qenë se nga dokumentacioni i depozituar dhe nga shkresat e shoqërisë nuk mund të evidentohet qartë fillimi i punimeve brenda afatit të përcaktuar, si dhe me qëllim sqarimin e kushtit të mbetur të vendimit nr. 238/2024, u vendos zhvillimi i një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s më datë 7.4.2026, për të cilën shoqëria u njoftua nëpërmjet shkresës me nr. 998/1 prot., datë 27.3.2026.

- Në vijim të zhvillimit të seancës dëgjimore, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 998/2 prot., datë 9.4.2026, depozitoi dokumentacion vërtetues për fillimin e punimeve të centralit brenda afatit të parashikuar, si e tillë, pika 2 e vendimit të licencimit vlerësohet të shfuqizohet.

- Po ashtu, në këtë shkresë nga shoqëria është bërë me dije se në raportimet periodike ka bërë një lapsus në raportimin e vendndodhjes së centralit, duke e raportuar atë në Njësinë Administrative Dërmenas, ndërkohë që centrali rezulton në Njësinë Administrative Topojë.

- Në rrethanat kur ERE po rishikon këtë vendim dhe duke qenë se është vënë re dhe një lapsus në konstatimet e vendimit nr. 238/2024 (për sa i përket referimit të kontratës me MIE-n) dhe pikës 1, të vendimit nr. 238/2024, lind nevoja që të bëhen dhe

korrigjimet përkatëse vetëm për sa i përket vendndodhjes së centralit, e cila do të jetë: në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Po ashtu, në kuadër të sa është përcaktuar në pikën 3, të vendimit nr. 238/2024, ERE me shkresën me nr. 998/3 prot., datë 15.5.2026, i është drejtuar shoqërisë, duke i kërkuar të dokumentojë në ERE aktin përkatës të lëshuar nga AKBN-ja, në lidhje me testimin e veprës ose të bëjë me dije nëse procedurat e testimit të veprës janë vijuar nga vetë shoqëria pas përfundimit të afateve të përcaktuara në nenin 10, pika 4, të kontratës me MIE-n.

- Së fundi, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 998/4 prot., datë 20.5.2026, dokumentoi në ERE shkresën e AKBN-së me nr. 1609/2 prot., datë 19.5.2026, drejtuar shoqërisë dhe për dijeni MIE-s, me anë të së cilës ka njoftuar shoqërinë se AKBN-ja do të marrë pjesë në testimin e impiantit 2 Mw në datat 20–22.5.2026.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Për gjithë sa më sipër, me depozitimin e dokumentacionit që provon fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaiik vlerësohet se pika 2, e vendimit nr. 238/2024 është plotësuar dhe duhet të shfuqizohet.

- Po ashtu, duke qenë se nga të dhënat që ERE disponon, rezulton se subjekti është në operim duke filluar nga muaji shkurt 2026, vlerësohet që pika 3, e vendimit nr. 238/2024, të ndryshohet, duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitojë në ERE testimin e veprës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e lajmëruar nga AKBN-ja për përfundimin e testimit, pra brenda datës 22.7.2026.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

- Në vijim të shfuqizimit të pikës 2 dhe ndryshimit të pikës 3, të vendimit nr. 238/2024, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi, si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.



Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 238, datë 6.11.2024, si vijon:

a) Pika 1, e vendimit nr. 238, datë 6.11.2024, ndryshon dhe bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “Orher” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.”;

b) Pika 2, e vendimi të Bordit nr. 238, datë 6.11.2024, shfuqizohet;

c) Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 238, datë 6.11.2024, ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës brenda datës 22.7.2026.”;

d) Pika 4, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 238, datë 6.11.2024, ndryshon dhe bëhet:

“4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Orher” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 151, datë 28.5.2026

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 174, DATË
29.8.2024, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘FAETHON’ SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1696 prot., datë 26.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.8.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Faethon’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Faethon” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 174, datë 29.8.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 317, datë 12.12.2025, vendosi të licencojë shoqërisë “Faethon” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 78.6 mw AC, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë, për një afat 25-vjeçar.

- Në pikat 2 dhe 3 të vendimit përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, jo më vonë se data 14.2.2027, si dhe të depozitojë në ERE një kopje të aplikimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për pajisjen me VNM paraprake të rinovuar, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 170/38 prot., datë 28.1.2026 dhe nr. 170/77 prot., datë 2.2.2026, ka bërë me dije se janë në pritje për marrjen e lejeve përkatëse të zhvillimit dhe



ndërtimit, por nuk rezulton që të ketë depozituar sa është kërkuar në pikën 3, të vendimit të Bordit nr. 174/2024, të ndryshuar.

- Detyrimi i përcaktuar në pikën 2 të vendimit, për të filluar ushtrimin e veprimtarisë brenda datës 14.2.2027, lidhet me afatet e përcaktuara në pikën 1, germa “d”, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 67, datë 14.2.2024 dhe nenit 9, pikës 2 të kontratës të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe rezulton se shoqëria është brenda këtij afati.

- Por në rrethanat kur nga shoqëria nuk është depozituar brenda afatit sa lënë detyrë në pikën 3, të vendimit nr. 174, datë 29.8.2024, të ndryshuar, për depozitimin e një kopjeje të aplikimit për pajisje me VNM të rinovuar dhe centrali nuk është ndërtuar ende, vlerësohet që të bëhet pezullim i vendimmarrjes së licencimit, duke ndryshuar pikën 1, të vendimit të bordit nr. 174/2024, të ndryshuar, deri në depozitimin në ERE të VNM-së paraprake të re, por jo më vonë se data 14.9.2026, duke marrë në konsideratë dhe kohën që nevojitet për ndërtimin dhe vënien në operim të centralit brenda afatit 14.2.2027.

- Në këto rrethana, vlerësohet të shfuqizohet pika 2, në lidhje me fillimin e operimit dhe pika 3, e cila tashmë propozohet të integrohet si pjesë e pikës 1.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.8.2024, i ndryshuar, si vijon:

a) Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 174, datë 19.8.2024, ndryshon dhe bëhet:

“1. Të pezullojë vendimmarrjen për licencimin e shoqërisë “Faethon” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 78.6 mw AC, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë, deri në

Faqe | 11974

depozitimin në ERE të VNM-së paraprake të re, por jo më vonë se data 14.9.2026.”;

b) Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 174, datë 19.8.2024, shfuqizohet;

c) Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 174, datë 19.8.2024, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së origjinës të njoftojë shoqërinë “Faethon” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 152, datë 28.5.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 91, DATË 2.4.2026, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘DION ENERGJI’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i



ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘DION Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “DION Energji” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 91, datë 2.4.2026 vendosi të licencojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 15.5.2026, ndërsa në pikën 4 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Për vendimin e sipërcituar, shoqëria është njoftuar me shkresën e ERE-s me nr. 667/8 prot., datë 20.4.2026, me anë të së cilës i janë sjellë në vëmendje dhe kushtet e vendimit.

- Nga të dhënat që ERE disponon, në kuadër të raportimeve mujore të depozituara nga shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., rezulton se shoqëria “DION Energji” sh.p.k. ka hyrë në operim në muajin prill 2026, pra brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s.

- Në këto kushte, vlerësohet se pika 2 e vendimit nr. 91/2026, duhet të shfuqizohet.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë’, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

- Në vijim të shfuqizimit të pikës 2, të vendimit nr. 91/2026, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi, si vijon: “Ky vendim është

objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, , si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, si vijon:

a) Pika 2, e vendimi të Bordit nr. 91, datë 2.4.2026, shfuqizohet;

b) Pika 4, e vendimi të Bordit nr. 91, datë 2.4.2026, ndryshon dhe bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 153, datë 28.5.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK PËR
TRANSFERIMIN E PLOTË TË
LICENCËS SË TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TE SHOQËRIA
“EZ5 TRADING” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 17, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1613/1 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria ‘EZ5 Trading’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 438, seria T19/T23, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 7.3.2019, si dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 9.10.2023, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1613 prot., datë 18.5.2026, shoqëria ka depozituar aplikimin për transferimin e plotë të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, te shoqëria e krijuar “EZ5 Trading” sh.p.k., e cila do të administrojë dhe operojë këtë veprimtari.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 17, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. Po ashtu, rezulton se shoqëria ka shlyer dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 17, pika 2, germa “e”, vlerësohet që t’i kërkohej shoqërisë që të bëjë sqarimet përkatëse, në lidhje me kontributin financiar. Po ashtu, në referencë të këtij transferimi, shoqëria duhet të bëjë përditësimin e informacionit/ dokumentacionit që ka shërbyer për licencimin e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës nr. 438, seria T19/T23, dhënë shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 7.3.2019, si dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 9.10.2023, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, te shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 154, datë 28.5.2026****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “EZ5 TRADING” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 17, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1613/1 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 439, seria F19/F23, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 7.3.2019, si dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 288, datë 9.10.2023, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1614 prot., datë 18.5.2026, shoqëria ka depozituar aplikimin për transferimin e plotë të licencës së furnizimit të energjisë elektrike, te shoqëria e krijuar “EZ5 Trading” sh.p.k., e cila do të administrojë dhe operojë këtë veprimtari.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 17, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. Po ashtu, shoqëria ka shlyer dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 17, pika 2, germa “e”, vlerësohet që t’i kërkohej shoqërisë që të bëjë sqarimet përkatëse, në lidhje me kontributin financiar. Po ashtu, në referencë të këtij transferimi, shoqëria duhet të bëjë përditësimin e informacionit/dokumentacionit që ka shërbyer për licencimin e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës nr. 439, seria F19/F23, dhënë shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 7.3.2019, si dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 288, datë 9.10.2023, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, te shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 155, datë 28.5.2026**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 171, DATË
31.7.2025, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘EZ-5 ENERGY’ SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 30 mw”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1701 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 30 mw’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 171, datë 31.7.2025, ndryshuar me vendimin nr. 280, datë 6.11.2025, vendosi të licencojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 30 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025 dhe të depozitojë në ERE testimin e veprës jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt. Ndërsa në pikën 5 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve në pikat 3 dhe 4.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Afati për vënien në operim të centralit brenda datës 31.12.2025, është përcaktuar duke iu referuar parashikimeve të vetë shoqërisë, ndërkohë që me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 176, datë 15.1.2026, shoqëria ka bërë me dije se është pajisur me lejen e ndërtimit dhe parashikon se punimet për ndërtimin e centralit do të fillojnë më datë 29.1.2026.

- Referuar pikës 1, germa “d”, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.4.2025 dhe nenit 9, të kontratës nr. 4456 rep., nr. 2040 kol., datë 27.5.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të depozituara nga shoqëria në kuadër të licencimit, përcaktohet se, impianti fotovoltaik duhet të fillojë operimin brenda datës 30.4.2028. Shoqëria është brenda këtij afati, ndaj vlerësohet që dhe afati i pikës 3 të vendimit të jetë në përputhje me këto akte.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, të ndryshuar, si vijon:

a) Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria të fillojë operimin/ushtimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.4.2028.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund

ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 156, datë 28.5.2026

**MBI MIRATIMIN E VLERËSIMIT TË
ERE-s PËR GATISHMËRINË E TREGUT
TË DITËS NË AVANCË NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 30, pika 5, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1684 prot., datë 25.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme dhe Sektori i Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi miratimin e vlerësimit të ERE-s për gatishmërinë e tregut të ditës në avancë në Shqipëri”,

konstatoi se:

1. Baza metodologjike dhe procedura paraprake

- Bordin i ERE-s, me vendimin nr. 279, datë 6.11.2025, miratoi “Metodologjinë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë elektrike të ditës në avancë”, e cila përcakton parimet, treguesit dhe metodologjinë e vlerësimit të gatishmërisë së tregut DAM, si kusht paraprak për kalimin nga marrëveshjet e blerjes së energjisë (PPA) në kontratat për diferencë (CfD), në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 24/2023.

- Në mbledhjen e datës 14.4.2026, Bordin i ERE-s shqyrtoi informacionin mbi vijimin e procedurës për vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në

avancë, duke autorizuar vijimin e procesit të konsultimit publik të draftvlerësimit.

2. Konsultimi publik dhe njoftimi i palëve

- Draftvlerësimi u publikua në faqen zyrtare të ERE-s, nën zërin “Konsultime”, datë 15.4.2026, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 24/2023 dhe nenin 12 të rregullores “Mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 162, datë 20.10.2020.

- Gjatë procesit të konsultimit publik, ERE mori sugjerime nga palë interesi. Me shkresë nr. 4-05/26, datë 4.5.2026, “GEN-I Tërana” sh.p.k. paraqiti sugjerime mbi vlerësimin. Sugjerimet e kësaj pale janë shqyrtuar nga ERE dhe nuk janë marrë në konsideratë në finalizimin e dokumentit.

- Sugjerimet e paraqitura nga shoqëria “GEN-I Tërana” sh.p.k., u shqyrtuan dhe u konstatua se metodologjia e vlerësimit është miratuar paraprakisht me vendimin nr. 279, datë 6.11.2025 të Bordit të ERE-s, pas një procesi konsultimi publik, dhe se vlerësimi i gatishmërisë së tregut është kryer, në përputhje me treguesit dhe kriteret e përcaktuara në këtë metodologji. Gjithashtu, u vlerësua se çështjet e ngritura në lidhje me strukturën dhe organizimin e tregut përbëjnë elemente me karakter strategjik dhe nuk ndikojnë në rezultatet e vlerësimit të kryer, sipas metodologjisë në fuqi, ndaj u vlerësua që sugjerimet të mos reflektohen në dokumentin përfundimtar.

- Komentet e subjektit janë publikuar, gjithashtu në faqen zyrtare të ERE-s, nën zërin “Konsultime”, në frymën e transparencës dhe procesit të konsultimit publik.

3. Përmbajtja dhe treguesit e vlerësimit

- Vlerësimi mbështetet në të dhënat e periudhës 12-mujore, nga data 1 nëntor 2024 deri më 31 tetor 2025 për tregun e bashkuar Shqipëri–Kosovë të ALPEX-it, dhe analizon katër tregues të detyrueshëm dhe dy tregues plotësues, në përputhje me metodologjinë e miratuar.

- Treguesi i disponueshmërisë së çmimit: ALPEX-i ka siguruar çmim klerimi për çdo orë gjatë gjithë periudhës së analizuar (12 muaj), duke plotësuar pragun minimal të këtij treguesi.

- Faktori i qarkullimit (*churn factor*): vlera e llogaritur është 0.102, ndjeshëm më e ulët se të gjitha tregjet krahasuese (HUPX 0.511, CROPEX 0.359, TGE 0.168), duke treguar se pjesë e vogël e energjisë



tregtohet nëpërmjet mekanizmeve të hapura konkurrencte.

- Diferenca ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*): mediana në ALPEX është 9.7% e çmimit mesatar, pesë herë më e lartë se në HUPX (1.2% në 2019), duke treguar kapacitet të kufizuar të tregut për të përthithur vëllime shtesë.

- Thellësia e tregut: në 25% të orëve, tregu nuk do të kishte qenë i aftë të përthithte më shumë se 146 mw ofertë të re me çmim zero, duke ruajtur çmim pozitiv klerimi, nivel i pamjaftueshëm për të mbështetur konvertimin në CfD.

- Konkurrueshmëria (HHI): ana e shitjes është konkurruese (HHI = 853), ndërsa ana e blerjes është mesatarisht e përqendruar (HHI = 1,220). Numri i pjesëmarrësve (32 shitës dhe 33 blerës) është i krahasueshëm me tregjet e BE-së.

- Çmimet e tregut të Shqipërisë dhe Kosovës konvergjojnë në mbi 99% të orëve të periudhës së analizuar, duke justifikuar trajtimin e tyre si treg i bashkuar në llogaritjen e treguesve.

4. Vlerësimet e ERE-s

- Vlerësimi është hartuar në përputhje të plotë me metodologjinë e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 6.11.2025, dhe me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 24/2023.

- Në bazë të analizës së të gjithë treguesve të vlerësuar, tregu i ditës në avancë i ALPEX-it, gjatë periudhës nëntor 2024–tetor 2025, ende nuk plotëson kriteret e gatishmërisë për t'u përdorur si çmim reference në mekanizmat mbështetës CfD për prodhuesit e energjisë nga burimet e rinovueshme në Shqipëri, kryesisht për shkak të faktorit të ulët të qarkullimit dhe thellësisë së pamjaftueshme të tregut.

- Treguesit pozitivë të evidentuar, si disponueshmëria e vazhdueshme e çmimit referencë për 12 muaj, konkurrueshmëria e anës së shitjes dhe *Bid-Ask Spread*, i cili rezulton i disponueshëm në

97.5% të orëve, konfirmojnë drejtimin pozitiv të zhvillimit të tregut.

- Kryerjen e vlerësimit të radhës së gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të ALPEX-it, sipas ciklit të parashikuar nga metodologjia e miratuar, me qëllim rivlerësimin e treguesve, me qëllim rivlerësimin e treguesve pas 6 muajsh nga kryerja e këtij vlerësimi.

- Procedura e konsultimit publik është kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke siguruar transparencë dhe gjithëpërfshirje të palëve të interesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Vlerësimit të ERE-s për gatishmërinë e tregut të ditës në avancë në Shqipëri” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit përfshirë MIE-n, ALPEX sh.a., AAES, AREA, FTL sh.a. dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, për me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrës dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VLERËSIMI I ERE-s PËR GATISHMËRINË E TREGUT TË DITËS NË AVANCË NË SHQIPËRI

Abstrakt

Ky dokument paraqet gjetjet e vlerësimit të parë të gatishmërisë së Tregut të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.

Dispozitat kalimtare të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (ligji për BRE) parashikojnë kryerjen periodike nga Enti Rregullator i Energjisë të vlerësimeve të funksionimit të Tregut të Ditës në Avancë (DAM).¹ ERE ka miratuar “Metodologjinë e vlerësimit të gatishmërisë së Tregut shqiptar të energjisë elektrike të Ditës në Avancë në nëntor 2025.”²

Në metodologji, ERE përcakton parimet dhe treguesit që do të përdoren për të vlerësuar gatishmërinë e tregut DAM të ALPEX-it. Tregu DAM konsiderohet “gati” kur është mjaftueshëm likuid dhe konkurrues për të siguruar një çmim referencë të shpeshtë dhe të qëndrueshëm për kontratat për diferencë (CfD) në Shqipëri. Ky dokument paraqet gjetjet e ERE-së në vlerësimin e parë të tregut.

ERE llogarit treguesit për ALPEX-in dhe i krahason ata me treguesit për tregjet DAM në disa vende të përzgjedhura të Bashkimit Evropian në momentin kur këto vende kanë zbatuar skemat e CfD-ve.

Në metodologji, ERE angazhohet për analizimin e katër treguesve të gatishmërisë së tregut:

Disponueshmëria e çmimit të ditës në avancë: ky tregues tregon nëse ALPEX DAM ka prodhuar çmim tregu për çdo orë për të paktën një periudhë 10-mujore.

Faktori i qarkullimit (*churn*): faktori i qarkullimit (*churn*) shprehet si raporti ndërmjet vëllimit të tregtuar në DAM dhe vëllimit total të konsumuar, pra vëllimit të tregtimit krahasuar me madhësinë fizike të tregut.

Spread-i bid-ask: *Spread-i Bid-Ask* përcaktohet si diferenca ndërmjet çmimit minimal të ofertës së pasuksesshme (shitjes) dhe çmimit maksimal të blerjes së pasuksesshme. Ky është një tregues i likuiditetit, pasi tregon aftësinë e pjesëmarrësve të tregut për të tregtuar vëllime marginale shtesë pa shkaktuar lëvizje të mëdha të çmimit.

Thellësia e tregut (*depth*): thellësia e tregut përshkruan vëllimin e ofertës së re me kosto zero që blerësit në DAM të ALPEX-it do të ishin të gatshëm ta blejnë me një çmim pozitiv. Me fjalë të tjera, ajo mat madhësinë e kërkesës me çmim pozitiv, minus pjesën jopozitive të kurbës së ofertës.

Për të plotësuar treguesit e përzgjedhur, ERE shqyrton edhe dy tregues të tjerë:

Konkurrueshmëria: një ambient konkurrues kontribuon në rritjen e likuiditetit, pasi ekzistojnë më shumë palë të disponueshme për tregtim. Tregjet më konkurruese, gjithashtu, reduktojnë mundësinë që pjesëmarrës individualë të ushtrojnë ndikim mbi çmimet. ERE mat konkurrueshmërinë e tregut përmes indeksit *Herfindahl-Hirschman (HHI)* dhe numrit të pjesëmarrësve.

Bashkimi i tregut: ERE merr në konsideratë çiftimin e tregut shqiptar dhe atij kosovar në kuadër të DAM të ALPEX-it. Nëse tregjet janë të çiftuara dhe interkonektori mes Shqipërisë dhe Kosovës nuk është i tejngarkuar, atëherë ERE përdor të dhënat e tregut të çiftuar për kryerjen e vlerësimit.

Për të vënë në kontekst vlerat e treguesve të ALPEX DAM, ERE i krahason ato me vlerat e të njëjtëve tregues në tregjet DAM të vendeve krahasuese të BE-së. Përzgjedhja e tregjeve krahasuese bëhet në bazë të rishikimit të faktorëve të qarkullimit të publikuar nga ACER, si dhe të analizës së likuiditetit të tregjeve DAM në periudhën kur vendet përkatëse kanë zbatuar vetë skemat e kontratave për diferencë (CfD).

ERE përzgjedh tri vende krahasuese: Poloninë (2016), Hungarinë (2019) dhe Kroacinë (2020). Si rrjedhojë, tregjet DAM përkatëse që merren si referencë janë Bursa Polake e Energjisë (TGE), Bursa Hungareze e Energjisë (HUPX) dhe Bursa Kroate e Energjisë (CROPEX).

ERE llogarit vlerat e treguesve të likuiditetit në tregun e çiftuar të ALPEX-it për periudhën 12-mujore nga 1 nëntor 2024 deri më 31 tetor 2025. Në të njëjtën kohë, ERE llogarit faktorin e *churn*-it në të gjitha tregjet krahasuese, si edhe *Bid-Ask Spread* në tregun HUPX, për vitet kalendarike përkatëse.

¹ Ligji nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, neni 30, “Dispozita kalimtare”, paragrafi 4.

² ERE (2025), “Metodologjia për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë elektrike të ditës në avancë”.



Gjatë periudhës së analizuar, faktori *churn* në ALPEX rezulton më i ulët se në të gjitha tregjet krahasuese, ndërsa *Bid-Ask Spread* në ALPEX është më i lartë se në HUPX gjatë vitit 2019. Përveç kësaj, analiza e thellësisë së tregut të çiftuar të ALPEX-it tregon se, në 25% të orëve, tregu nuk do të kishte qenë në gjendje të përthithte më shumë se 146 mw ofertë të re me çmim zero duke ruajtur një çmim pozitiv të pastrimit të tregut.

Megjithatë, tregu DAM i ALPEX-it shfaq një ecuri pozitive drejt rritjes së likuiditetit. Ai ka prodhuar një sinjal çmimi të pandërprerë për më shumë se 10 muaj, dhe numri i pjesëmarrësve është i krahasueshëm me tregjet e BE-së. Indikatorit HHI sugjeron se tregu i çiftuar është konkurrues në anën e shitjes dhe mesatarisht i përqendruar në anën e blerjes. Gjithashtu, pika e pastrimit të tregut e shteron plotësisht ofertën ose kërkesën vetëm në rreth 2.5% të orëve; me fjalë të tjera, një *Bid-Ask Spread* është i përcaktuar në 97.5% të orëve.

Tabelat 1 dhe 2 më poshtë paraqesin përmbledhjen e treguesve të llogaritur nga ERE.

Tabela 1: Përmbledhje e treguesve në ALPEX dhe në tregjet DAM krahasuese

Treguesi	ALPEX	HUPX (2019)	CROPEX (2020)	TGE (2016)
10 muaj me çmime të pandërprera	✓			
Faktori i qarkullimit ³	0.102	0.511	0.359	0.168
Përqindja e orëve me <i>spread</i> të përcaktuar	97.5%	100%		
HHI – ana e shitjes	853; treg konkurrues			
HHI – ana e blerjes	1,220; mesatarisht i përqendruar			
Numri i pjesëmarrësve	32 shitës, 33 blerës		21 shitës; 20 blerës	39 shitës, 39 blerës

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e bursave të energjisë.

Tabela 2: Statistikat përmbledhëse të shpërndarjes së *Spread-it Bid-Ask* dhe thellësisë së tregut

Treguesi	5th pctl.	25th pctl.	Median	Mesatarja	75th pctl.	95th pctl.
ALPEX, <i>Spread-i Bid-Ask</i> , si përqindje e çmimit mesatar të klerimit të tregut	0.6%	4.0%	9.7%	17.4%	19.2%	51.7%
HUPX, <i>Spread- Bid-Ask</i> , si përqindje e çmimit mesatar të klerimit të tregut	0.2%	0.4%	1.2%	3.7%	3.0%	11.3%
ALPEX – Thellësia e tregut (mw)	93	146	192	211	258	386

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e bursave të energjisë.

Në bazë të kësaj analize, ERE del në përfundimin se tregu DAM i ALPEX-it **ende nuk është gati** për t'u përdorur si çmim referencë për kontratat për mbështetje të energjisë elektrike në Shqipëri.

1. Hyrje dhe kontekst

Dispozitat kalimtare të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (ligji për BRE) parashikojnë që ERE të kryejë vlerësime periodike të funksionimit të Tregut të Ditës-në-Avancë (DAM)⁴. Një vlerësim pozitiv i gatishmërisë së tregut nga ERE, i cili konstaton funksionim të mjaftueshëm të tregut dhe aftësinë e tij për të prodhuar një çmim referencë të shpeshtë dhe të qëndrueshëm, do të aktivizojë konvertimin e marrëveshjeve ekzistuese të mbështetjes së prodhuesve të energjisë nga burime të rinovueshme (PPAs) në kontrata për diferencë (CfDs).⁵

³ Pasi vlerësimet e ACER-it për faktorët e qarkullimit përfshijnë edhe tregtimet jashtë bursës (*Over-the-Counter*), NERA ka llogaritur faktorët e qarkullimit për tregjet krahasuese, duke përdorur vetëm të dhënat e tregut DAM.

⁴ Ligji i BRE, neni 30, “Dispozita kalimtare”, paragrafi 4.

⁵ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Dokumentet e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e projekteve fotovoltaike diellore, që do të marrin masa mbështetëse, në vendndodhjet e identifikuara nga zhvilluesit”, f. 8.



ERE zhvilloi konsultime në lidhje me “Metodologjinë për vlerësimin e tregut” dhe e miratoi atë më 6 nëntor 2025.⁶ Në këtë metodologji, ERE përcakton parimet dhe treguesit që do të përdoren për të vlerësuar gatishmërinë e Tregut të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX).⁷ Në terma ekonomikë, ALPEX DAM konsiderohet “gati” kur arrin të prodhojë një çmim referencë të shpeshtë dhe të qëndrueshëm për kontratat CfD për prodhimin e mbështetur nga BRE në Shqipëri. Për këtë qëllim, një treg konsiderohet i gatshëm, kur është mjaftueshëm likuid dhe konkurrues.

Megjithatë rregullatorët dhe politikëbërësit ndërkombëtarë synojnë të kenë tregje energjie sa më likuide, vetë likuiditeti nuk ka një përkufizim apo standard të vetëm matjeje. Në këtë vlerësim të gatishmërisë së tregut, ERE shqyrton tregues që përshkruajnë aftësinë e pjesëmarrësve të tregut për të blerë apo për të shitur energji në DAM pa shkaktuar luhatje të mëdha të çmimit.

Një treg konkurrues është ai ku blerësit dhe shitësit mund të shkëmbejnë mallra dhe ku asnjë ndërmarrje e vetme nuk ka një pozicion dominues që të ndikojë çmimin e tregut. Ashtu si likuiditeti, edhe konkurrueshmëria mund të matet me disa tregues. Për shembull, Komisioni Rregullator i Tregut të Energjisë në Irlandë SEMC në Irlandë e lidh konceptin e konkurrueshmërisë me fuqinë e tregut, ndërsa Bursa Kroate e Energjisë (CROPEX) e sheh atë përmes përqendrimit të tregut.⁸

Në mungesë të një përkufizimi të përgjithshëm të pranuar për likuiditetin, ERE merr në konsideratë disa tregues të gatishmërisë së tregut, të cilët janë përcaktuar në metodologjinë e miratuar.⁹ ERE përzgjedh treguesit bazuar në ligjin për BRE, kontratat ekzistuese të mbështetjes së prodhuesve, si dhe në praktikatat më të mira ndërkombëtare. Për të përcaktuar gatishmërinë e tregut, ERE llogarit vlerat e treguesve të përzgjedhur dhe i krahason ato me nivelet e vëzhguara në shtetet e tjera të Bashkimit Evropian në momentin kur ato kanë zbatuar kontratat CfD.

Ky dokument vijon si më poshtë:

Seksioni 2 paraqet treguesit që përdor ERE në vlerësimin e gatishmërisë së tregut;

Seksioni 3 përshkruan tregjet krahasuese për ALPEX DAM;

Seksioni 4 paraqet rezultatet e analizës;

Seksioni 5 jep përfundimet.

2. Treguesit e gatishmërisë së tregut

Në përcaktimin e metodologjisë, ERE ka zhvilluar një proces konsultimi mbi treguesit që do të përdoren në vlerësimin e gatishmërisë së tregut. Treguesit e përfshirë në metodologjinë e miratuar pasqyrojnë kërkesat e ligjit për BRE dhe plotësohen me praktikatat më të mira të përdorura në marrëveshjet e mbështetjes së energjisë nga burimet e rinovueshme dhe në shtete të tjera të BE-së, të cilat janë të përshtatshme për t'u marrë si krahasim për ALPEX-in.

2.1 Treguesit e detyrueshëm

Neni 5, paragrafi 1 i metodologjisë së miratuar përcakton se ERE duhet të marrë në konsideratë dy elemente kryesore në vlerësimin e gatishmërisë së tregut:

- Disponueshmërinë e pandërprerë të çmimit të Tregut të Ditës në Avancë; dhe

- Likuiditetin e tregut, i matur përmes faktorit të qarkullimit (*churn*), pra raportit ndërmjet vëllimit të energjisë së tregtuar në DAM dhe konsumit total.¹⁰

Në metodologji, ERE është angazhuar të shqyrtojë metodologjinë e përdorur nga Agjencia e Rregullatorëve të Energjisë të BE-së (ACER). Për të mundësuar krahasimin e faktorëve të *churn*-it midis

⁶ ERE (2025), Metodologjia për Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut të Ditës në Avancë.

⁷ Ky dokument i referohet Tregut të Ditës në Avancë të ALPEX-it. Vlerësimi bazohet te tregu i bashkuar Shqipëri–Kosovë gjatë periudhave kur tregjet e bashkuara japin rezultate. Tregu është bashkuar për herë të parë në muajin shkurt 2024.

⁸ Komisioni SEM (8 maj 2015), “Dokumenti i diskutimit për zbutjen e fuqisë së tregut të integruar të energjisë elektrike SEM-15-031”, f. 3–4. Bursa Kroate e Energjisë, Raporti Vjetor 2023, f. 8.

⁹ ERE (2025), Metodologjia për Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut të Ditës në Avancë, neni 5.

¹⁰ Ligji për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (BRE) po ashtu kërkon që ERE të analizoje nëse tregu ka aplikuar parimet dhe rregullat për integritetin dhe transparencën e shitjes së energjisë. Ligji i BRE, neni 30, “Dispozita kalimtare”, paragrafi 4.

ALPEX-it dhe vlerave që publikon ACER, ERE përdor të njëjtën qasje si ACER.¹¹ Kjo do të thotë se faktori I qarkullimit (*churn*) llogaritet si:

$$Churn_Y = \frac{\sum_{h=1}^n \text{Vëllimi i tregtimit në DAM për orën } h}{\sum_{h=1}^n \text{Konsumi në orën } h}$$

ku n është numri i orëve në vitin Y .

2.2 Treguesit plotësues


Neni 5, paragrafi 3, i metodologjisë së miratuar parashikon se ERE mund të marrë në konsideratë edhe dy tregues shtesë. Përdorimi i këtyre treguesve varet nga disponueshmëria e të dhënave në tregjet e tjera të BE-së për qëllime krahasimi:

- *Bid-Ask Spread*, i cili përshkruan diferencën ndërmjet çmimit minimal të ofertës së pasuksesshme të shitjes (ask) dhe çmimit maksimal të ofertës së pasuksesshme të blerjes (bid); dhe
- Thellësia e tregut (*market depth*), e cila mat nëse tregu mund të përthithë ofertë të re nga burimet e rinovueshme brenda renditjes sipas meritës së kostos.

2.2.1 Diferenca ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*)

Diferenca ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) përbën një masë të drejtpërdrejtë të likuiditetit të tregut, pasi tregon aftësinë e pjesëmarrësve për të tregtuar vëllime marginale shtesë të energjisë pa shkaktuar lëvizje të konsiderueshme të çmimit. Vlera e *Bid-Ask Spread* nuk përshkruan në detaje kurbat e ofertës dhe kërkesës dhe as nuk pasqyron efektet e tregtimit të vëllimeve të ndryshme në treg. Figura 2.1 paraqet një ilustrim të konceptit të *Bid-Ask Spread*.

Grafiku 2.1: Ilustrim i *Bid-Ask Spread*



Shënim. Kurbat e ofertës dhe kërkesës janë vetëm për ilustrim.

Llogaritja e *Bid-Ask Spread* kërkon të dhëna të detajuara të librit të porosive për tregun DAM dhe tregjet e bashkuara. ERE ka marrë të tilla të dhëna për tregun DAM të ALPEX-it dhe për tregun DAM të Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX). Këto të dhëna nuk janë të disponueshme për tregjet e tjera krahasuese.¹²


¹¹ ERE ka sqaruar formulën që ka përdorur ACER për të llogaritur faktorin e qarkullimit në përputhje me metodologjinë e ACER. Duke qenë se ACER përdor si tregtitë jashtë bursës (OTC), ashtu edhe tregtitë në Tregun e Ditës në Avancë (DAM) për llogaritjen e faktorit të qarkullimit, konsulti i ERE-s llogarit, gjithashtu, faktorin e qarkullimit për tregjet krahasuese, duke përdorur vetëm të dhëna nga Tregu i Ditës në Avancë (DAM).

¹² Shiko seksionin 3 për për zgjedhjen e tregjeve krahasuese dhe shtojcën B.2 për detaje mbi mbledhjen e të dhënave.

2.2.2 Thellësia e tregut

Në kuadër të analizës së gatishmërisë së tregut, ERE përdor treguesin e thellësisë së tregut (*market depth*) për të vlerësuar nëse oferta nga burimet e rinovueshme, që do të hynte në tregun DAM të ALPEX-it, pas një vlerësimi pozitiv të gatishmërisë, do të ndërthuret me kurbën e kërkesës në segmentin e saj me çmime jonegative.¹³ Kjo siguron që: çmimi referencë për CfD-të të mos jetë negativ, pasi një çmim negativ do të sillte një kosto shtesë për politikën mbështetëse; dhe që, në terma ekonomike, oferta nga burimet e rinovueshme të ndërpritet me kurbën e kërkesës në një segment ku pjesëmarrësit e tregut kanë një vullnet pagese jonegativ për energjinë elektrike. Figura 2.2 ilustron efektet e futjes së kapaciteteve të reja të rinovueshme mbi ofertën, çmimin e tregut dhe vëllimet e tregtuara.

Grafiku 2.2: Ilustrim i ndryshimeve në çmim, vëllimin e tregtuar dhe thellësinë e tregut kur kapacitetet e rinovueshme hyjnë në DAM



Shënim. Kurbat e ofertës dhe kërkesës janë vetëm ilustrative. Figura supozon se kapacitetet e rinovueshme që hyjnë në tregun DAM kanë kosto marginale zero, ndaj ato pozicionohen në kurbën e ofertës pas ofertave me çmim jopozitiv.

Vlerësimi i thellësisë së tregut kërkon të dhëna të detajuara nga libri i porosive. Meqenëse treguesi i thellësisë lidhet me rritjen e pritshme të kapaciteteve që do të shiten në DAM, ERE vlerëson thellësinë e tregut vetëm për tregun DAM të ALPEX-it.

2.3 Treguesit e tjerë të përdorur nga vendet krahasuese të BE-së

Përveç treguesve të përcaktuar në nenin 5 të metodologjisë përfundimtare, ERE analizon edhe dy tregues të konkurrueshmërisë së tregut DAM të ALPEX-it. Këta tregues përfshijnë numrin e pjesëmarrësve në treg dhe indeksin *Herfindahl-Hirschman* (HHI).

HHI mat përqendrimin e tregut dhe përdoret gjerësisht në vlerësimin e bashkimeve dhe blerjeve, si dhe në analizat e vendeve krahasuese të BE-së për të vlerësuar shkallën e përqendrimit në tregjet e energjisë elektrike.¹⁴ ERE i krahason rezultatet e llogaritura me pragjet e zakonshme që përdoren për vlerësimin e konkurrueshmërisë. HHI përllogaritet si shuma e katrorëve të pjesëve të tregut të të gjithë pjesëmarrësve në treg. Në këtë kuadër, ERE përdor formulën e mëposhtme për llogaritjen e HHI-së, veçmas për anën e ofertës (*supply side*) dhe atë të kërkesës (*demand side*):

$$HHI = \sum_n (MS_n)^2$$

ku n përfaqëson pjesëmarrësin individual dhe MS pjesën e tij të tregut.

¹³ Projektimi i Tregut të Ditës në Avancë i lejon çmimet negative. Në kontekstin e ALPEX-it, çmimi dysheme është €-500/mWh.

¹⁴ Si shembull, referojuni ACER/CEER (2025), 2025 Raporti për Monitorimin e Tregut në Poloni, faqe 51.



3. Përzgjedhja e tregjeve krahasuese dhe periudhave të analizës

Siç përcakton ERE në metodologji, vlerat e treguesve të përzgjedhur krahasohen me vlerat e vëzhguara në tregjet krahasuese të BE-së.¹⁵ Meqenëse ERE kryen vlerësimin e gatishmërisë së tregut për të mundësuar konvertimin e PPA-ve në CfD, ne përzgjedhim tregjet krahasuese nga vende që tashmë kanë zbatuar vetë kontratat CfD.

3.1 Tregjet krahasuese më të përshtatshme për Shqipërinë

Deri më sot, kontratat dypalëshe për diferencë (*two-sided CfDs*) janë përdorur në dymbëdhjetë shtete anëtare të Bashkimit Evropian.¹⁶ Këto shtete anëtare janë: Franca, Spanja, Danimarka, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Polonia, Kroacia, Portugalia, Lituania dhe Rumania.¹⁷

Tregjet krahasuese të BE-së që kanë zbatuar skema të CfD-ve kanë vlerësuar se tregjet e tyre të Ditës në Avancë (DAM) janë mjaftueshëm likuide për të mbështetur funksionimin e këtyre skemave. Prandaj, prova se ALPEX DAM është po aq likuid dhe konkurrues sa tregjet DAM të vendeve krahasuese do të mbështeste një vlerësim pozitiv të gatishmërisë së tregut.

ERE vlerëson likuiditetin e ALPEX DAM, duke e krahasuar atë me treguesit e likuiditetit të tregjeve të përzgjedhura të BE-së në periudhën kur secili shtet anëtar ka futur skemën e CfD-ve. Likuiditeti aktual i tregjeve krahasuese mund të jetë më i lartë sesa në kohën e futjes së CfD-ve, pasi vetë zbatimi i skemave CfD mund të ketë nxitur rritjen e likuiditetit. Disa prej këtyre tregjeve kanë operuar me CfD për më shumë se pesë vjet dhe likuiditeti i tyre mund të jetë përmirësuar me kalimin e kohës.

Më tej, ERE përqendrohet te tregjet krahasuese të BE-së që paraqesin *vlerat më të ulëta* të treguesve të likuiditetit, por që megjithatë operojnë skema CfD për energjinë e rinovueshme. Krahasimi me këto tregje i ofron ERE-s një tregues të nivelit minimal të likuiditetit që kërkohet në tregjet DAM të Evropës për të futur një skemë CfD.

Për të përzgjedhur tregjet krahasuese, janë rishikuar faktorët e *churn*-it të llogaritur nga ACER në periudhën kur DAM-et përkatëse kanë futur mbështetjen me CfD, ose në vitin paraardhës. Tabela 3.1 më poshtë paraqet momentin e zhvillimit të ankandit të parë dhe faktorët e *churn*-it të llogaritur nga ACER.

¹⁵ ERE (2025), “Metodologjia për vlerësimin e gatishmërisë së tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë”, neni 7.

¹⁶ Një impiant që mbështetet nga një kontratë dypalëshe për diferencë (*two-sided CfD*) ose merr ose kthen mbrapsht diferencën ndërmjet çmimit referencë të tregut dhe çmimit strike.

¹⁷ *Florence School of Regulation* (2024), “Kontratat për diferencë për mbështetjen e teknologjive të energjisë së rinovueshme: Konsiderata për projektimin dhe zbatimin”; AURES II (2022), “Ankandet për mbështetjen e energjisë së rinovueshme në Kroaci”; Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) (2025), “Me mbështetjen e BERZH-it, Rumania zhvillon ankandin e dytë të suksesshëm për energjinë e rinovueshme”; Komisioni Evropian (2023), Ndihma shtetërore: Komisioni miraton skemën lituaneze prej 193 milionë eurosh për mbështetjen e parqe eolike në det, me qëllim nxitjen e tranzicionit drejt një ekonomie me emetime neto-zero.

**Tabla 3.1:** Ankandi i Parë për CfD dhe faktorët e qarkullimit në vendet krahasuese të BE-së

Shteti	Ankandi i parë për CfD	Faktori i qarkullimit-it para ankandit të parë
Francë	2016	0.225 (2015)
Spanjë	2021	0.810 (Iberia, 2020)
Danimarkë ¹⁸	2005	NA
Greqi	2016	1.028 (2015)
Hungari	November 2019	0.533 (2019)
Irlandë	2020	1.068 (2019)
Itali	2019	0.702 (2018)
Poloni	December 2016	0.169 (2016)
Kroaci	December 2020	0.385 (2020)
Portugali	2019	0.795 (Iberia, 2018)
Rumani	2024	0.32 (2023)
Lituani	2023	0.95 (2022)

*Burimi: ACER, Florence School of Regulation, AURES II.*¹⁹

Shënim. ACER ka publikuar faktorët e qarkullimit deri në vitin 2022. Spanja dhe Portugalia operojnë një treg të përbashkët rajonal të energjisë në Gadishullin Iberik.

Faktorët e qarkullimit sugjerojnë që ERE duhet të marrë në konsideratë Kroacinë, Hungarinë, Rumaninë dhe Poloninë si tregje krahasuese për Tregun e Ditës në Avancë të ALPEX-it. Pavarësisht vlerës së ulët të qarkullimit, Franca nuk përbën një treg krahasues të përshtatshëm, pasi ACER ka sqaruar se qarkullimi i ulët francez lidhet me faktin që një pjesë e konsiderueshme e energjisë tregtohet përmes kontratave bilaterale ose mekanizmave të veçantë kombëtarë.²⁰ Për më tepër, Franca e kishte Tregun e Ditës në Avancë të saj të bashkuar me Belgjikën dhe Holandën për gati dhjetë vjet në kohën kur zhvilloi ankandin e parë të Kontratave për Diferencë, CfD-ve.²¹ Për këtë arsye, faktori i qarkullimit për Francën, e marrë më vete, nuk përfaqëson në mënyrë të saktë nivelin real të likuiditetit në tregun e gjerë të bashkuar. Aktiviteti faktik i tregut në Francë është dukshëm më i lartë sesa vlera që reflektohet nga llogaritjet e ACER-it.

Shtetet e tjera anëtare me faktorë qarkullimi më të lartë nuk janë aq të përshtatshme si tregje krahasuese. Likuiditeti i tregjeve të tyre të Ditës në Avancë (DAM), i matur përmes faktorëve të qarkullimit, është më i madh sesa niveli minimal i nevojshëm për të futur skemat e CfD-ve. Për më tepër, disa juridiksione, përfshirë Greqinë dhe Irlandën, paraqesin faktorë qarkullimi jashtëzakonisht të lartë për një Treg të Ditës në Avancë (d.m.th. mbi 1), për shkak se pjesëmarrja në tregun e ditës në avancë është e detyrueshme ose shumë e favorshme për prodhuesit.²² Megjithatë pjesëmarrja në Tregun e Ditës në Avancë (DAM) nuk është e detyrueshme për prodhuesit e energjisë elektrike në Irlandë, ajo njihet gjerësisht si i vetmi mekanizëm për të siguruar pozicion D-1 në tregun me shumicë të energjisë elektrike, i cili minimizon ekspozimin e prodhuesit ndaj tregut të balancimit.²³ Pikërisht, për shkak të këtyre

¹⁸ Danimarka ka alokuar mbështetje për CfD vetëm për parqet eolike në det. Danimarka organizoi një ankand teknologjikisht neutral në vitin 2021, por nuk u paraqit asnjë ofertë. (*Danish Energy Agency (2021)* “Përfundimi i tenderit teknologjikisht neutral 2021”).

¹⁹ Raporti i Monitorimit të Tregut të ACER për vitet 2020, 2021 dhe 2023; paneli i të dhënave të ACER, i disponueshëm në adresën: https://www.acer.europa.eu/monitoring/MMR/electricity_gas_key_developments_2025. Aksesi, kryer më 2.12.2025. *Florence School of Regulation (2024)*, “Kontratat për diferencë për mbështetjen e teknologjive të energjisë së rinovueshme: Shqyrtim për projektimin dhe zbatimin”; *AURES II (2022)*, “Ankandet për mbështetjen e energjisë së rinovueshme në Kroaci”; *AURES II (2020)*, “Ankandet për mbështetjen e energjisë së rinovueshme në Hungari”.

²⁰ ACER (2023), “Progresi i integritetit të tregut me shumicë të energjisë elektrike në BE”, paragrafi 55.

²¹ EPEX Spot faqja zyrtare, link: <https://www.epexspot.com/en/marketcoupling>. Aksesi, kryer më 2.12.2025.

²² *Hellenic Energy Exchange (14 tetor 2021)*, Rregulloja e Tregtimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe Brenda Ditës (Day-Ahead & Intra-Day Markets Trading Rulebook), seksioni 4.1.4, paragrafi 1.

²³ Faqja zyrtare e Komitetit të Tregut të Vetëm të Energjisë Elektrike – *Single Electricity Market Committee*, “Si funksionon SEM”, seksioni për Tregun e Ditës në Avancë (Day-Ahead Market), link: <https://www.semcommittee.com/how-sem-works>. Accessed 27.8.2024.



rregullimeve të veçanta të tregut, këto tregje të Ditës në Avancë nuk përbëjnë tregje krahasuese të përshtatshme për Shqipërinë.

ERE merr, gjithashtu, në konsideratë bashkimin e tregjeve krahasuese. Nëse një Treg i Ditës në Avancë (DAM) më i vogël dhe me qarkullim më të ulët është i bashkuar me një Treg të Ditës në Avancë më të madh, vlera e ulët e qarkullimit mund të mos tregojë realisht likuiditet të ulët në tregun krahasues, pasi Tregu i Ditës në Avancë më i madh mund të kontribuojë në rritjen e likuiditetit brenda tregut të përbashkët të bashkuar.

Të gjitha tregjet potenciale krahasuese janë aktualisht të bashkuara me fqinjët e tyre. Hungaria ka bashkuar tregjet e saj të Ditës në Avancë (DAM) me Çekinë dhe Sllovakinë në vitin 2012, dhe Rumania iu bashkua tregut të bashkuar në vitin 2014.²⁴ Tregu i bashkuar, 4M MC, iu bashkua Bashkimit të Ditës në Avancë në një të Vetëm (SDAC) Evropian së bashku me Tregun e Ditës në Avancë të Polonisë në qershor 2021.²⁵ Tregu kroat i Ditës në Avancë u bashkua, gjithashtu, me Bashkimin e Ditës në Avancë në një të Vetëm (SDAC) në vitin 2018 përmes kufirit Kroaci–Slloveni, dhe në qershor 2022 edhe përmes kufirit Kroaci–Hungari.²⁶ Përveç Bashkimit të Ditës në Avancë në një të Vetëm (SDAC), Tregu i Ditës në Avancë i Polonisë u bashkua me vendet nordike përmes Suedisë në vitin 2010.²⁷

Për vlerësimin e gatishmërisë së tregut, ERE përqendrohet te Kroacia, Hungaria dhe Polonia si tregje krahasuese potenciale. Edhe pse Rumania ka një faktor qarkullimi relativisht të ulët, ajo është e bashkuar me juridiksione të tjera që prej vitit 2014, gjë që mund të sjellë likuiditet më të lartë sesa niveli i paraqitur në tabelën 3.1. Për këtë arsye, tregjet e Ditës në Avancë të përdorura si krahasim në këtë studim janë CROPEX për Kroacinë në vitin 2020, HUPX për Hungarinë në vitin 2019 dhe *Polish Power Exchange (TGE)* për Poloninë në vitin 2016.²⁸

4. Llogaritja e treguesve

4.1 Përmbledhja e treguesve

Për të kryer vlerësimin e gatishmërisë së Tregut të Ditës në Avancë të ALPEX-it, ERE llogarit treguesit e përcaktuar në seksionin 2. Për ALPEX-in, përdoren të dhënat e 12 muajve, nga 1 nëntori 2024 deri më 31 tetor 2025, për të vlerësuar nivelin e këtyre treguesve.²⁹ Për tregjet krahasuese, analizojmë të dhënat për një vit kalendarik në vitin kur shtetet përkatëse kanë futur skemat e CfD-ve. Konkretisht, analizojmë të dhënat e HUPX-it nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2019, të dhënat e CROPEX-it nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2020, dhe të dhënat e TGE-së nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2016.

Tabelat 4.1 dhe 4.2 përmbledhin vlerat e treguesve. Siç shihet në tabelën e parë, tregu i Ditës në Avancë i ALPEX-it ka një faktor qarkullimi më të ulët sesa tregjet krahasuese të përzgjedhura. Megjithatë, numri i pjesëmarrësve në tregun e bashkuar të ALPEX-it është në linjë me tregjet krahasuese dhe ana e ofertës në tregun e ditës në avancë është konkurruese. Tabela e dytë tregon se Tregu i Ditës në Avancë i ALPEX-it paraqet vlera më të larta të *Bid-Ask Spread* krahasuar me tregun HUPX në vitin 2019. Rezultatet paraqiten në përqindje për secilin përqindje (pctl.). Për shembull, 25 për qind e vlerave të *Bid-Ask Spread* në ALPEX janë më të ulëta se 4.0 për qind e çmimit mesatar të klerimit të tregut.

²⁴ Faqja zyrtare e Bursës Hungareze të Energjisë, link: <https://hupx.hu/en/about-us/10-year-anniversary>, Aksesi kryer më 15.8.2024.

²⁵ Faqja zyrtare e operatorit të sistemit të transmetimit të Polonisë, link: <https://raport2021.pse.pl/en/economic-and-market-impact/integration-of-the-polish-market-with-european-markets>. Aksesi, kryer më 16.8.2024.

²⁶ Bursa Kroate e Energjisë Elektrike (CROPEX) (2024), Raporti Vjetor 2023, f. 10.

²⁷ *Nord Pool* (2010) nr. 74/2010 NPS – Nisja e suksesshme e bashkimit të çmimeve midis Rajonit Nordik dhe Polonisë.

²⁸ Bursa Polake e Energjisë Elektrike quhet *Towarowa Giełda Energii* në gjuhën polake.

²⁹ Për disponueshmërinë e çmimeve, mjafton që çmimet të jenë të disponueshme në çdo periudhë tregtimi përgjatë një periudhe prej 10 muajsh.

**Tabela 4.1:** Përmbledhja e treguesve në ALPEX dhe tregjet krahasuese DAM i vendeve të tjera

Treguesi	ALPEX	HUPX (2019)	CROPEX (2020)	TGE (2016)
10 muaj me çmime të pandërprera	✓			
Faktori i qarkullimit ³⁰	0.102	0.511	0.359	0.168
Pjesa e orëve në të cilat <i>Bid-Ask Spread</i> është i përcaktuar	97.5%	100%		
HHI, ana e ofertës	853; konkurrues			
HHI, ana e kërkesës	1,220; mesatarisht e përqendruar			
Numri i pjesëmarrësve	32 shitës, 33 blerës		21 shitës; 20 blerës	39 shitës, 39 blerës

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e bursave të energjisë.

Tabela 4.2: Statistikat përmbledhëse të shpërndarjes së *Bid-Ask Spread* dhe thellësisë së tregut

Treguesi	5th pctl.	25th pctl.	Median	Mesatar ja	75th pctl.	95th pctl.
ALPEX, <i>Bid-Ask Spread</i> , si përqindje e çmimit mesatar të klerimit të tregut	0.6%	4.0%	9.7%	17.4%	19.2%	51.7%
HUPX, <i>Bid-Ask Spread</i> , si përqindje e çmimit mesatar të klerimit të tregut	0.2%	0.4%	1.2%	3.7%	3.0%	11.3%
Thellësia e ALPEX-it (MW)	93	146	192	211	258	386

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e bursave të energjisë.

4.2 Disponueshmëria e çmimeve

Konvertimi i marrëveshjeve ekzistuese të mbështetjes për prodhuesit e energjisë nga burimet e rinovueshme, nga PPA në CfD, kërkon që çmimi referencë të jetë i disponueshëm në çdo periudhë tregtimi. Metodologjia përfundimtare e ERE-s përcakton se çmimet referencë duhet të kenë qenë të disponueshme për të paktën 10 muaj.

Gjatë periudhës nga 1 nëntori 2024 deri më 31 tetor 2025, ERE konstatoi se ALPEX-i ka siguruar një çmim klerimi të tregut për Shqipërinë dhe Kosovën në çdo orë të periudhës dymbëdhjetëmuajore. Për rrjedhojë, Tregu i Ditës në avancë i ALPEX-it ka ofruar një çmim referencë të vazhdueshëm për CfD për më shumë se 10 muaj dhe plotëson këtë kriter të përcaktuar në metodologjinë përfundimtare të ERE-s.

4.3 Bashkimi i tregut

ALPEX-i ka bashkuar Tregun e Ditës në Avancë të Shqipërisë dhe atë të Kosovës në shkurt 2024. Në një treg të bashkuar, pjesëmarrësit në treg paraqesin ofertat e tyre për energji elektrike pa marrë individualisht alokime të kapaciteteve ndërkufitare. ALPEX-i merr në konsideratë kapacitetin ndërkufitar të disponueshëm gjatë procesit të llogaritjes së çmimit, për të minimizuar diferencat e çmimeve midis tregut shqiptar dhe atij kosovar.

Nëse linja e interkoneksionit midis Shqipërisë dhe Kosovës nuk është duke funksionuar me kapacitet të plotë, çmimet në tregun e bashkuar konvergojnë. Në këto orë, urdhrat e blerjes dhe të shitjes nga të dyja anët e tregut kontribuojnë në formimin e një çmimi të vetëm, dhe treguesit si *Bid-Ask Spread* dhe thellësia e tregut në këtë treg të përbashkët janë të njëjta me ato të tregjeve individuale. Megjithatë, nëse kufizimet e interkoneksionit bëhen penguese, çmimet në dy tregjet nuk konvergojnë dhe kombinimi i kurbave të ofertës dhe kërkesës së dy tregjeve nuk përshkruan më në mënyrë të saktë situatën në secilën anë të interkoneksionit.

³⁰ Meqenëse vlerësimet e faktorëve të qarkullimit nga ACER përfshijnë edhe transaksione jashtë bursës (*Over-the-Counter*), NERA ka llogaritur faktorët e qarkullimit për tregjet krahasuese, duke përdorur vetëm të dhënat e Tregut të Ditës në Avancë (DAM).



Çmimet e tregut në Shqipëri dhe Kosovë ndryshojnë në 57 nga 8,760 orët e periudhës së analizuar. Me fjalë të tjera, çmimet e tregut në Shqipëri dhe Kosovë janë të njëjta në më shumë se 99 për qind të orëve të periudhës së analizës. Për rrjedhojë, për vlerësimin e gatishmërisë së tregut, ERE do të konsiderojë tregjet e Ditës në Avancë në Shqipëri dhe në Kosovë, të bashkuara, dhe do të llogarisë treguesit e likuiditetit dhe konkurrueshmërisë në përputhje me këtë.³¹

4.4 Faktori i qarkullimit

Siç përcaktohet në metodologjinë e miratuar, ERE llogarit faktorët e qarkullimit në Tregun e Ditës në Avancë të ALPEX-it dhe i krahason ato me faktorët e qarkullimit në tregjet krahasuese. Faktori i qarkullimit përcaktohet si sasia e energjisë elektrike e tregtuar në DAM, pjesëtuar me konsumin total në zonën përkatëse.

Në llogaritim faktorët e qarkullimit për Tregun e Ditës në Avancë të bashkuar të ALPEX-it. Kjo do të thotë se analizojmë shumën e volumeve të tregtuara në tregun e bashkuar në të gjitha orët e periudhës së analizës dhe e pjesëtojmë atë me shumën e kërkesës së sistemit në Shqipëri dhe Kosovë gjatë së njëjtës periudhë.

Për tregjet krahasuese, vlerësimet e faktorëve të qarkullimit nga ACER marrin në konsideratë edhe transaksionet jashtë bursës (*Over-the-Counter*). Për të bërë një krahasim të saktë të faktorëve të qarkullimit, ERE llogarit, gjithashtu, faktorët e qarkullimit të tregjeve krahasuese, duke përdorur vetëm vëllimet e klerimit të tregut në Tregun e Ditës në Avancë.³²

Tabela 4.3 tregon faktorët e qarkullimit në ALPEX dhe në tregjet krahasuese të Ditës në Avancë. Siç shihet nga tabela, ERE konstaton se faktori i qarkullimit në ALPEX është më i ulët se faktorët e qarkullimit në tregjet krahasuese.

Tabela 0.1: Faktorët e qarkullimit në ALPEX dhe në tregjet krahasuese

	ALPEX	HUPX (2019)	CROPEX (2020)	TGE (2016)
Faktori i qarkullimit	0.102	0.511	0.359	0.168

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e bursave të energjisë.

4.5. Diferenca ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*)

ERE vlerëson diferencën mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*) në Tregun e Ditës në Avancë të ALPEX-it për të plotësuar analizën mbi faktorët e qarkullimit (*churn factor*). Vlerësimi i këtij treguesi kërkon të dhëna të detajuara nga libri i porosive të Tregut të Ditës në Avancë të ALPEX-it. Meqë pika e klerimit të tregut dhe vëllimet përcaktohen nga kurbat e ofertës dhe kërkesës në Shqipëri dhe në Kosovë, si dhe nga tregtimet përmes linjës së interkoneksionit, ERE analizon tregun e bashkuar të Ditës në Avancë ALPEX (tregun e bashkuar Shqipëri–Kosovë).³³

Diferenca mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*) mund të përcaktohet vetëm nëse ekziston një urdhër i pambushur, si në anën e blerjes, ashtu edhe në atë të shitjes në Tregun e Ditës në Avancë. Me fjalë të tjera, *Bid-Ask Spread* ekziston kur sasia e klerimit të tregut nuk shteron as ofertën dhe as kërkesën në tregun e bashkuar. ERE konstaton se *Bid-Ask Spread* mund të përcaktohet dhe llogaritet në 97.5 për qind të orëve të kampionit.³⁴ Kjo do të thotë se diferenca mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*) nuk mund të përcaktohet në 2.5 për qind të orëve, p.sh. në orët kur të gjitha urdhrat e kërkesës janë plotësuar ose të gjitha urdhrat e ofertës janë plotësuar. ERE i përjashton këto orë nga statistikën përmbledhëse.

³¹ Në marrim në konsideratë tregtimet dhe kërkesën në tregun e bashkuar për të llogaritur treguesit e qarkullimit dhe konkurrueshmërisë për të gjitha orët e vitit. Për analizën e thellësisë dhe diferencës mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*), ERE përjashton orët në të cilat linja e interkoneksionit është e ngarkuar. Megjithatë ka vetëm 57 orë kongestion në linjën e interkoneksionit, përfshirja e tyre nuk do të ndryshonte përfundimet e vlerësimit. Për më shumë informacion mbi orët e përjashtuara nga analiza, shih shtojcën 0.

³² Faktorët e qarkullimit, pa përfshirë tregtitë jashtë bursës (*Over-the-Counter*), janë të ngjashëm me faktorët e qarkullimit që publikon ACER.


³³ ERE përjashton nga analiza 57 orët në të cilat linja e interkoneksionit është e ngarkuar.

³⁴ ERE përjashton nga kampioni orët në të cilat rezultatet e tregut dhe kurbat e ofertës dhe të kërkesës të publikuara nga ALPEX-i nuk janë të përputhshme, ose në të cilat tregu nuk mund të konsiderohet i bashkuar (*coupled*). Shih shtojcën 0.



Grafiku 4.1 paraqet shpërndarjen e diferencës ofertë-kërkesë. Në disa orë, ajo arrin deri në 720 euro/mwh. Megjithatë, shumica e diferencave janë më të ulëta: 75 për qind e tyre janë nën 24.25 euro/mwh. Diferencat më të larta vërehen në fillim të periudhës së analizës, në nëntor 2024.

Grafiku 4.1: Diferenca mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*) në ALPEX DAM



Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e ALPEX-it

Tabela 0.2 paraqet statistikën përmbljedhëse të diferencës mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*), si në terma EUR/mwh, ashtu edhe si përqindje e çmimit mesatar në ALPEX gjatë periudhës së analizës. Tabela tregon se gjysma e vlerave të *Bid-Ask Spread* janë nën 9.7 për qind të çmimit mesatar të Tregut të Ditës në Avancë. Megjithatë, në 25 për qind të orëve, *Bid-Ask Spread* është më i lartë se 19.2 për qind e çmimit mesatar. Për shkak të këtyre vlerave të larta, mesatarja e *Bid-Ask Spread* rezulton më e madhe se mediani.

Tabela 0.2: Statistikat Përmbljedhëse të diferencës mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*) në ALPEX

	Formula	5th pctl.	25th pctl.	Median	Mesatarja	75th pctl.	95th pctl.
Diferenca kërkesë-ofertë, €/mwh	A	0.82	5.00	12.27	22.02	24.25	65.43
Çmimi i tregut, €/mwh	B	126.54					
Diferenca kërkesë-ofertë, si përqindje e çmimit mesatar	A/Mesatarja (B)	0.6%	4.0%	9.7%	17.4%	19.2%	51.7%

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e ALPEX-it.

Përveç ALPEX-it, HUPX-i i ka vënë në dispozicion ERE-së kurbat e ofertës dhe kërkesës që janë të mjaftueshme për të përcaktuar pikën e klerimit të tregut dhe diferencën mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*) për vitin 2019.³⁵

Ashtu si ALPEX-i, edhe HUPX-i ka orë të veçanta me diferencë të lartë mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*). Si rezultat, mesatarja e këtij treguesi është më e lartë se mediani. Megjithatë, diferenca mes ofertës dhe kërkesës në HUPX gjatë vitit 2019 është në mënyrë të qëndrueshme më e ulët se ajo në ALPEX, përgjatë periudhës së analizës, kur shprehet si përqindje e çmimit mesatar të Tregut të Ditës në

³⁵ Në vitin 2019, ka tri ditë midis 28 nëntorit dhe 1 dhjetorit në të cilat vëllimet e klerimit të tregut nuk janë të përputhshme me kurbat e ofertës dhe kërkesës. Këto orë i përjashtojmë nga kampioni.



Avancë. Tabela 0.3 paraqet statistikën përmblledhëse të diferencës mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*) në Tregjet e Ditës në Avancë të ALPEX-it dhe HUPX-it.

Tabela 0.3: Diferenca mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*) në ALPEX dhe në HUPX, si përqindje e çmimit mesatar të Tregut të Ditës në Avancë (DAM)

	5th pctl.	25th pctl.	Mediani	Mesatarja	75th pctl.	95th pctl.
Diferenca kërkesë-ofertë, ALPEX	0.6%	4.0%	9.7%	17.4%	19.2%	51.7%
Diferenca kërkesë-ofertë, HUPX	0.2%	0.4%	1.2%	3.7%	3.0%	11.3%

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e ALPEX-it dhe HUPX-it.


4.6. Thellësia e tregut

ERE analizon thellësinë e tregut të ALPEX-it, e cila matet si diferenca midis kërkesës maksimale (me çmim pozitiv) dhe ofertës me çmim jopozitiv në treg, me qëllim vlerësimin se sa prodhim i ri nga burime të rinovueshme mund të hyjë në Tregun e Ditës në Avancë të ALPEX-it dhe të ndërpritet me kurbën e kërkesës në segmentin e saj me çmim jonegativ. Kjo masë e thellësisë tregon se sa ofertë të re me kosto marginale zero janë të gatshëm të blejnë pjesëmarrësit e tregut.

Siç tregohet në grafik, thellësia e tregut është pozitive në të gjitha orët dhe duket se rritet përgjatë periudhës së analizës. Thellësia minimale e tregut ishte 14.5 mw, të cilën e arriti në fund të prillit 2025.

Grafiku 4.2 paraqet thellësinë e tregut në ALPEX gjatë gjithë periudhës së analizës.³⁶ Siç tregohet në grafik, thellësia e tregut është pozitive në të gjitha orët dhe duket se rritet përgjatë periudhës së analizës. Thellësia minimale e tregut ishte 14.5 mw, të cilën e arriti në fund të prillit 2025.

Grafiku 4.2: Thellësia e tregut në ALPEX (*ALPEX Market Depth*)



Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e ALPEX-it.

Tabela paraqet statistikën përmblledhëse të thellësisë së tregut gjatë periudhës së analizës. Siç shihet në tabelë, në 25 për qind të orëve thellësia e tregut është më pak se 145.9 mw, çka do të thotë se Tregu i Ditës në Avancë i ALPEX-it nuk do të kishte qenë në gjendje të përthithte 145.9 mw kapacitet të ri me çmim pozitiv në 25 për qind të kohës gjatë 12 muajve ndërmjet nëntorit 2024 dhe tetorit 2025.

³⁶ ERE dhe konsulenti i saj përjashtojnë të njëjtin grup orësh për analizën e thellësisë, ashtu si edhe për analizën e diferencës mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spread*). Shih shtojcën B.



Tabela 4. Tabela paraqet statistikat përmbledhëse të thellësisë së tregut gjatë periudhës së analizës. Siç shihet në tabelë, në 25 për qind të orëve thellësia e tregut është më pak se 145.9 mw, çka do të thotë se Tregu i Ditës në Avancë i ALPEX-it nuk do të kishte qenë në gjendje të përthithte 145.9 mw kapacitet të ri me çmim pozitiv në 25 për qind të kohës gjatë 12 muajve ndërmjet nëntorit 2024 dhe tetorit 2025.

Tabela 4.6: Statistikat përmbledhëse të thellësisë së tregut në ALPEX

	5th pctl.	25th pctl.	Mediani	Mesatarja	75th pctl.	95th pctl.
Thellësia, mw	93.0	145.9	191.6	210.8	257.9	385.7

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e ALPEX-it.

4.7 Konkurrueshmëria

ERE analizon konkurrueshmërinë e Tregut të Ditës në Avancë të ALPEX-it, duke vlerësuar numrin e pjesëmarrësve në treg dhe nivelin e përqendrimit të tregut. Për të matur përqendrimin e tregut, ERE llogarit indeksin HHI si për anën e shitjes, ashtu edhe për anën e blerjes në tregun e bashkuar.

Nuk ka pragje universale të indeksit HHI për të përcaktuar nëse një treg është konkurrues apo i përqendruar. Për shembull, udhëzuesit e BE-së për vlerësimin e bashkimeve horizontale përcaktojnë se tregjet me HHI nën 1,000 ka gjasa të jenë konkurruese.³⁷ Udhëzuesit, gjithashtu, vendosin kritere më të rrepta për ndryshimin e indeksit HHI si rezultat i një bashkimi, nëse tregu ka një HHI pas bashkimit prej të paktën 2,000. Udhëzuesit e Departamentit të Drejtësisë së SHBA-së (DOJ) dhe të Komisionit Federal të Tregtisë (FTC) e konsiderojnë tregun me HHI nën 1,000 si konkurrues dhe tregun me HHI mbi 1,800 si shumë të përqendruar.³⁸

ERE përdor pragjet e indeksit HHI të përcaktuara në udhëzimet e BE-së. Për vlerësimin e gatishmërisë së Tregut të Ditës në Avancë, tregu i bashkuar ALPEX konsiderohet konkurrues nëse ka një HHI prej 1,000 ose më pak, mesatarisht i përqendruar nëse HHI është midis 1,000 dhe 2,000, dhe i përqendruar nëse HHI është 2,000 ose më shumë.

Table 4.7 paraqet pjesën e tregut të pjesëmarrësit më të madh, indeksin HHI dhe klasifikimin e Tregut të Ditës në Avancë të bashkuar të ALPEX-it. Siç tregon tabela, tregu është mesatarisht i përqendruar në anën e blerjes dhe konkurrues në anën e shitjes.³⁹ Pjesëmarrësi i tregut me pjesën më të madhe në anën e blerjes ka një pjesë tregu prej 22 për qind, ndërsa pjesëmarrësi më i madh në anën e shitjes ka një pjesë tregu prej 20 për qind. Për më tepër, në anën e blerjes ka më shumë pjesëmarrës me pjesë tregu prej të paktën 10 për qind sesa në anën e shitjes.

Table 4.7: Përqendrimi i tregut në ALPEX

	Ana e blerjes	Ana e shitjes
Pjesa e tregut e pjesëmarrësit më të madh	22%	20%
HHI	1,220	853
Klasifikimi	Mesatarisht i përqendruar	Konkurrues

Burimi: NERA Analysis of ALPEX data.

ERE analizon, gjithashtu, numrin e pjesëmarrësve në treg në ALPEX dhe në tregjet krahasuese.

Tabla 4. paraqet numrin e pjesëmarrësve në secilin treg, të ndarë sipas anës së shitjes dhe anës së blerjes. Siç tregon tabela, Tregu i Ditës në Avancë i ALPEX-it ka më shumë pjesëmarrës se CROPEX në vitin 2020, por më pak pjesëmarrës se TGE në vitin 2016.

³⁷ Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian (2004/C 31/03), “Udhëzuesi për vlerësimin e bashkimeve horizontale sipas rregullores së Këshillit për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”.

³⁸ Departamenti i Drejtësisë së SHBA-së dhe Komisioni Federal i Tregtisë (2023), Udhëzuesit për Bashkimet 2023. Versionet e mëparshme të udhëzuesve të DOJ-së dhe FTC-së e kanë konsideruar tregun me HHI nën 1,500 si të papërqendruar, dhe tregun me HHI midis 1,500 dhe 2,500 si mesatarisht të përqendruar. Departamenti i Drejtësisë së SHBA-së dhe Komisioni Federal i Tregtisë (2010), Udhëzuesit për Bashkimet Horizontale.

³⁹ Injeksi i klasifikimit do të zbatohet edhe nëse ERE do të përdorte udhëzuesit aktual të DOJ-së dhe FTC-së.

**Tabla 4.8:** Numri i pjesëmarrësve në treg në ALPEX dhe në tregjet krahasuese të Ditës në Avancë (DAM)

	ALPEX	HUPX (2019)	CROPEX (2020)	TGE (2016)
Shitësit	32		21	39
Blerësit	33		20	39

Burimi: Analiza e NERA-s, bursat e energjisë

5. Përfundimet

ERE ka kryer vlerësimin e parë të gatishmërisë për Tregun e Ditës në Avancë të ALPEX-it dhe ka llogaritur vlerat e treguesve të likuiditetit të përcaktuar në metodologjinë e vitit 2025 për vlerësimin e gatishmërisë së Tregut të Ditës në Avancë të energjisë elektrike. Në kuadër të këtij vlerësimi, ERE analizon tregun e bashkuar të Ditës në Avancë Shqipëri–Kosovë.

Në këtë moment, ERE konstaton se Tregu i Ditës në Avancë i ALPEX-it nuk është aq likuid sa tregjet krahasuese në periudhën kur ato kanë futur kontratat për diferenca (CfD). Faktori i qarkullimit në tregun e bashkuar të ALPEX-it është më i ulët se në tregjet krahasuese në vitet përkatëse, diferencat mes ofertës dhe kërkesës (*Bid-Ask Spreads*) janë më të larta se ato në HUPX në vitin 2019, dhe tregu nuk është në gjendje të përthithë 146 mw kapacitet të ri me çmim pozitiv në 25 për qind të orëve. Prandaj, vlerësimi i gatishmërisë së tregut nuk jep prova se Tregu i Ditës në Avancë i ALPEX-it është ende gati të mbështesë konvertimin e kontratave PPA të prodhuesve nga burimet e rinovueshme në CfD.

Megjithatë, ka zhvillime pozitive drejt rritjes së likuiditetit. Tregu i Ditës në Avancë i ALPEX-it ka prodhuar një sinjal të qëndrueshëm çmimi për më shumë se 10 muaj, dhe numri i pjesëmarrësve është në përputhje me tregjet krahasuese të BE-së. Për më tepër, treguesi HHI sugjeron se ana e shitjes në tregun e bashkuar është konkurruese, ndërsa ana e blerjes është mesatarisht e përqendruar. Pika e klerimit të tregut shteron ofertën ose kërkesën vetëm në rreth 2.5 për qind të orëve.

Siç parashikohet në metodologjinë e miratuar nga ERE për vlerësimin e gatishmërisë së Tregut të Ditës në Avancë, ERE do ta përsërisë vlerësimin e gatishmërisë së tregut vitin e ardhshëm, për të rivlerësuar nëse Tregu i Ditës në Avancë i ALPEX-it do të jetë gati të mbështesë konvertimin e kontratave PPA në kontrata për diferenca (CfD).

Shtojca A. Burimet e të dhënave dhe procesi i marrjes së tyre

Siç e kemi paraqitur në pjesën kryesore të këtij dokumenti, ERE kërkon të dhëna të detajuara mbi çmimet dhe vëllimet e klerimit të tregut, kurbat e ofertës dhe kërkesës, si dhe tregtimet e përfunduara, për të kryer vlerësimin e gatishmërisë së tregut. Kjo shtojcë përshkruan burimet e të dhënave të përdorura dhe procesin e marrjes së tyre.

A.1 ALPEX

Për të kryer analizën e saj, ERE kërkoi këto të dhëna për çdo orë në tregun e bashkuar Shqipëri–Kosovë të Ditës në Avancë, që mbulojnë të gjithë periudhën e analizës:

- Çmimet dhe vëllimet e pastrimit të tregut në Shqipëri dhe Kosovë;
- Kurba e ofertës dhe kërkesës në Shqipëri dhe Kosovë;
- Tregtitë e përfunduara sipas pjesëmarrësve të tregut në Shqipëri dhe Kosovë.

Për të siguruar të dhënat e tregut të ditës-në-avancë, ERE u angazhua me ALPEX-in për marrjen e informacionit mbi tregtimet e përfunduara. ALPEX-i i vuri në dispozicion ERE-s dhe konsulentit të saj të dhëna mbi tregtimet e përfunduara gjatë gjithë periudhës së analizës. Përveç kësaj, ERE përdori të dhënat që ALPEX-i i publikon në mënyrë të hapur mbi kurbat e ofertës dhe kërkesës, si dhe mbi çmimet dhe vëllimet e klerimit të transaksioneve të tregut. Siç diskutohet në pjesën kryesore të këtij dokumenti, vlerësimi i ERE-s merr në konsideratë si Tregun e Ditës në Avancë në Shqipëri, ashtu edhe atë në Kosovë, në periudhat kur dy tregjet janë të bashkuara, pra kur nuk ka ngarkesë ndërzonale dhe tregu i bashkuar funksionon si një i vetëm.

A.2 Të dhënat nga bursat e tjera të energjisë

ERE, gjithashtu, u angazhua me bursat e energjisë që u përzgjidhën si tregje krahasuese. Ajo siguroi të dhëna mbi çmimet dhe vëllimet e procesit të klerimit të tregut në secilin treg, si dhe kurbat e ofertës dhe kërkesës, kur këto ishin të mjaftueshme për të përcaktuar formimin e çmimit.



A.3 ACER

Për të krahasuar në mënyrë të saktë faktorët e qarkullimit të llogaritur nga ERE me ata që ACER vlerëson dhe publikon çdo vit, ERE u angazhua me ACER-in për të kuptuar metodologjinë që ACER përdor. ACER-i konfirmoi qasjen e saj për llogaritjen e faktorëve të qarkullimit në komunikimin me *email* me ERE-n.

ACER konfirmoi, gjithashtu, se në vlerësimin e faktorëve të qarkullimit për tregjet krahasuese merr parasysh edhe tregtimin jashtë bursës (*Over-the-Counter*). Për të mundësuar një krahasim më të drejtpërdrejtë midis ALPEX-it dhe vendeve të BE-së që shërbejnë si krahasim, ERE ka llogaritur faktorët e qarkullimit për secilin treg krahasues, duke përdorur të dhënat e publikuara mbi vëllimet e procesit të klerimit të tregut.

A.4 ENTSO-E

Për të llogaritur faktorët e qarkullimit, ERE kërkoi të dhëna mbi ngarkesën (*load*) në Shqipëri, në Kosovë dhe në secilin treg krahasues për vitet përkatëse. ERE ka përdorur të dhënat e ngarkesës të publikuara nga ENTSO-E në platformën e tij të transparencës, për të llogaritur faktorët mujorë dhe vjetorë të qarkullimit që paraqiten në këtë dokument.

Shtojca B. Detaje mbi llogaritjen e treguesve

B.1. Faktori i qarkullimit

B.1.1. ALPEX

Për shkak të numrit të ulët të orëve me çmime të ndryshme të energjisë elektrike ndërmjet dy vendeve, ERE e trajton tregun si të bashkuar gjatë llogaritjes së faktorëve të qarkullimit. Kjo do të thotë se, për periudhën 12-mujore nga 1 nëntori 2024 deri më 31 tetor 2025, ERE merr në konsideratë shumën e vëllimeve të tregtuara në të dyja anët shqiptare dhe kosovare dhe e ndan këtë vëllim me kërkesën totale në të dyja rajonet për të llogaritur faktorët e qarkullimit.⁴⁰

Në seksionin 4.4, ne raportojmë faktorët e qarkullimit për periudhën 12-mujore të analizës. ERE, gjithashtu, llogarit faktorët e qarkullimit për secilin muaj të vitit, me qëllim studimin e mundshëm të sezonalitetit dhe ndryshimeve në këtë tregues. Kjo do të thotë se formula përshtatet për të llogaritur faktorët e qarkullimit në mënyrë të tillë që:

$$Qarkullimi\ n_M = \frac{\sum_{h=1}^k \text{Vëllimi i tregtimeve në DAM në orën } h}{\sum_{h=1}^k \text{konsumi në orën } h}$$


ku k është numri i orëve në muajin M .

Grafiku B.1 më poshtë paraqet vëllimet mujore të klerimit të tregut, kërkesën mujore të sistemit dhe faktorët mujorë të qarkullimit. Siç tregohet në grafik, vëllimet e tregtuara dhe faktori i qarkullimit janë rritur gjatë periudhës së matjes. Faktori i qarkullimit, gjithashtu, paraqet njëfarë sezonaliteti, i cili lidhet kryesisht me ndryshimet në ngarkesën e sistemit. Gjatë periudhës së analizës, faktori i qarkullimit ka qenë në intervalin nga 0.060 në 0.152, ndërsa për periudhën e plotë të analizës është 0.102.

⁴⁰ ERE zbriti tregtimet në linjën e interkoneksionit nga vëllimet e klerimit të tregut. ALPEX-i raporton tregtimin në linjën e interkoneksionit në të dyja anët e tregut të bashkuar.



Grafiku B.1: Vëllimi mujor i tregtimeve në ALPEX, ngarkesa dhe faktori i qarkullimit




Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e ALPEX-it

B.1.2. HUPX

ERE analizon, gjithashtu, faktorët mujorë të qarkullimit në tregjet krahasuese. Ashtu si faktori i qarkullimit në ALPEX, edhe faktorët e qarkullimit në tregjet krahasuese ndryshojnë nga muaji në muaj. Këto ndryshime shkaktohen si nga sezonaliteti i vëllimeve të tregtuara, ashtu edhe nga ngarkesa totale e sistemit.

Grafiku B.2 paraqet faktorët mujorë të qarkullimit në HUPX për vitin 2019. Siç shihet në grafik, faktori mujor i qarkullimit varion nga 0.43 në janar 2019 në 0.55 në mars, prill dhe maj. Faktori vjetor i qarkullimit për vitin 2019 është 0.511.

Grafiku B.2: Faktori mujor i qarkullimit në HUPX, 2019




Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e HUPX-it.



B.1.3. CROPEX


Grafiku B.3 paraqet faktorët mujorë të qarkullimit në CROPEX për vitin 2020. Siç tregohet në grafik, faktori mujor i qarkullimit është në nivelin më të ulët, 0.31, në muajin korrik dhe në nivelin më të lartë, 0.48, në muajin maj. Faktori i qarkullimit për gjithë vitin 2020 është 0.359. Vëllimet e tregtuara në CROPEX, duket se paraqesin njëfarë sezonaliteti, me vëllime më të larta tregtimi dhe kërkesë totale më të madhe gjatë muajve të dimrit.



Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e CROPEX-it

B.1.4. TGE

Më poshtë paraqiten faktorët mujorë të qarkullimit në TGE për vitin 2016. Faktori i qarkullimit në TGE ndryshon disi më pak se në tregjet e tjera që analizohen në këtë studim, duke u luhatur nga 0.16 në 0.18. Kjo ndodh sepse vëllimet e tregtuara në TGE dhe ngarkesa totale në Poloni ndjekin një model të ngjashëm. Një rritje e ngarkesës totale shoqërohet me një rritje të vëllimit të tregtuar dhe anasjelltas.



Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e TGE-së.

B.2. Bid-Ask Spread

B.2.1. ALPEX

ERE ka analizuar diferencën ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) në Tregun e bashkuar të Ditës në Avancë të ALPEX-it. Si pjesë e analizës, ndërtohen kurbat e plota të ofertës dhe kërkesës në tregun e bashkuar, duke përdorur të dhëna mbi urdhrat e blerjes dhe të shitjes në Shqipëri dhe Kosovë.

Siç përcaktohet në seksionin 4.3, ne përjashtojmë nga analiza 57 orët në të cilat çmimet në Shqipëri dhe Kosovë nuk konvergojnë.

Gjithashtu, ka 47 orë në të cilat kurbat e ofertës dhe kërkesës në tregun e bashkuar nuk janë në përputhje me rezultatet e klerimit të tregut ose të dhënat mungojnë. Edhe këto orë përjashtohen nga mostra e analizës. Këto orë janë:

- Më 30 mars 2025, ka një orë pa të dhëna për shkak të ndryshimit të orës verore. Meqenëse nuk ka të dhëna dhe kjo orë në praktikë nuk ekziston, ajo përjashtohet nga mostra e analizës.

- Më 5 korrik 2025, rezultatet e publikuara të tregut nga ALPEX-i për Shqipërinë dhe Kosovën paraqesin sasi të njëjta të klerimit të tregut. Kjo duket të jetë një gabim në të dhëna dhe këto sasi nuk janë në përputhje me kurbat e ofertës dhe kërkesës në tregun e bashkuar. Për këtë arsye, këto orë përjashtohen nga mostra e analizës.

- Më 26 tetor, rezultatet e pastrimit të tregut të publikuara nga ALPEX-i dhe sasitë në të dhënat e tregtimeve nuk janë në përputhje pas ndryshimit të orës në 02:00. Meqenëse kjo duket të jetë një gabim në të dhëna, këto orë përjashtohen nga mostra e analizës.

Analiza e ERE-s mbi diferencën ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) përfshin orët e mbetura. Megjithatë, diferenca ofertë-kërkesë nuk mund të përcaktohet në 2.5 për qind të këtyre orëve. Siç përcaktohet në seksionin 0, diferenca ofertë-kërkesë përcaktohet vetëm nëse ekziston një urdhër i radhës i paplotësuar në të dy anët e tregut.

Grafiku B.5 më poshtë ilustron një rast në të cilin diferenca ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) nuk mund të përcaktohet qartë. Sasia e klerimit të tregut është e barabartë me sasinë maksimale të ofertës në treg. Për rrjedhojë, nuk ekziston urdhër i radhës i paplotësuar për shitje (*ask*), dhe diferenca ofertë-kërkesë nuk mund të përcaktohet në këtë orë ilustrative. Ky është rasti pavarësisht nëse e gjithë kërkesa përmbushet apo jo. Në mënyrë të kundërt, nëse e gjithë kërkesa në treg përmbushet, nuk ekziston urdhër i paplotësuar për blerje (*bid*), dhe diferenca ofertë-kërkesë nuk mund të përcaktohet, edhe nëse në treg ka urdhra të paplotësuar për shitje.⁴¹

Grafiku B.5: Diferenca ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) nuk përcaktohet kur e gjithë oferta përmbushet



Burimi: Ilustrim nga NERA.

B.2.2. HUPX

HUPX-i i vuri në dispozicion konsulentit të ERE-s kurbat e ofertës dhe të kërkesës që janë të mjaftueshme për të përcaktuar çmimet dhe sasitë e klerimit të tregut në Tregun e Ditës në Avancë të HUPX-it. Meqenëse këto kurba të ofertës dhe të kërkesës janë në përputhje me çmimet dhe vëllimet e

⁴¹ Gjatë periudhës së analizës, nuk ka asnjë orë në të cilën përmbushet njëkohësisht e gjithë kërkesa dhe e gjithë oferta në tregun e bashkuar.


klerimit të tregut në HUPX DAM, ato i mundësojnë ERE-s të vlerësojë diferencën ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) për çdo orë në HUPX DAM gjatë vitit 2019.

Ashtu si në ALPEX, të dhënat përfshijnë edhe orë në të cilat kurbat e ofertës dhe të kërkesës duket se nuk janë në përputhje me çmimet dhe vëllimet e klerimit të tregut. Në vitin 2019, ka 46 orë të tilla.

Pothuajse të gjitha, konkretisht 45 orë me mospërputhje, ndodhin ndërmjet datave 28 nëntor dhe 1 dhjetor 2019. Ora e fundit me mospërputhje të të dhënave ndodh më 23 dhjetor. ERE nuk disponon të dhëna për të përcaktuar arsyen e këtyre mospërputhjeve dhe nuk mund të përcaktojë se cilat të dhëna duhet të kenë përparësi. Për këtë arsye, këto orë përjashtohen nga mostra e analizës. Diferenca ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) është e përcaktuar qartë për të gjitha orët e mbetura në mostër.

Grafiku B.6 paraqet diferencat ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) për çdo orë gjatë vitit 2019 dhe Tabla B.1 paraqet statistikën përmbljedhëse të shpërndarjes së tyre. Siç mund të shihet nga grafiku dhe tabela, tre të katërtat e diferencave ofertë-kërkesë janë 1.50 EUR/mwh ose më pak. Kjo korrespondon me më pak se 3.0 për qind të çmimit mesatar vjetor të tregut. Megjithatë, ka raste individuale ku diferenca ofertë-kërkesë arrin deri në 285 EUR/mwh.

Grafiku B.6: Diferenca ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) në Tregun e Ditës në Avancë të HUPX-it në vitin 2019



Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e HUPX-it.

Tabla B.1: Statistikat Përmbljedhëse të diferencës ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) në Tregun e Ditës në Avancë të HUPX-it

	Formula	5th pctl.	25th pctl.	Mediani	Mesatarja	75th pctl.	95th pctl.
Diferenca ofertë-kërkesë (€/MWh)	A	0.10	0.20	0.60	1.86	1.50	5.70
Çmimi i tregut (€/mwh)	B				50.36		
Diferenca ofertë-kërkesë (në përqindje)	A/mean(B)	0.20%	0.40%	1.19%	3.70%	2.98%	11.32%

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e HUPX-it

B.2.3. CROPEX

Përfaqësuesit e CROPEX-it i komunikuan ERE-s se CROPEX-i nuk mund të sigurojë kurba të ofertës dhe kërkesës që janë të mjaftueshme për të përcaktuar formimin e çmimit në Tregun e Ditës në Avancë të CROPEX-it. CROPEX-i nuk ka akses në urdhrat e blerjes dhe të shitjes në bursat e energjisë, të bashkuara që kontribuojnë në çmimin dhe sasinë e klerimit të tregut në CROPEX DAM. Për këtë arsye, ERE nuk mund të llogarisë diferencën ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) për CROPEX-in.



B.2.4. TGE

Përfaqësuesit e TGE-së i komunikuan ERE-s, se TGE-ja nuk mund të sigurojë kurbat e ofertës dhe kërkesës për çdo orë të vitit 2016. Për këtë arsye, ERE nuk mund të llogarisë diferencën ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*) për TGE-në.

B.3. Thellësia e tregut

ERE ka analizuar thellësinë e tregut në Tregun e Bashkuar të Ditës në Avancë të ALPEX-it. Për këtë qëllim, ERE ndërton kurbat e plotë të ofertës dhe kërkesës në tregun e bashkuar, duke përdorur urdhrat e blerjes dhe të shitjes në Shqipëri dhe në Kosovë.

Siç kemi paraqitur në shtojcën 0, kurbat e ofertës dhe të kërkesës në tregun e bashkuar nuk janë në përputhje me rezultatet e klerimit të tregut, në rastet kur çmimet në Shqipëri dhe në Kosovë nuk konvergojnë. Për më tepër, ka edhe orë në të cilat rezultatet e klerimit të tregut duket se nuk janë në përputhje me kurbat e ofertës dhe kërkesës, ndoshta për shkak të gabimeve në të dhëna.

ERE përjashton të njëjtin grup orësh nga analiza e thellësisë së tregut, si edhe nga analiza e diferencës ofertë-kërkesë (*Bid-Ask Spread*). Konkretisht, përjashtohen 57 orët në të cilat çmimet në Shqipëri dhe në Kosovë ndryshojnë, si dhe 47 orët në të cilat kurbat e ofertës dhe të kërkesës në tregun e bashkuar nuk janë në përputhje me rezultatet e pastrimit të tregut ose mungojnë të dhënat.

B.4. Konkurrueshmëria

ERE analizon përqendrimin e tregut të bashkuar gjatë gjithë periudhës së analizës. Për këtë qëllim, ERE përdor të dhënat e tregtimeve në të dyja anët e tregut, atë shqiptare dhe atë kosovare, për të vlerësuar numrin e pjesëmarrësve, pjesët e tyre të tregut dhe treguesin HHI.

Siç raportohet në seksionin 4.7, ERE konstaton se ana e blerjes së tregut është mesatarisht e përqendruar, ndërsa ana e shitjes është konkurruese. Diferenca në indeksin HHI është rreth 360, pavarësisht se pjesët e tregut të pjesëmarrësve më të mëdhenj janë të ngjashme. Pjesa më e madhe e tregut në anën e blerjes është 22 për qind, ndërsa në anën e shitjes është 20 për qind. Diferenca në indeksin HHI shkaktohet nga prania e më shumë blerësve me pjesë më të mëdha tregu.

Tabela B.2 më poshtë paraqet pesë pjesët më të mëdha të tregut në të dyja anët e tregut. Siç tregon tabela, pesë pjesët më të mëdha të tregut në anën e blerjes janë më të larta se pjesët përkatëse të tregut të shitësve.

Tabela B.2: 5 pjesët e tregut të pjesëmarrësve

	Ana e blerjes	Ana e shitjes
Më e larta	22.1%	20.0%
E dyta më e lartë	15.0%	10.2%
E treta më e lartë	11.9%	9.2%
E katërta më e lartë	10.3%	7.6%
E pesta më e lartë	9.8%	7.1%

Burimi: Analiza e NERA-s mbi të dhënat e ALPEX-it.



VENDIM
Nr. 158, datë 5.6.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “GREENSOL” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/1 prot., datë 3.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Greensol’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Greensol” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 22.5.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaike, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 mw.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a” dhe “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “b” dhe “d”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera Shoqëria “Greensol” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën nr. 602 rep., nr. 164 kol., datë 10.2.2026, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 49.96 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, nga shoqëria ‘Greensol’ sh.p.k.”;

- Është pajisur me miratimin në parim për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës me nr. 1994/2 prot., datë 23.5.2025, të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë;

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa “c”: Shoqëria duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me stafin teknik efektiv;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “b”: Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE mbështetjen financiare për 20% e mbetur të vlerës totale të investimit të projektit;

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1, Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë një garanci për panelet që parashikon të përdorë, në rast se e disponon, për të rakorduar afatin e vlefshmërisë së licencës, si dhe të përcaktojë një datë specifike në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit;



- germa “c”: Shoqëria duhet të bëjë me dije në rast se ka nënshkruar marrëveshjen përfundimtare me “OST” sh.a. dhe nëse po, ta depozitojë atë në ERE;

- germa “e”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE një VNM paraprake të përditësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Greensol” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Greensol” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 159, datë 5.6.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ASSA ENERGY SOLUTIONS” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika

1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1641/1 prot., datë 3.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ASSA Energy Solutions’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ASSA Energy Solutions” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1641 prot., datë 20.5.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me vendndodhje në Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, me kapacitet të instaluar 10 mwac.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a” dhe “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencim në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “c”, “d” dhe “e”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera
Shoqëria “ASSA Energy Solutions” sh.p.k.:



- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në datën 25.11.2024, “Marrëveshjen për zhvillimin e projektit në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e një impianti fotovoltaiik me një kapacitet të instaluar prej 10 mwac dhe kapacitet të mbështetur prej 10 mwac që do vendoset në Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier”, me nr. 9291 prot., datë 25.11.2024;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. “Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaiik ASSA” të protokolluar në OST sh.a. me nr. 760/7 prot., datë 15.4.2026 dhe në shoqërinë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k., me nr. 13 prot., datë 15.4.2026, për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit.

- Shoqëria “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. është pajisur me vendimin për VNM paraprake me nr. AN 150920250037, datë 12.1.2026, komisioni 05, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Parku fotovoltaiik ASSA dhe veprat ndihmese”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9. Formatit dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa “c”: Shoqëria duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me bërjen efektive të stafit teknik;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë vendimet e organeve drejtuese të secilës prej shoqërive ortake të saj, ku të jetë dedikuar shuma përkatëse në kuadër të financimit të 20% të vlerës totale të investimit të projektit;

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1”:

- germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë një garanci për panelet që parashikon të përdorë, në rast se e disponon, për të rakorduar afatin e vlefshmërisë së licencës, si dhe të përcaktojë një datë specifike në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit;

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE komunikimin me MIE-n, në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta (SPV) (së cilës,

sipas marrëveshjes me MIE-n, i transferohen të gjitha të drejtat, ndër to dhe e drejta e operimit të impiantit), të depozitojë në ERE qëndrimin e MIE-s, në rast se ka pasur një të tillë; të bëjë me dije në rast se e ka nënshkruar marrëveshjen përfundimtare dhe ta depozitojë atë në ERE; si dhe të përditësojë çdo informacion vijues, në lidhje me zhvillimin e projektit;

- germa “e”: Shoqëria duhet të japë informacion, në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit, si dhe të bëjë saktësimet përkatëse në lidhje me vendndodhjen e centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 160, datë 5.6.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “NEXORA ENERGY” SHPK
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1660/1 prot., datë 3.6.2026, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nexora Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Nexora Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1660 prot., datë 22.5.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016,

të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 germat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

- Në lidhje me stafin teknik që do të angazhohet me veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, shoqëria ka bërë me dije se stafi do të jetë efektiv në fazën e dytë, pas marrjes së licencës. Në këto rrethana vlerësohet t’i bëhet me dije shoqërisë që në rast licencimi, do t’i lihet kushti përkatës për përditësimin e informacionit mbi stafin efektiv të angazhuar në ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Nexora Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË]]Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 129|Datë: 22.06.2026 12:17:08
+02:00[[f1297da2-c1bc-4966-a822-85f734745f6c

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)